- A) Dhimbja konstante (abdominale) uterine
- B) Hemorragjia vaginale me gjak të errët
- C) Uterusi i kontraktuar, i dhimbshëm, hipertonic
- D) Mungesë e hemorragjisë

Infermieri Pyetje: 826

Pas lindjes gruaja ka hemoragji të vazhdueshme në sasi të pakët, fundusi uterin i kontraktuar. Kjo vjen si pasojë e:

- A) Atonisë së uterusit
- B) Laçeracionit të columit
- C) Mbetjeve të fragmenteve placentare
- D) Mbetjeve të membranave amniotike

Infermieri Pyetje: 827

Hemoragjia e hershme e postpartumit (hemoragjia që ndodh brenda 24 orëve të para të pas lindjes) ka më pak gjasa të ndodhë si rezultat i :

- A) Atonin uterine
- B) Formacioneve të hematomave
- C) Laceracionet e labieve, perineumit, vaginës ose cerviksit
- D) Subinvolucionin e uterusit

Infermieri Pyetje: 828

Shkaqet më të shpeshta të subinvolucionit janë:

- A) Barra multiple dhe hemorragjia postpartum
- B) Hemorragjia postpartum dhe infeksioni
- C) Kontraksion persistent dhe mbidozim me oxytocinë
- D) Mbetje e fragmenteve placentare dhe infeksioni

Infermieri Pyetje: 829

Një grua shtatzanë për herë të parë lind dy binjakë në javën e 37 të shtatzanisë.

Përshkrimi korrekt i anamnezës obstetrikale të gruas do të jetë:

- A) Multigravida, multipara
- B) Multigravida, primipara
- C) Primigravida, multipara
- D) Primigravida, primipara

Infermieri Pyetje: 830

Amniotomia është:

- A) Marrja e likidit amniotik për vlerësim
- B) Plasja artificiale e membranave
- C) Plasja spontane e membranave
- D) Studimi citologjik i likidit amniotik

Infermieri Pyetje: 831

Në metodat diagnostikuese jo-invazive në obstetrikë NUK bën pjesë:

- A) Ekografia
- B) Stress test
- C) Amniocenteza
- D) Profili biofizik

Infermieri Pyetja: 832

Zonja X ka zgjedhur metodën kalendarike për të kontrolluar kontracepsionin. Gjatë procesit të vleresimit, më e rëndësishme për infermieren është:

A) Ekzaminimi i pigmentacionit të lëkurës dhe cilesise së flokëve për ndryshime hormonale

B) Marrja e anamnezës menstruale për 6- 12 muajt e fundit

C) Njohja e experiencës së mëparshme të gruas për të kontrolluar lindjen

D) Përcaktimi i shtimit dhe humbjes në peshë

Infermieri Pyetja: 833

Zonja X është duke përdoruar temperaturën bazale trupore si metodë kontrceptive. Ajo shkon për kontroll në klinikë dhe i tregon infermieres "periodat e mia janë paksuar dhe temperatura nuk është rritur" përgjigja më e përshtatshme e mamisë duhet të jetë:

A) Ju keni qënë e sëmurë këtë muaj

B) Ju ndoshta nuk patët ovulacion këtë muaj

C) Kjo ndoshta nënkupton që ju jeni shtatzanë

D) Mos u mërzitni ndoshta kjo nuk është asgjë

Infermieri Pyetja: 834

Sifilia shkaktohet nga :

A) Clamidia trakomatis

B) Herpesi simpleks

C) Neiseria gonorrhoea

D) Treponema pallidum

Infermieri Pyetja: 835

Substancat spermicide veprojnë me anë të:

A) Barrierave mekanike

B) Duke frenuar ovulacionin

C) Duke shtuar rritjen e epitelit vaginal.

D) Shkatërrimit të spermës

Infermieri Pyetja: 836

Cili tip i pilulave kontraceptive konsiderohet i përshtatshëm për gjashtë javët e para pas lindjes kur është në ushqyerje me gji?

- A) pilulat kontraceptive të kombinuara
- B) pilulat kontraceptive trifazike
- C) pilulat me dozë të lartë estrogeni
- D) pilula vetëm me progesterone

Infermieri Pyetja: 837

Çrregullimet e shikimit dhe ato cerebrale janë karakteristike për:

- A) Diabetin e shtatzanisë
- B) Aneminë e shtatzanisë
- C) Preeklampsinë e rëndë
- D) Asnjë nga këto

Infermieri Pyetja: 838

Kondomët duhet të përdoren gjatë shtatzanisë:

- A) Asnjëherë
- B) Nga gratë me rrezik për kandida
- C) Nga gratë me rrezik të lartë për SST
- D) Nga të gjitha gratë shtatzana

Infermieri Pyetja: 839

Një grua e re vjen në klinikë dhe ju shpjegon që një natë më parë gjatë marëdhënies seksuale kondomi u çka. Në konsultë me këtë kliente ju e këshilloni atë që kontracepsioni post koital (kontracepsioni i urgjencës) ul rrezikun e një shtatzanie dhe është shumë efektiv kur:

- A) Ajo merret në çdo kohë përpara ciklit
- B) Doza e parë merret sa më shpejt që të jetë e mundur
- C) Doza e parë mund të merret pas 72 orëve
- D) Mund të merret dhe pas tre ditësh

Infermieri Pyetja: 840

Zonja X është beqare dhe përshkruan jetën e saj seksuale, si aktive dhe me shumë partnerë. Ajo dëshiron një metodë kontraceptive, e cila është e sigurtë dhe që nuk ndikon në aktivitetin e saj seksual. Ajo kërkon D.I.U.. Përgjigja me e përshtatëshme e ma

- A) D.I.U. do t'ju mbrojë ju nga SST
- B) D.I.U. nuk ndikon në aktivitetin seksual
- C) Përqindja e barrave është më e lartë me D.I.U.
- D) Rreziku i SIP është më i madh për ju

Infermieri Pyetja: 841

Zoti dhe Zonja X po kalojnë momente të vështira për pamundësinë e tyre për të krijuar shtatzanësi. Ata duan të dinë se çfarë mund të bëjnë për të ruajtur ekuilibrin e tyre emocional. Përgjigja më e përshtatëshme nga ana e mamisë është :

- A) T'i tregojnë gjithë shokëve të tyre dhe familjeve
- B) Të bisedojnë me homologët e tyre infertil
- C) Të kërkojnë mbështetje nga grupet e specializuara për këtë problem
- D) Të fillojnë procedurat e menjëherëshme për adoptim

Infermieri Pyetja: 842

Një grua është duke përdorur diafragmën në mënyrë jo korrekte nëse ajo:

- A) Aplikon spermicid brenda kupës dhe rreth buzëve të diafragmës
- B) E lan atë me sapun të butë dhe ujë pas përdorimit dhe më pas e pudros atë me niseshte
- C) Lëviz atë brenda 2 orëve pas aktit të fundit të koitusit
- D) Vendos diafragmën 6 orë para marrëdhënies

Infermieri Pyetje: 843

Zonja X. sapo ka patur abort në tremestrin e I-rë dhe është dërguar në shtëpi duke i dhënë kontraceptivë oral për tu mbrojtur nga një barrë, ajo është këshilluar të :

- A) Të fillojë kontraceptivët oral që ditën e kryerjes së abortit
- B) Të mënjanojë kontaktin seksual deri sa të pushojë hemorragjia
- C) Të përdorë kondom dhe shkumë për javën e parë
- D) Të përdorë një metodë tjetër kontraceptive për një cikël të plotë

Infermieri Pyetje: 844

Procedura e sterilizimit në meshkuj është:

- A) Lidhja e tubave
- B) Spermicitet
- C) Spermitostatikë
- D) Vasektomia bilaterale

Infermieri Pyetje: 845

Metoda më frekvente për kontrollin e lindjeve e përdorur nga femrat 15-19 vjeçare është:

- A) Depo-Provera
- B) DIU-ja
- C) Kontraceptivët oral
- D) Norplanti

Infermieri Pyetja: 846

Zonja X është diagnostikuar dhe trajtuar për sindromin e shokut toksik. Ajo në ndonjë rast të marrdhënieve seksuale ka përdorur kontraktivë të marrë vetë në farmaci. Bazuar në anamnezën e saj, çfarë kontraktivësh, nuk duhet të përdorë ajo dhe partner

- A) Diafragmat
- B) Kondom vaginal.
- C) Kondomi
- D) Sfungjerët

Infermieri Pyetja: 847

IST që transmetohen më shpesh janë:

- A) C. Trachomatis
- B) N. Gonorrhea
- C) Sifilizi
- D) Vulvovaginal candidosis

Infermieri Pyetja: 848

Në efektet anësore të DIU (dispozitivi intrauterin) përfshihen:

- A) Depresioni
- B) Gjendja e ankthit
- C) Nauzeja dhe dhimbja e kokës
- D) Menstruacione më të rënda

Infermieri Pyetja: 849

Cilat nga pikat e mëposhtme sugjeron infermierin që gruaja mund të ketë vaginitis monialis?

- A) Ankesë për kuarje vulvare irrituese
- B) Dhimbje mesi të padurueshme
- C) Sekrecine të ujshme në ngjyrë të verdhë
- D) Temperaturë



Infermieri Pyetja: 198

Tek astma frymemarrja e pafrytshme lidhet me:

- A) bllokimin e rrugëve ajrore
- B) përmirësimin e sëmundjes
- C) përgjigjjen jo të mirë ndaj mjekimit
- D) sekrecionet e shumta

Infermieri Pyetja: 199

Astma përfaqëson një:

- A) Dëmtim funksional
- B) Obstruksion te rrugeve respiratore
- C) Sekrecione të shumta
- D) Mjekime jo specifike

Infermieri Pyetja: 200

Haemarthrosis është gjakrrjedhje ne:

- A) toraks
- B) SNQ
- C) artikulacione
- D) traktin gastro-intestinal

Infermieri Pyetja: 201

Parotiti është një sëmundje:

- A) e gjëndrave limfatike
- B) endemike sporadike
- C) enët e gjakut
- D) sistemin nervor





Infermieri Pyetja: 202

Shkaktari i fruthit është virusi :

- A) RNA
- B) i grupit te herpoviruseve
- C) i fruthit
- D) i gripit

Infermieri Pyetja: 203

Në bronkiolit pas hyrjes së virusit kemi këto pasoja:

- A) vështirësi në frymarrje
- B) infiltrim peribronkial
- C) bllokim të anës së prekur
- D) zmadhim te anës së prekur

Infermieri Pyetja: 204

Tipari karakteristik i fibrozës cistike është:

- A) disfunkcion i sipërfaqeve epiteliale
- B) mosfunktionimit të shkëmbimit të brëndshëm të gjëndrave
- C) disfunkcioni i bërthamës qelizore të gjëndrave.
- D) mos oksigjenimi i organizmit

Infermieri Pyetja: 205

Fibroza cistike vjen si pasoj e çrregullimit te fluksit hidroelektrolitik:

- A) midis gjëndrave
- B) midis sistemeve
- C) transepitelial
- D) i enëve të gjakut





Infermieri Pyetja: 206

Metodat për përcaktimin e testit për fibrozën cistike bëhen pas muajit :

- A) të parë të jetës
- B) të gjashtë të jetës
- C) të tretë të jetës
- D) të dymbëdhjete të jetës

Infermieri Pyetja: 207

Tek fibroza cistike dozat e enzimave do jepen në bazë të :

- A) defiçitit të enzimave
- B) sipas oreksit
- C) sipas harxhimeven në organizem
- D) humbjeve të gjakut

Infermieri Pyetja: 208

Rreziku për ndryshimin e funksionit kardio-vaskular lidhet me :

- A) pamjaftushmërin e punës së zemrës
- B) mungesën e mjekimit
- C) pamundësin për të kuptuar gjëndjen
- D) pamjaftushmerin e lendëve proteinike

Infermieri Pyetja: 209

Tek të sëmurët me probleme kardiake digogsina shkakton:

- A) reduktim të të rrahurave të zemrës
- B) rritje të të rrahurave të zemrës
- C) neutralizim të të rrahurave të zemrës
- D) ndalje të punës së zemrës



Infermieri Pyetje: 210

Anemia vjen si pasoje e :

- A) uljes së masës leukocitare
- B) prodhimit gabim të leukociteve
- C) uljes së masës eritrocitare
- D) rritjes së masës eritrocitare

Infermieri Pyetje: 211

Në dëmtimet kronike renale, ulja e filtrimit renal, fillon nga rritja e:

- A) pH
- B) produktit të katabolizimit të proteinave
- C) nivelit të serumit të fosfateve
- D) nivelit të yndyrave

Infermieri Pyetje: 212

Në stadin e dytë shiriti i gjedhit migron për në :

- A) mëlçi
- B) mushkri
- C) tru
- D) veshka

Infermieri Pyetje: 213

Pas sa kohësh kemi ulçeracion të plagës nga pickimi i merimangës së zezë?

- A) 3-4 dite
- B) 7-14 dite
- C) 15-20 dite
- D) 22-27 dite





Infermieri Pyetje: 214

Veprimi i zgjatur ultralent i insulinës e ka kulmin pas sa orësh të injektimit subkutan

- A) 2-4 orë
- B) 6-12 orë
- C) 14-24 orë
- D) 28-36 orë

Infermieri Pyetje: 215

Sa është sasia e lëndëve rehidruuese (Trisol) për ml/kg/peshë, që nevojiten në 24 orë në dehidrimin e lehtë nga diarrea?

- A) 30
- B) 50
- C) 70
- D) 100



Infermieri Pyetje: 216

Në dehidrimin e rëndë sasia për ml/kg/Peshë e likideve intravenoze që nevojiten në 24 orë janë:

- A) 70
- B) 100
- C) 150
- D) 250

Infermieri Pyetje: 217

Cila është koha që fëmija riinfekton veten me oksiuere?

- A) 6-10 orë
- B) 3-5 ditë
- C) 6-8 javë
- D) 10-15 javë





Infermieri Pyetje: 218

Cila dhimbje tregon se fëmija ka askaride?

- A) Abdominale
- B) Muskujsh
- C) Koke
- D) Këmbe

Infermieri Pyetje: 219

Shenjat klinike të Trichinosis janë:

- A) dhimbje koke
- B) anemi
- C) enjte të syve
- D) kollë



Infermieri Pyetje: 220

Karakteristikat e dhimbjes të pickimit nga merimanga janë:

- A) fillon brenda një dite pas pickimit
- B) përhapet nga vendi i pickimit në kokë
- C) imiton një apendisit akut
- D) shoqërohet me prurit

Infermieri Pyetje: 221

Gjatë helmimit bëjme futjen e sondës gastrike dhe aplikojmë tretësire kripore:

- A) 10-25 ml
- B) 30-40 ml
- C) 50-80 ml
- D) 100-120 ml



Infermieri Pyetje: 222

Shenjat klinike të helmimit nga hidrokarburet janë:

- A) ndryshime të vetëdijes
- B) oliguri
- C) dehidrim
- D) anemi

Infermieri Pyetje: 223

Pas sa kohësh ndodh periudha e fshehte tek helmimi nga acetaminofeni?

- A) 2-4 sekonda
- B) 8-16 minuta
- C) 24-36 ore
- D) 7-10 ditë

Infermieri Pyetje: 224

Pas të vjellave fëmija vëzhgohet për shenja të dehidrimit, të cilat janë:

- A) thellim të syve
- B) dhimbje barku
- C) dhimbje koke
- D) thellim të syve, dhimbje barku e koke

Infermieri Pyetje: 225

Cilat janë shenjat e idiosinkrazisë?

- A) Dilatim i pupilave
- B) Puls
- C) Dhimbje barku
- D) Nauze

Infermieri Pyetje: 226

Çfarë shenjash ka stomatiti Vincent?

- A) Gjakrrjedhje nga gingivat
- B) Të vjella
- C) Dhimbje të gjymtyrëve
- D) Diarre

Infermieri Pyetje: 227

Zhvillimi i alergjisë ndikohet nga :

- A) Lloji i kontaktit
- B) dhimbjet e barkut
- C) diare
- D) të vjellat

Infermieri Pyetje: 228

Si pasojë e mungesës së vitaminës D, kemi çrregullime si:

- A) dhimbje barku
- B) nauze
- C) diarre
- D) vonesë në mbylljen e fontanelës

Infermieri Pyetje: 229

Tetania lidhet me çrregullimin e :

- A) joneve të Natriumit
- B) joneve të Kalciumit
- C) joneve të Klorit
- D) joneve të Natriumit, Kalciumit dhe Klorit

Infermieri Pyetje: 230

Regjimi diabetik përqëndrohet në:

- A) bërjen e insulinës
- B) kontrolli i diures
- C) kontrolli i të vjellave
- D) kontrolli i lekures

Infermieri Pyetje: 231

Obeziteti është i shoqëruar me një varg pasojash mjekësore ku përfshihen:

- A) diabeti
- B) puls i ulur
- C) probleme të dhëmbëve
- D) dhimbje koke

Infermieri Pyetje: 232

Ku depozitohen askaridet në stadin e parë të tyre?

- A) Duoden
- B) Pankreas
- C) Stomak
- D) Veshka

Infermieri Pyetje: 233

Vlerësimi infermieror në diabet përqëndrohet në:

- A) gjendjen fiziologjike
- B) informimin për sëmundjen
- C) dhimbjet e barkut
- D) dhimbjet e kokës

Infermieri Pyetje: 234

Shenjat klinike në reaksionin imuno kompleks janë:

- A) urtikarje
- B) nauze
- C) të vjella
- D) diare

Infermieri Pyetje: 235

Kujdesi infermieror në ostiomelit, për sigurimin e komfortit përfshin:

- A) pozicioni i pershtatshëm
- B) dhimbjet e barkut
- C) diarre
- D) të vjella

Infermieri Pyetje: 236

Ndërlëkimet afatgjata të diabetit insulinovartës janë:

- A) retinopatia
- B) sëmundjet intestinale
- C) anoreksia
- D) të vjellat

Infermieri Pyetje: 237

Veshka sekretion hormone si:

- A) Renina
- B) Acidi uric
- C) Urea
- D) Kristale

Infermieri Pyetje: 238

Periudha e inkubacionit të difterisë është :

- A) 2-5 ditë
- B) 7-10 ditë
- C) 13-16 ditë
- D) 20-24 ditë

Infermieri Pyetje: 239

Para marrjes së diuretikëve matet rregullisht:

- A) urinimi
- B) defekimi
- C) të vjellat
- D) tensioni arterial

Infermieri Pyetje: 240

Periudha e fshehtë e poliomyelitit abortiv është:

- A) 3-6 ditë
- B) 7-10 ditë
- C) 13-15 ditë
- D) 16-18 ditë

Infermieri Pyetje: 241

Faza post renale vjen si pasojë e një obstrukcioni mekanik:

- A) të traktit urinar
- B) traktit gastrointestinal
- C) respirator
- D) venoz

Infermieri Pyetja: 242

Sindromi hemoragjik tek i porsalinduri, vjen si pasojë e mungesës se vitamines:

- A) A
- B) D
- C) K
- D) E

Infermieri Pyetja: 243

Cila nga këto shenja shihet në analizën e ikerit?

- A) Rritja e glukozës në gjak
- B) Rritja e azotemisë
- C) Rritja e glicemisë
- D) Rritja e bilirubinës

Infermieri Pyetja: 244

Cila është ndërhyrja e parë në fëmijën prematur?

- A) Ushqyerja
- B) Dhënia e oksigjenit
- C) Vënia e perfuzioneve I/V
- D) Rregullimi i temperaturës

Infermieri Pyetja: 245

Cila është shenja e infeksionit umbelikal?

- A) Nauze
- B) Temperaturë
- C) Humbje oreksi
- D) Zverdhje

Infermieri Pyetje: 246

Ku konsiston ndërhyrja për foshnjën lindur me ikter?

- A) Vendosja nën oksigjen
- B) Dhënia e antibiotikëve
- C) Bërja e transfuzioneve
- D) Futja në fototerapi

Infermieri Pyetje: 247

Cila është simptoma që tregon frakturë të klavikulës?

- A) Shtrembërim të cepit të buzës
- B) Dhimbje kur i prek krahun
- C) Hematomë të fytyrës
- D) Rënie të cepit të syrit

Infermieri Pyetje: 248

Cili organ luan rol në eliminimin e bilirubinës, gjatë jetës fetale?

- A) Placenta
- B) Mushkëria
- C) Zemra
- D) Pankreasi

Infermieri Pyetje: 249

Cila është ndërhyrja e parë, që bëhet në foshnjën me asfiksi?

- A) Ushqyerja
- B) Rregullimi i temperaturës
- C) Aspirimi
- D) marrja e analizave



Infermieri Pyetje: 250

Apnea është:

- A) frymëmarrje e shpejtë
- B) frymëmarrje e ngadaltë
- C) pushim në frymëmarrje
- D) frymëmarrje normale

Infermieri Pyetje: 251

Cila është simptoma e stenozes hipretrofike të pilorit?

- A) Cianoze
- B) Frymëmarrje e vështirësuar
- C) Apnoe
- D) Të vjella



Infermieri Pyetje: 252

Cila është masa e parë që marrim për parandalimin e përhapjes së infeksionit?

- A) Dhënia e oksigjenit
- B) Rregullimi i temperaturës
- C) Izolimi i foshnjës
- D) Bërja e ekzaminimeve

Infermieri Pyetje: 253

Hipoglicemia trajtohet me dhënie të:

- A) kaliumit
- B) antibiotikëve
- C) bikarbonat natriumit
- D) perfuzioneve me glukozë 5%





Infermieri Pyetja: 254

Periudha neonatale quhet periudha që përfshin:

- A) 20 ditët e para të jetës
- B) 28 ditët e para të jetës
- C) 30 ditët e para të jetës
- D) 40 ditët e para të jetës

Infermieri Pyetja: 255

Ushqyerja me sondë nazo-gastrike behet në fëmijët me:

- A) ikter
- B) frakturë të klavikulës
- C) buzë dhe qelzë të carë
- D) asfiksi



Infermieri Pyetja: 256

Cili lindje është shkaktare për një lindje asfiktike?

- A) Ne term
- B) Me sexio-cezarea
- C) Post - term
- D) Podalike

Infermieri Pyetja: 257

Me çfarë trajtohet nje infeksion umbilikal?

- A) Antibiotic
- B) Natri-bikarbonat
- C) Alkool 70 gradë
- D) Perfuzionel/V



Infermieri Pyetje: 258

Cili nga këta faktorë nuk ndikon në shfaqjen e diabetit?

- A) Moshë e fëmijës
- B) Kequshqyerja ose humbja në peshë
- C) Higjiena e pastër
- D) Mosruajtja e mirë e ushqimeve

Infermieri Pyetje: 259

Në cilën nga shkallët e dehidrimit është shprehur saktë rënia e peshës trupore?

- A) Dehidrim i lehtë = 10 %
- B) Dehidrim mesatar mbi 10%
- C) Dehidrim i rëndë = 10%
- D) Dehidrim i rëndë > 10%

Infermieri Pyetje: 260

Cili nga faktorët nuk është shkaktar i obezitetit?

- A) Metabolik
- B) Trashëgues
- C) Nënushqyerja
- D) Psikologjik

Infermieri Pyetje: 261

Cila nga kujdesjet nuk bën pjesë në trajtimet e anoreksisë?

- A) Kujdesi ndaj malnutricionit
- B) Fillimi i një diete të pasur dhe me lëngje
- C) Mbështetja psikologjike
- D) Përdorimi i laksativëve



Infermieri Pyetje: 262

Cili nuk hyn në shkaktarët e stomatitit?

- A) Sëmundjet sistemike
- B) Traumat
- C) Dalja e dhëmbëve
- D) Higjena e pastër

Infermieri Pyetje: 263

Kandidoza orale është:

- A) Infeksion kërpudhor
- B) Inflamacion i mukozave orale
- C) Ulcer e membranave të mukozave të gojës
- D) Sëmundje sistemike



Infermieri Pyetje: 264

Cili është ekzaminimi që përcakton llojin e parazitit në fece?

- A) Gjak komplet
- B) Urokulturë
- C) Koprokulturë
- D) Sputum

Infermieri Pyetje: 265

Në cilin helmim nuk këshillohet nxitja e të vjellave?

- A) Medikamentet
- B) Ushqyerja
- C) Salicilatet
- D) Lëndët gërryese





Infermieri Pyetje: 266

Cili nga këto nuk është shkaktar i shfaqjes së alergjive?

- A) Ushqimi
- B) Medikamentet
- C) Mungesa e hekurit
- D) Pluhurat

Infermieri Pyetje: 267

Në mjekimin e shokut anafilaktik nuk ndikon:

- A) Adrenalina
- B) Ultrakorteni
- C) Aspirina
- D) Antihistaminikët



Infermieri Pyetje: 268

Cila nga simptomat e mëposhtme nuk vërehet në sëmundjen e serumit?

- A) Edema
- B) Eritema
- C) Hipotirozë
- D) Edeme laringu

Infermieri Pyetje: 269

Cila është zona ku nuk shfaqet dermatiti seborroik?

- A) Skalpi
- B) Balli
- C) Zona inguinale
- D) Shputat e këmbëve



Infermieri Pyetje: 270

Cili nga këta shkaktarë nuk është përgjegjës për mungesën e vitaminës D?

- A) Niveli i ulët social-ekonomik
- B) Keqpërthithja e lëndëve ushqimore
- C) Ekspozimi në diell
- D) Banimi në zona të ndotura

Infermieri Pyetje: 271

Cila nga këto vitamina mund të sintetizohet nga organizmi ?

- A) Vitamina A
- B) Vitamina B
- C) Vitamina C
- D) Vitamina D

Infermieri Pyetje: 272

Deformimet kockore të avitaminozës D prekin të gjitha të poshtëshënuara përveç:

- A) Toraksin
- B) Kockat e fytyrës
- C) Anësitë
- D) Kockat e kokës

Infermieri Pyetje: 273

Cila nuk është e saktë, në shenjat e fëmijëve me hipotiroide, në lindje?

- A) Ikteri fiziologjik
- B) Dalje e shpejtë jashtë
- C) Probleme respiratore
- D) Vështirësi në ushyerje



Infermieri Pyetje: 274

Cila nga këto shenja nuk bën pjesë në sëmundjen e osteomielitit?

- A) Temperturë e lartë
- B) Zona e prekur e skuqur dhe e nxehtë
- C) Epistaksis
- D) Gjymtyrë e dhimbshme

Infermieri Pyetje: 275

Cili regjion nuk preket nga osteomieliti?

- A) Tibian
- B) Shputat e këmbëve
- C) Humerusi
- D) Shputat e duarve



Infermieri Pyetje: 276

Cili nga parametrat ndryshon shumë në osteomielit?

- A) Eritrocitet
- B) Leukocitet
- C) Hemoglobina
- D) Hematokriti

Infermieri Pyetje: 277

Cilin nga indet apo organet prek artriti?

- A) Veshkën
- B) Mushkëritë
- C) Kycet
- D) Pankreasin



Infermieri Pyetje: 278

Cila nga këto shenja nuk bën pjesë në artrit?

- A) Inflamacion lokal
- B) Lëvizjes spontane të kyceve
- C) Humbje të vetëdijes
- D) Temperaturë

Infermieri Pyetje: 279

Cili nga ekzaminimet e mëposhtme është i zgjedhuri në defektet e lindura të zemrës?

- A) Skaner
- B) Radiografi
- C) Rezonancë
- D) Ekografi

Infermieri Pyetje: 280

Cili nga të mëposhtmet nuk e shkakton artritin?

- A) E. Coli
- B) Haemophilus influenzae
- C) Salmonela
- D) Stafilokok

Infermieri Pyetje: 281

Cili pohim nuk është i saktë në ndërhyrjet post - operatore të tonsilitit?

- A) Monitorimi
- B) Pozicionohet shtrirë dhe drejtë
- C) Vlerësohet për shenjat e hemoragjisë
- D) Fillohen perfuzione I/V



Infermieri Pyetje: 282

Skarlatina shkaktohet nga:

- A) Bordetella pertusis
- B) Corynae bacterium diphtheriae
- C) Streptokoku B hemolitik i grupit A
- D) Bakteriet

Infermieri Pyetje: 283

Cila nga shenjat e mëposhtme nuk është e saktë, në rihnit?

- A) Teshtitje
- B) Obstruksion i rrugëve të frymëmarrjes
- C) Temperaturë
- D) Sekrecione



Infermieri Pyetje: 284

Cila nga këto sëmundje nuk bën pjesë në LTB(laringo-trakeo -bronkitit)?

- A) Laringotrakeiti
- B) Epiglottis
- C) Bronkioliti
- D) Trakeiti bakterial

Infermieri Pyetje: 285

Cila nga këto shenja nuk bën pjesë në laringo-trakeo -bronkitit?

- A) Temperaturë
- B) Dhimbje fyti
- C) Melena
- D) Vështirësi në frymëmarrje





Infermieri Pyetje: 286

Cila nuk bën pjesë në ndërhyrjet e laringo-trakeo-bronkitit?

- A) Ruajtja e pastër e rrugëve ajrore
- B) Dhënia e oksigjeno-terapisë
- C) Plotësimi i nevojave me lëngje
- D) Dhënia e vitaminës D

Infermieri Pyetje: 287

Cila nuk bën pjesë në kujdesin për pulmonet?

- A) Dhënia e Heparinës
- B) Aerozoloterapia
- C) Aspirimi i sekrecioneve
- D) Oksigjenoterapia



Infermieri Pyetje: 288

Cili nga medikamentet e mëposhtme nuk jepet në astmën bronkiale?

- A) Bronkodilatatorët
- B) Kortikosteroidet
- C) Levotiroksina
- D) Antiacidet





Infermieri Pyetje: 289

Cili nga aparatet e mëposhtme preket më shumë nga fibroza cistike?

- A) Genito-urinar
- B) I frymëmarrjes
- C) Kardio-vaskular
- D) Pankreasi

Infermieri Pyetje: 290

Në cilën nga të dhënat e mëposhme nuk bazohet diagnoza e fibrozës cistike?

- A) Në historinë e sëmundjes familjare
- B) Në mungesën e enzimave pankreatike
- C) Në dhimbjen abdominale
- D) Në rritjen e koncentrimin elektrolitik të djersës

Infermieri Pyetje: 291

Cili nga kriteret e mëposhtme, nuk është manifestim klinik madhor i etes?

- A) Karditis
- B) Poliartriti
- C) Artralgjia
- D) Eritema

Infermieri Pyetje: 292

Shkaktojnë endokardit bakterial të gjitha, me përjashtim të:

- A) Streptokoku
- B) Enterokoku
- C) Gonokoku
- D) Rikecia





Infermieri Pyetja: 293

Kemi anemi kur hemoglobina është:

- A) nën 12g/dl (6 - 12 vjec)
- B) 12g/dl (6 muaj - 6 vjec)
- C) 13g/dl (6muaj - 6 vjec)
- D) nën 11g/dl (6muaj - 12 vjec)

Infermieri Pyetja: 294

Cili nuk bën pjesë në efektet klinike të talasemisë major?

- A) Difektet në sintezën e hemoglobinës A
- B) Dobësim i strukturës së qelizave të kuqe të gjakut
- C) Rritje e numrit të leukociteve
- D) Jetëgjatësia e shkurtër e eritrocitit

Infermieri Pyetja: 295

Cilët nga elementët e analizës së gjakut, rriten në leucemi?

- A) Eritrocitet
- B) Hemoglobina
- C) Leukocitet
- D) Sedimenti

Infermieri Pyetja: 296

Cila nga nderhyrjet, nuk bën pjesë në ndërhyjet per IRA?

- A) Monitorimi i shenjave vitale
- B) Llogaritja me saktësi e marrjen dhe nxjerrjen e lëngjeve
- C) Administrimi i medikamentave
- D) Kryerja e ushtimeve fizike



Infermieri Pyetja: 297

Cilat nga indet e mëposhtme prek encefaliti?

- A) Brinjët e përparme të palsës së kurrizit
- B) Prek indin granular dhe sistemin nervor
- C) Prek parenkimën e trurit
- D) Prek aparatën e frymëmarrjes

Infermieri Pyetja: 298

Cili nga këto manifestime klinike tregon për sëmundjen e hemofilisë?

- A) Rënia në peshe
- B) Vështirësi në frymëmarrje
- C) Melena
- D) Të vjella

Infermieri Pyetja: 299

Cila nga këto shenja nuk bën pjesë në klinikën e bronkiolitit?

- A) Temperaturë 38- 39
- B) Dhimbje koke
- C) Vështirësi në frymëmarrje
- D) Konvulsione

Infermieri Pyetja: 300

Nuk është shkaktar i bronkopneumonisë bakteriale ?

- A) Bakteriet
- B) Streptokoku
- C) Pneumokoku
- D) Fruthi

Infermieri Pyetja: 301

Cila nga simptomat e mëposhtme nuk është e pranishme në meningit?

- A) Temperatura
- B) Cefaleja
- C) Rigiditeti nuchal
- D) çrregullim i ritmit të zemrës

Infermieri Pyetja: 302

Cila nuk bën pjesë në trajtimin e fëmijës me anemi?

- A) Aerosolo-terapia
- B) Dhënia e vit B12
- C) Dhënia Fe
- D) Dhënia e një diete të pasur me Fe

Infermieri Pyetja: 303

Nuk bën pjesë në ndërhyrjen e pacientëve me IRA (insuficiencë renale akute)?

- A) Kufizimi i kriprave
- B) Dhënia e antibiotiko-terapisë
- C) Bërja e dializës
- D) Oksigjenoterapia

Infermieri Pyetja: 304

Cila shenje nuk bën pjesë në manifestimet klinike të trombocitopenisë?

- A) Hematemezis
- B) Melena
- C) Hemoragji e gingivave
- D) Temperaturë



Infermieri Pyetja: 305

Meningiti është:

- A) Inflamacion i meningeve
- B) Inflamacion i zorreve
- C) Inflamacion i perikardit
- D) Sëmundje e trashëguar

Infermieri Pyetja: 306

Inkubacioni tek rubeola zgjat:

- A) 10-20 ditë
- B) 17-30 ditë
- C) 6- 7 ditë
- D) 14-21 ditë



Infermieri Pyetja: 307

Nuk është rruga e saktë e transmetimit të heptatitit B?

- A) Rruga aerogene
- B) Nga nëna shtatzanë te fetusit
- C) Rruga hematogene
- D) Me anë të pështymës

Infermieri Pyetja: 308

Cila është rruga e transmetimit të fruthit?

- A) Nëpërmjet frymëmarrjes, spërklave
- B) Rrugës hematogene
- C) Perfuzioneve I/V
- D) Kontaktit të lëkurës



Infermieri Pyetja: 309

Eneurezis nokturna është urinim:

- A) normal
- B) me ndërprerje
- C) i shpeshtë
- D) i pavullnetshëm natën

Infermieri Pyetja: 310

Përgjegjësia kryesore e veshkave është të mbaje konstant:

- A) volumin e lëngjeve
- B) frymëshkëmbimin
- C) ritmin e zemrës
- D) qarkullimin e gjakut

Infermieri Pyetja: 311

Cila nga përgjigjet nuk është e saktë për fëmijët me sindrom Down?

- A) Kanë qëndrim hypotonik
- B) Pëllëmba e dorës me rrudha
- C) Fytyra me pamje normale
- D) Gishti i madh i dorës i vecuar

Infermieri Pyetja: 312

Forma më e rëndë e krizave epileptike quhet:

- A) Humbje e vetëdijes
- B) Marrje mendsh
- C) Status epileptik
- D) Gjendje sinkopale



Infermieri Pyetje: 313

Në analizën e gjakut të fëmijëve me leuçemi kemi rritje:

- A) Të eritrociteve
- B) Hemoglobinës
- C) Hematokritit
- D) Leukociteve

Infermieri Pyetje: 314

Në purpurën trombocitopenike, ulja e trombociteve është nën:

- A) 150.000/mm³
- B) 140.000/mm³
- C) 130.000/mm³
- D) 120.000/mm³



Infermieri Pyetje: 315

Sa shkurtohet jeta e eritrocitit tek trombocitopenia?

- A) 2-4 dite
- B) 3-5 dite
- C) 6-8 dite
- D) 7-10 dite

Infermieri Pyetje: 316

Cili nga aparatet preket në 90% të rasteve nga fibroza cistike?

- A) Genito-urinar
- B) Kardiak
- C) Respirator
- D) SNQ





Infermieri Pyetje: 317

Cila nuk bën pjesë në shenjat e astmës bronkiale?

- A) Kolla e thatë
- B) Vështirësi në frymëmarrje
- C) Fishkëllima në ekspirim
- D) Urinim i pavullnetshëm

Infermieri Pyetje: 318

Dhënia e karbohidrateve ndihmon në:

- A) Kursimin e proteinave të organizmit
- B) Pakësimin e rezervave të glikogjenit
- C) Prodhimin e proteinave dhe glikogjenit
- D) Eliminimin e proteinave dhe glikogjenit

Infermieri Pyetje: 319

Fëmijët me kequshqyerje rrezikohen nga plaget e:

- A) dekubituseve
- B) kavitetit oral
- C) narinës
- D) lobit të veshit

Infermieri Pyetje: 320

Gjatë vitit të parë të jetës, fëmija duhet të marrë vitaminë D:

- A) 400 UI në ditë
- B) 1000 UI në ditë
- C) 2000 UI në ditë
- D) 2500 UI në ditë





Infermieri Pyetje: 321

Tetania është:

- A) Një gjendje e shtuar ekstabiliteti neuromuskular
- B) Një gjendje e pakësuar ekstabiliteti neuromuskular
- C) Një mungesë totale ekstabiliteti neuromuskular
- D) Një gjendje e shtimit dhe pakësimit në të njëjtën kohë

Infermieri Pyetje: 322

Ç'është Ketoacidoza diabetike?

- A) Shtim i theksuar i insulinës
- B) Mungesë e theksuar e insulinës
- C) Pakësim i kalciumit
- D) Pakësim i elektroliteve

Infermieri Pyetje: 323

Shkallët e dehidrimit janë:

- A) I lehtë 5%; mesatar 10%; i rëndë mbi 10%
- B) I lehtë 10%; mesatar 15%; i rëndë 20%
- C) I lehtë 15%; mesatar 20%; i rëndë 25%
- D) I lehtë 20%; mesatar 25%; i rëndë 30%

Infermieri Pyetje: 324

Nuk është shenjë klinike në vendosjen e trupave të huaj në bronke:

- A) Hemoragji nga hunda
- B) Kolla
- C) Kriza dispneje
- D) Wheezing



Infermieri Pyetje: 325

Trupat e huaj në trake manifestohen me:

- A) Vështirësi në frymëmarrje
- B) Mungesë kolle
- C) Skuqje të fytyrës
- D) Frymëmarrje normale

Infermieri Pyetje: 326

Nëse bronkoskopia rigide dështon:

- A) Është i nevojshëm trajtimi kirurgjikal
- B) Nuk është i nevojshëm trajtimi kirurgjikal
- C) Përdoren mënyra të tjera
- D) Nuk ekzistojnë mënyra të tjera

Infermieri Pyetje: 327

Virusi respirator sincicial tek bronkioliti është:

- A) Shkaku i vetëm
- B) Shkaku kryesor në mbi 50% të rasteve
- C) Nuk është shkak kryesor
- D) Nuk ekziston fare si mundësi

Infermieri Pyetje: 328

Matja e gazeve në gjak është e rëndësishme:

- A) Për të testuar influencën e tyre
- B) Për mbulimin e agjentit etiologjik
- C) Për të gjykuar gravitetin e sëmundjes
- D) Për kodifikimin e tyre

Infermieri Pyetje: 329

Bronkopneumonia takohet në:

- A) të gjitha moshat
- B) moshën e tretë
- C) adoleshencë
- D) parashkollorë

Infermieri Pyetje: 330

Disavantazhi i aeorozolit është:

- A) Medikamentet nuk absorbohen me shpejtësi
- B) Fëmija mund të kërkojë administrimin e tij shumë shpesh
- C) Medikamentet veprojnë me shpejtësi
- D) Minimizon efektet e përgjithshme

Infermieri Pyetje: 331

Ç'është hidroklortiaziti dhe përse përdoret?

- A) Diuretik dhe përdoret për të rritur diurezen
- B) Vitaminë dhe përdoret për rritje rezistence
- C) Antidepresiv dhe përdoret për gjendjet depresive
- D) Atropine dhe përdoret për relaksim e muskulaturës së pilorit

Infermieri Pyetje: 332

Procesi i kujdesjeve në pediatri përfshin:

- A) Moskryerjen e ekzaminimeve fizike
- B) Vendosjen e diagnozës
- C) Mjekimin e menjëhershëm
- D) Zbatimin e planeve të kujdesjeve

Infermieri Pyetja: 333

Vlerësimi për veten i përket gjykimit:

- A) personal
- B) përgjithësues
- C) asnjëherë
- D) pa subjekt

Infermieri Pyetja: 334

Për të parandaluar pasojat e ftohjes prematuri:

- A) vendoset në inkubator
- B) vendoset në një dhomë shtëpi që të jetë
- C) i vishen rroba të trasha
- D) Temperatura e dhomës të jetë sa më e lartë

Infermieri Pyetja: 335

Shpenzimi minimal i Oksigjenit ndodh kur temperatura sipërfaqësore e lëkurës është:

- A) 36.5 gradë celsius
- B) 36.8 gradë celsius
- C) 37 gradë celsius
- D) 37.2 gradë celsius

Infermieri Pyetja: 336

Te kujdesjet për lëkurën e fëmijës këshillohet:

- A) Përdorimi i sapunëve
- B) Përdorimi i locioneve alkaline
- C) Çdo lloj solucioni larës
- D) Jo çdo lloj solucioni



Infermieri Pyetja: 337

Nevojat themelore të fëmijës jane:

- A) Te jetës së përditshme
- B) Ushqimi dhe uji
- C) Mbajtja afër
- D) Ajër i pastër

Infermieri Pyetja: 338

Për të parandaluar fleksionin e qafës së fëmijës:

- A) Vendoset një jastëk nën shpatull
- B) Vendoset një jastëk nën kokë
- C) Vendoset një jastëk nën zonën e belit
- D) Nuk vendoset jastëk fare



Infermieri Pyetja: 339

Nëse ndërpritet ushqyerja me gji:

- A) Ulet niveli serik i bilirubinës
- B) Ngrihet niveli serik i bilirubinës
- C) Niveli serik i bilirubinës s'lëviz
- D) Niveli serik i bilirubinës ngrihet dhe ulet

Infermieri Pyetja: 340

Me rritjen e moshës së shtatzanisë:

- A) Frekuenca respiratore ulet
- B) Frekuenca respiratore ngrihet
- C) Frekuenca respiratore s'pëson ndryshim
- D) Ndryshimet respiratore janë të pakonsiderushme





Infermieri Pyetje: 341

Mekanizmat e thithjes dhe të tretjes:

- A) Përcaktohen pas lindjes
- B) Përcaktohen para lindjes
- C) Përcaktohen shumë më vonë
- D) Nuk përcaktohen absolutisht

Infermieri Pyetje: 342

Disa nga faktorët që shkaktojnë asfiksionë janë:

- A) Moshë e nënës, e shtatzënisë
- B) Lindjet në kohë, barrë e rregullt
- C) Mospërdorimi i medikamenteve
- D) Problemet psikologjike



Infermieri Pyetje: 343

Janë shenja të infeksionit tek i porsalinduri përveç:

- A) Lëkurë e zbehtë në ngjyrë gri
- B) Pin mirë gjirin
- C) Çrregullime të frekuencës respiratore dhe kardiake
- D) Ulje të temperaturës

Infermieri Pyetje: 344

Traumat e indeve të buta shkaktohen:

- A) Kur ka disproporcion cefalopelvik
- B) kur nuk ka disproporcion pelvik
- C) Kur ka proporcion cefalopelvik
- D) Si pasojë e dëmtimeve të ndryshme





Infermieri Pyetja: 345

Në hemoragjitë umbilikale injektohet vitamine:

- A) D për parandalim
- B) A për parandalim
- C) K për parandalim
- D) C për parandalim

Infermieri Pyetja: 346

Edemat serosanguine:

- A) Nuk janë leziona cefalike
- B) Janë leziona cefalike
- C) Janë leziona cefalo-pelvike
- D) Nuk janë leziona të asnjë lloji

Infermieri Pyetja: 347

Stenoza e pilorit është:

- A) Bllokim hipertrofik i muskulit rrethues të kanalit të pilorit
- B) Zgjerim i muskulit rrethues të kanalit të pilorit
- C) Bllokimi dhe zgjerimi në të njëjtën kohe i muskulit rrethues
- D) Çrregullim Hidro-elektrolitik

Infermieri Pyetja: 348

Obeziteti shoqërohet me:

- A) Pasoja mjekësore, psikologjike
- B) Vetëm pasoja mjekësore
- C) Vetëm pasoja psikologjike
- D) Luhatje sipërfaqësore





Infermieri Pyetje: 349

Medikamentet që shkaktojnë humbjen në peshë tek anoreksikët janë:

- A) Laksativët, diuretikët
- B) Imipramina, deprimina
- C) Antepar, povan
- D) Aspirina, Fe sulfat

Infermieri Pyetje: 350

Në rastet e një reaksioni të rëndë nga pickimi i grerëzës apo bletës:

- A) Bëhet lavazh stomaku
- B) Injektohet vit.K
- C) Bëhet adrenalinë e ultrakorten
- D) Injektohet vit A+D



Infermieri Pyetje: 351

Alergjia është:

- A) Hipersensibilitet ndaj një substance
- B) Hiposensibilitet ndaj një substance
- C) Përqasje e virozave të stinës
- D) Komplikacion nga substancat toksike

Infermieri Pyetje: 352

Eritroblastozë fetale quhet ndryshe sëmundje:

- A) hemolitike e të porsalindurit
- B) ikterike e të porsalindurit
- C) bakteriale e të porsalindurit
- D) e sistemit respirator e të porsalindurit





Infermieri Pyetja: 353

Me çfarë trajtohet hipokalcemia?

- A) Kalcium
- B) Glukozë
- C) Serum
- D) Oksigjen

Infermieri Pyetja: 354

Me çfarë trajtohet hipoglicemia?

- A) Trisol
- B) Kalcium
- C) Perfuzion solucion glukoze
- D) Vitamine A

Infermieri Pyetja: 355

Mamia di që faza e parë e lindjes është :

- A) Dalja e placentës
- B) Dilatacioni
- C) ExpulSIONI
- D) Rikuperimi i gruas

Infermieri Pyetja: 356

Shenjat klinike më të zakonshme në pacientet me enfizemë pulmonare janë:

- A) Prania e sputumit
- B) Ortopnea
- C) Lodhja
- D) Dispnea



Infermieri Pyetja: 357

Infermieri/a e vlerëson pacientin me bronkit kronik për:

- A) Fryrje abdominale
- B) Kequshqyerje
- C) Cianoza
- D) Dispnea

Infermieri Pyetja: 358

Gjatë një ataku azmatik infermieri e vlerëson pacientin për :

- A) Kollë produktive
- B) Obstruksion respirator
- C) Ortopne
- D) Ankthin

Infermieri Pyetja: 359

Shenjat e kufizimit respirator ,në momente qetësie zakonisht zhduken në :

- A) Insufiçensë repiratore
- B) Asthma bronkiale
- C) Bronkitin kronik
- D) Emphizemë

Infermieri Pyetja: 360

Diagnozat e mundshme infermirore në asthmën bronkiale janë:

- A) Reduktimi I rrezikut për infeksion
- B) Përmirsimi I shkëmbimit të gazeve
- C) Intolerance e aktiviteteve
- D) Reduktimi I ankthit



Infermieri Pyetje: 361

Gjeni përgjigjen e saktë

- A) Leukocitet në urinë nuk tregojnë praninë e infeksionit
- B) Prania e eritrociteve në urinë është gjithnjë tregues i prekjes renale
- C) Proteinuria është karakteristike e uretriteve
- D) Mund të ndodhë bakteriuriasimptomatike

Infermieri Pyetje: 362

Sistemet e shpërndarjes së oksigjenit me ritëm të lartë janë:

- A) Maska pa rithithje të ajrit
- B) Maska me rithithje të ajrit
- C) Maska venturë
- D) Kanjula nazale

Infermieri Pyetje: 363

Në hipertirozë janë të gjitha shenjet me përjashtim të:

- A) Takikardisë
- B) Shkurtim të reflekseve
- C) Shtim në peshë
- D) Çrregullim të ciklit menstrual

Infermieri Pyetje: 364

Toksiciteti i mushkërive me O₂ jep dëmtime të tyre të tilla si:

- A) Dhembje substernale
- B) Koll productive
- C) Ortopne
- D) Temperaturë





Infermieri Pyetja: 365

Kërkesat për oksigjen zakonisht rriten në gjendje të tilla si:

- A) Edemë polmonare
- B) Hemoragji polmonare
- C) Membrana hyaline
- D) Gjendjet septike

Infermieri Pyetja: 366

Agjentët mukolitike në pacientët me probleme respiratore përdoren në kolla:

- A) me sekrecione trasha
- B) jopruduktive
- C) pa sekrecione
- D) produktive



Infermieri Pyetja: 367

Në hipotireozë kemi situatën e mëposhtme hormonale:

- A) Rritje të T3, T4 dhe rritje të TSH
- B) Rritje të T3, T4 dhe ulje të TSH
- C) Ulje të T3, T4 dhe rritje të TSH
- D) Ulje të T3, rritje të T4 dhe ulje të TSH

Infermieri Pyetja: 368

Përdorimi i anksiolitikëve është më produktiv gjatë gjendjeve të tilla si:

- A) Emboli pulmonare
- B) Emphyzemë pulmonare
- C) Atelektazë pulmonare
- D) Atak azmatik





Infermieri Pyetja: 369

Edukimi shëndetësor i pacientit me probleme respiratore bëhet nëpërmjet:

- A) Përmiresimit të marrjeve ushqimore
- B) Përmiresimit te natyrës se frymemarrjes
- C) Përmiresimit të ankthit
- D) Terapisë relaksuese

Infermieri Pyetja: 370

Rritje të rasteve me TBC ka pasur vitet e fundit në pacientët me :

- A) hepatit B kronik
- B) hepatit C
- C) HIV
- D) IST



Infermieri Pyetja: 371

Artriti rheumatoid nuk ka karakteristikë:

- A) Prekjen e artikulacioneve të vogla
- B) Eritemën marginale
- C) Fenomenin Raynaud
- D) Karakterin simetrik të prekjes artikulare

Infermieri Pyetja: 372

Vlersimi infermieror i një pacienti me TBC bëhet nëpërmjet:

- A) Gjendje e përgjithshme septike me temperature
- B) Prezantimit të simptomave
- C) Të dhënave objektive
- D) Të dhënave subjektive





Infermieri Pyetja: 373

Zakonisht pacientët të cilët kanë sëmundjen e TBC:

- A) Kanë temperature
- B) Nuk kanë fare temperaturë
- C) Kanë temperature subfebrile
- D) Temperatura nuk është kriter vlerësimi

Infermieri Pyetja: 374

Në rastin e aplikimit të testit të tuberkulinës, zona e skuqjes së lëkurës është reaksion pozitiv:

- A) me diameter 5 mm
- B) me l madh se 10mm
- C) me l vogel se 10mm
- D) me diameter 10mm



Infermieri Pyetja: 375

Vaksina e BCG jep mbrojtje efektive për pacientët për:

- A) Zakonisht per 5 vjet
- B) Zakonisht per 10 vjet
- C) Zakonisht per 15 vjet
- D) Për 20 vjet

Infermieri Pyetja: 376

Shkaktari më i shpeshtë i embolisë pulmonare është:

- A) Cdo substancë që depërton në qarkullim
- B) Nje copë garze ose pambuk
- C) Nje copë age metalike
- D) Nje koagul gjaku



Infermieri Pyetja: 377

Angina pectoris është gjendje në të cilën kemi:

- A) Imbalancë e përhershme e muskulit kardiak nga oksigjeni
- B) Imbalancë e përkohshme nga oksigjeni
- C) Deprivim i përgjithshëm nga oksigjeni
- D) Nekrotizim i përkohshëm

Infermieri Pyetja: 378

Ndër faktorët e modifikushëm të sëmundjeve te arterieve koronare janë:

- A) Historia familjare
- B) Stresi
- C) Seksi
- D) Mosha

Infermieri Pyetja: 379

Cila nga të dhënat e mëposhtme nuk i përket endokarditit:

- A) Zmadhim total i zemrës
- B) Temperaturë, palpitacione
- C) Djersë të shtuara, dispne
- D) Kollë me sekrecione të shumta hemoragjike

Infermieri Pyetja: 380

Cila është veçoria me tipike e angina pectoris?

- A) Dhembja substernale
- B) Ndodh pa ndonjë shkaktar
- C) Zakonisht zgjat 30 minuta
- D) Lehtësohet vetëm me opioide

Infermieri Pyetje: 381

Zakonisht pacientët që kanë dizorientim dhe konfuzion mendor janë:

- A) Të moshës mesme post- infarkt
- B) Të moshës vjetër post-infarkt
- C) Më shumë burrat post- infarkt
- D) Më shumë gratë post- infarkt

Infermieri Pyetje: 382

Në pacientët të cilët vuajnë nga angina ose infarkt gjatë observimit të përgjithshëm
verejmë:

- A) Me anë të palpacionit shohim që lëkura është e ngrohtë
- B) Me anë të prekjes ndjejmë që lëkura është e ftohtë
- C) Observimi me sy shohim djersitje
- D) Mungesë e pranisë së djersve

Infermieri Pyetje: 383

Cili nga shkaktarët e mëposhtëm nuk i përket pankreatitit:

- A) Gurët biliare, hiperlipidemia
- B) Ndërhyrjet kirurgjikale
- C) Infeksionet virale
- D) Osteoporoza dhe varfërimi me kalcium



Infermieri Pyetje: 384

Nitroglicerina jepet nga infermieri/a zakonisht me rrugë:

- A) i.m
- B) i.v
- C) s/c
- D) sublinguale

Infermieri Pyetje: 385

Gjeni përgjigjen e gabuar për Kolutin ulceroz:

- A) Karakterizohet nga ulceracione të shumta të zorrës
- B) Prek kryesisht duodenin
- C) Shoqërohet me rënie në peshë dhe diarre
- D) Kolonoskopia vendos diagnozën

Infermieri Pyetje: 386

Një pacient i cili ka kaluar infarkt miokardi zakonisht për tu shëruar plotësisht i duhen:

- A) Me pak se 4 jave
- B) Zakonisht 5-6 jave
- C) Duhet 6-8 jave
- D) Në 10 jave shërohen plotësisht

Infermieri Pyetje: 387

Osteoartriti prek më shumë regjionin cervikal në nivelin:

- A) C2-C3
- B) C3-C4
- C) C4-C5
- D) C4-C6





Infermieri Pyetja: 388

Gjeni përgjigjen e gabuar:

- A) HTA sekondar ka patologjitë renale si shkaktarë më të shpeshtë
- B) HTA kemi vetëm në rastet kur presioni sistolik është mbi 160 mmHg
- C) Hipertrofia kardiake është karakteristike e HTA kronik
- D) Preken nga HTA më shumë meshkujt se sa femrat

Infermieri Pyetja: 389

Gjeni përgjigjen e saktë:

- A) Nekroza miokardiale është proces i rikthyeshëm
- B) Obeziteti nuk është faktor predispozues për Infarkt Akut të Miokardit
- C) Preken më shumë femrat se meshkujt nga Infarkti Akut i Miokardit
- D) Duhanpirja është ndër faktorët etiologjikë më të shpeshtë të Infarktit Akut të

Miokardit



Infermieri Pyetja: 390

Menaxhim kirurgjikal në osteoartrit do të thotë:

- A) Rivendosje e pjeshme e kyçit
- B) Osteotomi
- C) Heqje e pjeshme e kyçit
- D) Rivendosje totale e kyçit

Infermieri Pyetja: 391

"Ngurtësimi mengjezor" është shenjë tipike për pacientët me :

- A) Osteoartrit
- B) Artriti reumatoid
- C) Asnjëra
- D) Hernie diskale te regjionit lumbar



Infermieri Pyetje: 392

Një kyç i ngrohtë dhe i enjtur tregon për:

- A) Rritje e furnizimit me gjak në atë pjesë të kyçit
- B) Grumbullim jonormal i gjakut venoz në atë pjesë të kyçit
- C) Inflamacion
- D) Infeksion

Infermieri Pyetje: 393

Gastriti kronik shoqërohet me :

- A) Infeksion
- B) Inflamacion
- C) Lezione në tru
- D) Insuficiencë renale

Infermieri Pyetje: 394

Terapia antiacide nuk lehtëson gjendjen në:

- A) Gastritin kronik
- B) Gastritin atrofik
- C) Gastritin akut
- D) Në ulçeren gastrike

Infermieri Pyetje: 395

Vitamina B12, e rëndësishme si antianemik, sekretohet nga mukoza:

- A) e pemës bronkiale
- B) intestinale
- C) gastrike
- D) e ezofagut

Infermieri Pyetje: 396

Gjeni përgjigjen e saktë:

- A) Insuficiencia renale shoqërohet me ulje të kreatininës
- B) Mungesa e eritropoetinës është karakteristike e insuficiencës renale
- C) Proteinuria tregon për dëmtim tëndjeshëm të filtracionit glomerular
- D) Dializa është një ndër opsionet terapeutike

Infermieri Pyetje: 397

Shkaktar të tilla si helicobacter pilori, duhani, stresi janë tipike për:

- A) Gastritin akut
- B) Gastritin kronik
- C) Gastritin atrofik
- D) Ulçeren peptike

Infermieri Pyetje: 398

Triada discomfort - dhembje - urth janë tipike për ulçerën :

- A) gastrike
- B) peptike
- C) duodenale
- D) sipërfaqesore

Infermieri Pyetje: 399

Perforacioni i stomakut shkakton shok:

- A) septic
- B) hypovolemik
- C) hemoragjik
- D) endogjen



Infermieri Pyetje: 400

Shkaktarët më të zakonshëm të pielonefritit janë:

- A) Pseudomonas
- B) Enterobakteret
- C) E. Coli
- D) Klipsiella

Infermieri Pyetje: 401

Gjeni përgjigjen e gabuar

- A) Leucemia është mieloidë dhe limfoide
- B) Ulja e eritrocitëve është domosdoshmëri në leucemi
- C) Prek me shumë meshkujt se femrat
- D) Leucemia mund të jetë akute ose kronike



Infermieri Pyetje: 402

Trajtimi i pielonefritit bëhet nëpërmjet:

- A) Ndjekje e vazhdueshme në shtëpi
- B) Trajtimi me ilaçe
- C) Trajtimi kirurgjikal
- D) Hospitalizimi

Infermieri Pyetje: 403

Ulcera gastrike ndodh zakonisht në grup moshat:

- A) 50-60 vjeçarë
- B) 40-50 vjeçarë
- C) 30-40 vjeçarë
- D) 20-30 vjeçarë



Infermieri Pyetje: 404

Simptoma klinike karakteristike e pacientit me Cistit është:

- A) Urgjenca për të urinuar
- B) Anuri
- C) Oliguri
- D) Temperaturë e ulët

Infermieri Pyetje: 405

Gjeni përgjigjen e gabuar: në astmën bronkiale kemi:

- A) Respiracion të shpeshtë
- B) Spirometria tregon rritje të kapacitetit pulmonar
- C) Dhimbje të krahërorit
- D) Kollë të forte

Infermieri Pyetje: 406

Në aneminë ferrodificitare gjejmë të gjitha përveç:

- A) Ferritinemi të ulur
- B) Rritje të hemoglobinës
- C) Hipokromi
- D) Ulje të hematokritit

Infermieri Pyetje: 407

Gjeni përgjigjen e saktë:

- A) Hiperuricemia nuk shkakton patologji reumatizmale
- B) Dhimbjet me karakter inflamator nuk ndeshen në qetësi
- C) Polimialgjia gjendet vetëm në sëmundjet reumatizmale
- D) Osteoporoza prek më shumë femrat se meshkujt



Infermieri Pyetje: 408

Gjeni përgjigjen e gabuar:

- A) Neuropatia monitorohet përmes ENG
- B) Fundus okuli është ekzaminim i domosdoshëm tek diabetikët
- C) HbA1C nuk është tregues i saktë i hiperglicemive
- D) Peptidi C tregon për sasinë e saktë të insulinës së prodhuar nga pankreasi

Infermieri Pyetje: 409

Tek pacienti me insuficiencë renale kronike, manifestimet hematologjike përfshijnë, anemine, e cila manifestohet me:

- A) temperaturë
- B) dhimbje
- C) zbehje
- D) të vjella

Infermieri Pyetje: 410

Tek pacientet me insuficiencë renale kronike, infermieri monitoron sasinë e kaliumit të marrë, pasi hiperkalemia mund shkaktojë:

- A) Disritmi kardiake
- B) Hypertension
- C) Edema
- D) Te vjella

Infermieri Pyetje: 411

Tek pacientet me insuficiencë renale kronike, infermieri siguron kujdesje për çdo zonë ku integriteti i lëkurës është i demtuar; kjo është e rëndësishme për të :

- A) Zvogëluar rrezikun për infeksione
- B) Është një kujdesje rutine nga ana e infermierit
- C) Është e rëndësishme për higjienën e pacientit
- D) Nuk është faktorë pedipozues





Infermieri Pyetja: 412

Në diabetin mellitus janë të pranishme të gjitha shenjat përveç njërës:

- A) Polidipsia
- B) Polifagia
- C) Galaktorrea
- D) Poliuria

Infermieri Pyetja: 413

Per te reduktuar konstipacionin, me qellim qe pacienti te kete nje aktivitet normal te zorreve eshte e rendesishme:

- A) Nje diete me permbajtje fibrash
- B) Nje diete pikante
- C) Jete sedentare
- D) Sa me pak aktivitet



Infermieri Pyetja: 414

Trajtimi primar i pacienteve me anemi nga mungesa e Fe, eshte:

- A) Rritja e marrjeve orale te hekurit nepermjet ushqimit
- B) Aktiviteti fizik
- C) Sa me shume likide
- D) Regjim shtrati

Infermieri Pyetja: 415

Ne trajtimin e pacienteve me anemi aplastike themelore jane:

- A) Transfuzionet e gjakut
- B) Dieta
- C) Likidet
- D) Aktiviteti





Infermieri Pyetja: 416

Tek pacientet me anemi , shmangia e lodhjes, eshte e rendesishme qe:

- A) Pacienti te mos perjetoje lodhje gjate kryerjes se aktiviteteve ditore
- B) Eshte nje kujdes rutin
- C) Nuk eshte e rendesishme per pacientin
- D) Aktivizon pacientin

Infermieri Pyetja: 417

Qarko nje nder simptomat karakteristike te semundjes se diabetit mellitus:

- A) Polifagi
- B) Fotofobi
- C) Anuri
- D) Edem



Infermieri Pyetja: 418

Cirroza hepatiche ka si shkaktar te gjithë shkaqet e poshtëshënuar përveç njërit:

- A) Konsumimin e alkoolit
- B) Dëmtimet e rrugëve biliare
- C) Ulcerën duodenale
- D) Hepatitin autoimun

Infermieri Pyetja: 419

Limfomat Hodgkin jane semundje malinjizante qe mund te zhvillohen ne cdo grup moshe, por, piken me te madhe te incidences e ka ne moshat e reja:

- A) 10-vjecare
- B) 20-vjecare
- C) 30-vjecare
- D) 40-vjecare



Infermieri Pyetja: 420

Per infermierin qe kujdeset per pacientin me Leucemi, objektivi kryesor eshte :

- A) Ta mbroje ate nga infeksionet
- B) Te parandaloje te vjellat
- C) Te qetesoj nauset
- D) Te qetesoj familjaret

Infermieri Pyetja: 421

Per shkak se prodhimi I palces normale eshte shume I kufizuar ne pacientet me leucemi, kjo e vendos pacientin ne rrezik te madhe:

- A) per hemoragji
- B) per nausea
- C) te vjella
- D) temperature

Infermieri Pyetja: 422

Diabeti mellitus eshte nje semundje kronike qe ndikon ne :

- A) Shume organe dhe sisteme te organizmit
- B) Ne te gjithe organizmin
- C) Pothuaj nuk ndikon ne organet dhe sistemet e organizmit
- D) Prek vetem nje organ te organizmi

Infermieri Pyetja: 423

Mungesa e insulines ndalon qelizat qe :

- A) Te perdorin glukozen si burim energjie
- B) Nuk eshte e rendesishme per organizmin
- C) Eshte fatale ne organizem
- D) Ndikon disi ne mbarvajtjen e organizmit

Infermieri Pyetje: 424

Një ndër faktorët predispozues të infeksioneve të traktit urinar është:

- A) Anomalia strukturale dhe funksionale e traktit urinar
- B) Refluksi ezofageal
- C) Gastritët
- D) Diarret

Infermieri Pyetje: 425

Cistiti jo-infeksioz mund të rezultojë nga:

- A) ekspozimi në agjent kimik
- B) ekspozimi në agjent infeksioz
- C) ekspozimi në temperatura të larta
- D) sëmundje të ndryshme

Infermieri Pyetje: 426

Një ndër vendet ku është lokalizuar edema në pacientët me Cirroze është :

- A) Fytyra
- B) Kapakët e syve
- C) Sakrumi
- D) në të gjithë trupin

Infermieri Pyetje: 427

Hypokalemia kronike që takohet tek bulemikët rezulton nga:

- A) Abuzimi me laksativ
- B) Abuzimi me alkool
- C) Abuzimi me kafein
- D) Aktivitet i tepruar

Infermieri Pyetje: 428

Në pankreatitin akut nuk gjejmë:

- A) Amilazën e rritur
- B) Lipazën e rritur
- C) Eritopoetinën e rritur
- D) Kalcifikime të pankreasit

Infermieri Pyetje: 429

Psikoterapia tek pacientë me bulëmi nervore është e rëndësishme dhe ka si qëllim:

- A) Rritjen e vet-vleresimit
- B) Është një procedurë rutinë
- C) Nuk ka ndonjë qëllim të caktuar
- D) Ndikon në ushqyerjen e pacientit

Infermieri Pyetje: 430

Shkaktari kryesor i Cistitit është:

- A) Bakteri koliform
- B) Insulin
- C) Acetilkolina
- D) Dopamine

Infermieri Pyetje: 431

Bronhektazia karakterizohet nga të gjithë elementet me përjashtim të:

- A) Kollë kronike me sputum purulent
- B) Hemoptizia
- C) Elemente kutane purpurik
- D) Dispne dhe cianoze

Infermieri Pyetje: 432

Kolecistiti kronik nuk karakterizohet nga:

- A) Dhimbje të forta në zonën epigastrike
- B) Të vjella biliare
- C) Temperaturë subferile
- D) Rritje e amilazës dhe lipazës

Infermieri Pyetje: 433

Qarko një ndër simptomat karakteristike të sëmundjes së diabetit insipid:

- A) Diureza masive
- B) Fotofobia
- C) Anuria
- D) Edema



Infermieri Pyetje: 434

Diabeti insipid nefrogenik rezulton nga:

- A) Një defekt I trashëgueshem
- B) Tumoret në regionin hypothalamic-petuitar
- C) Trauma në koke
- D) Tumoret metastazike

Infermieri Pyetje: 435

Pielonefriti akut është :

- A) Infeksioni akut I traktit të sipërurinar
- B) Pezmatimi I fshikëzës urinare
- C) Pezmatimi I uretrës
- D) Pezmatimi I prostatit



Infermieri Pyetje: 436

Një ndër shkaktarët sekondarë të glomerulonefritit kronik është:

- A) Stafilokoku
- B) Streptokoku beta hemolitiki grupit A
- C) Lupus sistemik eritematoz
- D) Hepatitis A

Infermieri Pyetje: 437

Një ndër shkaktarët primar të glomerulonefritit akut është:

- A) sklerodermia sistëmiqe progresive
- B) purpura trombocitopenike
- C) poliartriti nodular
- D) sifilizi



Infermieri Pyetja: 438

Azotemia prerenale në pacientë me insuficiencë renale akute karakterizohet me një nga simptomat e mëposhtme:

- A) Ndryshime në sasinë ose aparencën e urinës
- B) Hipotension arterial
- C) Diarre
- D) Konstipacion

Infermieri Pyetja: 439

Agjenti shkaktar i hepatitit A përhapet nëpërmjet rrugës:

- A) Hematogjene
- B) Oralo-fekale
- C) Kontakti me plagë të kontaminuar
- D) Kontakti me ujë të kontaminuar

Infermieri Pyetja: 440

Periudha e inkubacionit të hepatitit A është:

- A) 2-3 javë
- B) 2-6 javë
- C) 2-9 javë
- D) 2-12 javë

Infermieri Pyetja: 441

Gastriti kronik shkakton dhimbje epigastrike e cila:

- A) Lehtesohet nga marrja e ushqimit
- B) Perkeqesohet nga marrja e ushqimit
- C) Nuk ndikon ne dhimbje marrja ose jo e ushqimit
- D) Lehtesohet me likide



Infermieri Pyetja: 442

Tek cirrotiket, rekomandohet administrimi I Laktulozes per arsye se:

- A) Eleminon amoniakun nepermjet feceve
- B) Eshte pjese e kujdesit
- C) Nuk eleminon amoniakun
- D) Ndikon ne permiresimin e klinikes

Infermieri Pyetja: 443

Faktoret familjare dhe gjenetik luajne nje rol te rendesishem ne obezitet. Kur te dy prinderit jane obese sa % e femijeve lindin te tille:

- A) 80 % e femijeve
- B) 60 % e femijve
- C) 40% e femijve
- D) 20% e femijve



Infermieri Pyetja: 444

Nje person percaktohet si obez kur, pesha e tij eshte:

- A) 45-50 % mbi peshen ideale
- B) 35-40 % mbi peshen ideale
- C) 25-30% mbi peshen ideale
- D) 15-20% mbi peshen ideale

Infermieri Pyetja: 445

Nje person percaktohet me obezitet morbid kur pesha e tij eshte:

- A) 80% mbi peshen ideale
- B) 60% mbi peshen ideale
- C) 40 % mbi peshen ideale
- D) 20 % mbi peshen ideale



Infermieri Pyetje: 446

Karaharori i pacientit merr një formë si fuçi (bucelë) në:

- A) Bronkit kronik
- B) Pneumoni
- C) Emfizemë
- D) Fibrozë cistike

Infermieri Pyetje: 447

Pacientët me SPOK (Sëmundje Pulmonare Obstruktive Kronike), preferohen të administrohen nëpërmjet inhalatimit sepse shpërnahet medikamenti direkt në mushkëri:

- A) Mukolitikët
- B) Sodium kromolin
- C) Bronkodilatatorët
- D) Antibiotikët

Infermieri Pyetje: 448

Në pacientët me Pneumoni aspekti më i rëndësishëm për edukimin e pacientëve dhe familjarëve është:

- A) Larja e duarve
- B) Pozicionimi
- C) Edukimi për shmangien e infeksioneve të traktit të sipërm respirator
- D) Shmangia e qëndrimit me këmbë të kryqëzuara

Infermieri Pyetje: 449

Në pacientët me SPOK, për të reduktuar inflamacionin në fyt dhe mushkëri: përdoren

- A) Mukolitikët
- B) Antikolinergjikët
- C) Sodium kromolin
- D) Kortikosteroidet

Infermieri Pyetje: 450

Testi i tuberkulizimit bëhet (injektohet) në mënyrë:

- A) Intravenoze
- B) Intradermale
- C) Intramuskulare
- D) Subkutane

Infermieri Pyetje: 451

Në pacientët me emboli pulmonare mjekët, që të mos lejojnë zmadhimin e embolës dhe të parandalojnë formimin e koagulave të reja, rekomandojnë:

- A) Analgjezik
- B) Antikoagulantë
- C) Antikolinergjikë
- D) Antibiotikë

Infermieri Pyetje: 452

Palpitacioni është:

- A) Një ndjenjë e të rrahurave të shpeshta në krahë
- B) Humbje e përkohshme e koshiencës
- C) Frymëmarrje e shkurtër
- D) Një tregues i qarkullimit periferial

Infermieri Pyetje: 453

Diferenca midis vlerave sistolike dhe diastolike është referuar si:

- A) Pulsacioni venoz
- B) Presion i pulsit
- C) Presion i gjakut paradoksal
- D) Presion postural i gjakut

Infermieri Pyetje: 454

Presioni i gjakut paradoksal është përkufizuar si një rënie e presionit sistolik më shumë se:

- A) 10 mmHg
- B) 20 mmHg
- C) 30 mmHg
- D) 40 mmHg

Infermieri Pyetje: 455

Vlerësimi i pulsacionit arterial i jep infermierit informacion për:

- A) Zhurmat
- B) Integritetin vascular dhe qarkullimin
- C) Temperaturën e lëkurës
- D) Cianozën periferiale

Infermieri Pyetje: 456

Shkaktari më i zakonshëm i insuficiencës kardiace është:

- A) Infarkti i miokardit
- B) Pneumonia
- C) Bronkiti kronik
- D) Astma bronkiale

Infermieri Pyetje: 457

Në pacientët me Insuficiencë kardiace, për të rritur kontrakturat dhe zvogëluar rrahjet e zemrës tradicionalisht rekomandohen:

- A) Diuretikë
- B) Betablokues
- C) Digitalikë
- D) Bronkodilatatorë



Infermieri Pyetja: 458

Në pacientët me hipertension, efekti anësor kryesor që shoqëron administrimin e diuretikëve është:

- A) Disfunksioni seksual
- B) Lodhja
- C) Depresioni
- D) Hypokalemia

Infermieri Pyetja: 459

Në pacientët me Infarkt Miokardi mjeku mund të përshkruajë morfinë sulfat për lehtësimin e diskomfortit. Shenjat e një intoksikimi me morfinë janë:

- A) Depresioni respirator-hypotensioni-të vjella të shumta
- B) Lodhje-hypoglicemi-hypokalemi
- C) Dhimbje koke-marrje mendsh-zbehtësi
- D) Dobesi-lodhje-marrje mendsh

Infermieri Pyetja: 460

Në pacientët me Angina Pectoris medikamenti fillestar i përshkruar kundër dhimbjes është nitroglicerina sublinguale. Nitroglicerina:

- A) Rishpërndan gjakun në drejtim të subendokardit
- B) Redukton ritmin dhe punën e zemrës
- C) Rrit kontrakturat
- D) Ka efekt të shpejtë shkarkues

Infermieri Pyetja: 461

Endokarditi infektiv i referohet:

- A) Inflamacionit të perikardiumit, qeses embriologjike që mbështjell zemrën
- B) Trashjes inflamatore kronike të perikardiumit që e shtyp zemrën
- C) Infeksionit bakteral ose fungal të endokardit, e cila përshin dhe valvulat
- D) Dëmtimeve inflamatore të gjitha shtresave të zemrës





Infermieri Pyetja: 462

Ankesa kryesore e një pacienti me Osteoartrit është:

- A) Dispnea
- B) Kolla
- C) Dhimbja e kyçeve
- D) Petekie

Infermieri Pyetja: 463

Nodulat Osler's apo lezionet Janeways konsiderohen manifestime klasike në pacientët me:

- A) Endokardit infektiv
- B) Perikardit
- C) Kardiomiopati
- D) Kardit reumatik



Infermieri Pyetja: 464

Manifestimi më i madh dhe zakonisht i vetmi në Lupusin diskoid është:

- A) Temperature lokale
- B) Lokalizimi i edemave
- C) Prania e rasheve të thata dhe të luspuara në fytyrë
- D) Hipertrofi e kyçeve

Infermieri Pyetja: 465

Për shkak se Lupus nefritis është një shkaktar i vdekjes, infermieri me vëmendje vlerëson për shenjat e përfshirjes së:

- A) sistemit respirator
- B) sistemit renal
- C) sistemit kardiak
- D) sistemit neurologjik





Infermieri Pyetja: 466

Për shkak se Lupusi Sistemik është një gjendje inflamatore, gjendja më e zakonshme tek këta pacientë është:

- A) Ethja
- B) Takikardia
- C) Dispnea
- D) Kolla

Infermieri Pyetja: 467

Kujdesi infermieror për një pacient me Sklerodermi përfshin:

- A) Përmirësimin dhe sigurimin e mos vajtjes në llixha dhe plazh
- B) Sigurimin e lëvizjes së artikulacioneve duke inkurajuar ushtrime të shumta
- C) Përdorimin e kremit mbrojtës kundër diellit
- D) Kujdesin ndaj perceptimit të familjarëve

Infermieri Pyetja: 468

Është një sëmundje inflamatore kronike e rrugëve të frymëmarrjes, në të cilën marrin pjesë shumë qeliza dhe element qelizorë, sidomos mastocitet, eozinofilet, dhe limfocitet T:

- A) Tuberkulozi pulmonar
- B) Embolia pulmonare
- C) Astma bronkiale
- D) Edema pulmonare





Infermieri Pyetje: 469

Glukokortikoidet inhalatore janë barnat mbajtëse më efikase në pacientët astmatikë. Ato:

- A) Frenojnë inflamacionin e rrugëve të ajrit, pakësojnë hiperaktivitetin bronkial, kontrollojnë dhe parandalojnë simptomat
- B) Janë bronkodilatatorë që bllokojnë efektin e acetilkolinës së çliruar nga nervat kolinergjikë në rrugët e ajrit
- C) Janë bronkodilatatorë që e relaksojnë muskulaturën e lëmuar të bronkeve
- D) Janë bronkodilatatorë që mund të kenë efekte ekstrapulmonare

Infermieri Pyetje: 470

Disfagia është:

- A) Ndjenja e bllokimit apo shtrëngimit në rajonin retrosternal apo epigastër, gjatë fazës së kalimit të masës ushqimore nëpër ezofag
- B) Një inflamacion i shtresës mukozale të stomakut
- C) Një okluzion i plotë i lumenit të një segmenti të traktit gastrointestinal
- D) Një kalim permanent ose intermitent i një porcioni të pjesës së sipërme të stomakut, nëpërmjet orificiumit ezofageal të diafragmës

Infermieri Pyetje: 471

Refluksi- Gastro-Ezofagial përfaqëson një:

- A) okluzion të plotë të lumenit të një segmenti të traktit gastro-intestinal
- B) ngushtim të lumenit të një pjese të tubit tretës
- C) qese të lokalizuar të murit të traktit tretës e cila përmban të gjitha shtresat e indit
- D) situatë patologjike, që karakterizohet nga rikthimi i përmbajtjes acide të stomakut në ezofag.



Infermieri Pyetje: 472

Cilat nga barnat e mëposhtme shkakton efekteve të padëshirueshme në stomak?

- A) Antiinflamatorët josteroide
- B) Antiacidet
- C) Antagonistët e receptorëve histaminikë
- D) Frenuesit e pompës protonike

Infermieri Pyetje: 473

Asciti është:

- A) Rritja e likidit me përmbajtje të lartë të karbohidrateve dhe të ulet në yndyrna
- B) Akumulimi i likidit brenda kavitetit peritoneal
- C) Rritja e osmolaritetit në urinë
- D) Rritja e nivelit të urea-nitrogenit në serum

Infermieri Pyetje: 474

Ikteri hepatoqelizor zhvillohet sepse hepari:

- A) Nuk mund të metabolizojë bilirubinën
- B) Metabolizon bilirubinën më shumë se norma
- C) Nuk ka çdo lob të përfshirë
- D) I ka nodulat që ndryshojnë në formë dhe përmasë

Infermieri Pyetje: 475

Në pacientët me Cirrozë dhe likid ascitik qëllimi primar i terapisë diuretike është:

- A) Të reduktojë volumin qarkullues dhe të ulë sasinë e likidit ascitik
- B) Që pacienti të përjetojë lehtësim nga hemoragjia gastro-intestinale
- C) Të mos ketë ripërsëritje të episodeve hemoragjike
- D) Reduktimi i simptomave gastro-intestinale

Infermieri Pyetje: 476

Bulimia nervore është një sëmundje e ushqyerjes që karakterizohet nga:

- A) Episode të mbingrënies të cilat janë të pakontrolluara
- B) Refuzimi i ushqimit për shkak të frikës së dhjamosjes
- C) Defiçite të vitaminave në dietë
- D) Humbje e masës kockore nga osteoporoza

Infermieri Pyetje: 477

Obeziteti morbid (patologjik) i referohet peshës që negativisht vepron në shëndetin e personit, zakonisht më shumë se:

- A) 10% e peshës ideale trupore
- B) 20% e peshës ideale trupore
- C) 30% e peshës ideale trupore
- D) 40% e peshës ideale trupore

Infermieri Pyetje: 478

Infeksionet e traktit urinar ndodhin:

- A) Në raport të njëjtë mes meshkujve dhe femrave
- B) Më shpesh tek meshkujt se tek femrat
- C) Më shpesh tek femrat se tek meshkujt
- D) Nuk ka rëndësi gjinia

Infermieri Pyetje: 479

Cistiti ndodh më shpesh tek gratë për shkak të:

- A) Shkurtësisë së uretrës
- B) Ndryshimeve në inde lidhur me nivelin e ulët të estrogenit
- C) Ndryshimeve në procesin e të menduarit
- D) Deficiteve në njohuri në lidhje me metodat e parandalimit

Infermieri Pyetje: 480

Veçoria primare e sindromit nefrotik është nivel i lartë i:

- A) proteinurisë
- B) glicemisë
- C) leukociteve
- D) acidit folik

Infermieri Pyetje: 481

Anemia hemolitike kongjenitale më e shpeshtë është e shoqëruar me mungesën e:

- A) Fe (hekurit)
- B) Glukoz 6 Fosfat Dehidrogjenit (G6PD)
- C) Vit B 12
- D) Acidit folik

Infermieri Pyetje: 482

Problemi bazë në aneminë nga mungesa e Fe është:

- A) Pengimi i transportit të acidit folik
- B) Një deficiet i qarkullimit të eritrociteve, nga një dëmtim i qelizave të mëparshme hemapoetike
- C) Zvogëlimi i mbështetjes së Fe për zhvillimin e ruazave të kuqe të gjakut
- D) Një deficiet i enzimës Glukoz 6 Fosfat Dehidrogjenit (G6PD)

Infermieri Pyetje: 483

Komplikacionet kryesore të diabetit përfshijnë:

- A) Çrregullime të strukturës e funksionit të murit të enës së gjakut
- B) Dhimbje koke
- C) Zvogëlim të periudhave të vëmendjes
- D) Hemoragji nga gingivat

Infermieri Pyetje: 484

Acidoketoza Diabetike vjen nga mungesa e insulinës, me rritje relative apo absolute të:

- A) Proteinurisë
- B) Urea-nitrogenit
- C) Glukagonit
- D) Kaliumit

Infermieri Pyetje: 485

Hypomagnezemia shihet tek:

- A) Pijanecet dhe tek personat me sindromë të keqabsorbimit, disa sëmundje renale dhe keqëushqim
- B) Tek pacientët me mungesë të Vit D
- C) Tek pacientët me deformime të gjymtyrëve
- D) Tek pacientët me shqetësime psikologjike

Infermieri Pyetje: 486

Endokarditi Reumatik ndodh zakonisht pas një infeksioni të rrugëve të sipërme respiratore, shkaktuar nga:

- A) Streptokoku i grupit A
- B) Pseudomonas aeruginosa
- C) Serratia marcescens
- D) Adenoviruset

Infermieri Pyetje: 487

Sindroma klinike, që karakterizohet nga rënie e shpejtë dhe e theksuar e vlerës së filtrimit glomerular (me rritje të kreatininës dhe azotemisë) është:

- A) Insuficenca kardiake
- B) Insuficenca ventilatore
- C) IRA (Insuficenca Renale Akute)
- D) Insuficenca e oksigjenimit

Infermieri Pyetje: 488

Teste përgatitese për provimin e licencës për studentët e infermierisë
<https://gjithcka.al>

Në diabetin insipid sasia e ADH (Hormoni Anti Diuretik) e çliruar në përgjigje të stimujve fiziologjikë është:

- A) E pamjaftueshme
- B) Në normë
- C) E rritur
- D) Në vlerat maksimale

Infermieri Pyetje: 489

Sindroma Kushing është sëmundje që vjen si pasojë e prodhimit të shtuar të:

- A) Kortizolit
- B) Kaliumit
- C) Kalçiumit
- D) Natriumit

Infermieri Pyetje: 490

Shkaktari kryesor i Ulçerës gastrike është:

- A) Anemia pernicioze
- B) *Helicobacter pylori*
- C) Terapia me antiacid
- D) Marrja e qumështit

Infermieri Pyetje: 491

Është sëmundje multisistemike e karakterizuar nga dëmtime inflamatorë, vaskulare të lëkurës dhe të organeve të brendshme:

- A) Ethja reumatizmale
- B) Artriti reumatoid
- C) Sklerodermia
- D) Osteoartriti



Infermieri Pyetje: 492

Në pacientët me Uretrit, Cistit dhe Piolenefrit mikrobi shkakton në 80% të infeksioneve të pandërlikuara të rrugëve urinare është:

- A) Esherica coli
- B) Herpes simplex
- C) Adenoviruset
- D) Cytomegaloviruset

Infermieri Pyetje: 493

Infermieri fokusohet në simptomat kryesore të një pacienti me Bronkit kronik të cilat janë:

- A) Dhimbje kraharori gjatë respirimit
- B) Dispne dhe kollë produktive
- C) Temperaturë dhe djersë
- D) Takipne dhe takikardi

Infermieri Pyetje: 494

Dhimbja e kraharorit në pacientët me Angina Pectoris shkaktohet nga:

- A) Vazokonstriksioni koronar
- B) Lëvizja e trombit
- C) Ishemia e miokardit
- D) Prezenca e ateromës

Infermieri Pyetje: 495

Ndër efektet anësore kryesore që shoqërojnë administrimin e nitroglicerines është:

- A) Dobësia muskulare
- B) Hipertensioni
- C) Bradikardia
- D) Dhimbja e kokës

Infermieri Pyetje: 496

Alogjia-simptomat negative të skizofrenisë do të thotë:

- A) Kontakt i varfër me sy
- B) Emocion i papërshtatshëm
- C) Varfëri në të folur
- D) Latencë në përgjigje

Infermieri Pyetje: 497

Bashkëbisedimet terapeutike përbëhen nga:

- A) ato sociale dhe terapeutike
- B) Faza fillestare ose faza hyrëse
- C) Faza e punës
- D) Faza përfundimtare

Infermieri Pyetje: 498

Faza përfundimtare e bashkëbisedimeve do të thotë:

- A) Menaxhim i ankthit
- B) Kujdesi dhe puna në maksimum
- C) Një hap pozitiv
- D) Përforsimi i kufinjëve gjatë takimeve

Infermieri Pyetje: 499

Infermieri/a i shëndetit mendor është i aftë kur është në gjendje:

- A) Të respektojë diversitetin
- B) Të ketë besim tek të tjerët
- C) Të manifestojë siguri
- D) Të marrë përsipër përgjegjësitë

Infermieri Pyetja: 500

Cila nga shtresat e lëkurës përbëhet kryesisht nga fije kolagjene dhe elastike:

- A) epiderma
- B) shtresa korneale
- C) derma
- D) hipoderma

Infermieri Pyetja: 501

Kortikoterapia është trajtimi bazë për:

- A) folikulitin
- B) kandidozën
- C) ekzemën
- D) melanomën

Infermieri Pyetja: 502

Në principet e rikthimit të pacientit në jetën normale bën pjesë:

- A) Mbështetja familjare
- B) Aksesit në burime
- C) Kujdesi klinik
- D) Stigma

Infermieri Pyetja: 503

Respektimi I Diversitetit do të thotë:

- A) Bashkëpunimi me familjarë dhe kolegë
- B) Të kuptojë dhe të njohë diversitetin
- C) Përkushtim dhe mundësi të barabarta
- D) Respektimi I nivelit kulturor të pacientit

Infermieri Pyetje: 504

Dermatofitoza është një infeksion:

- A) viral
- B) mikrobik
- C) stafilo-streptokoksik
- D) mykotik

Infermieri Pyetje: 505

Depresioni shprehet me :

- A) Vështërsi në përqendrim
- B) Tension muskular
- C) Deluzione
- D) Haluçinacione

Infermieri Pyetje: 506

Ankthi i vazhdueshëm mund të shkaktojë:

- A) Pamundësi funksionimi i përditshëm
- B) Depresion të pakontrollueshëm
- C) Psikozë manjakale
- D) Skizofreni hebrefrenike

Infermieri Pyetje: 507

Gjendjet ankioze shoqërohen me:

- A) Pamundësi për tu kujdesur për veten
- B) Harrese dhe humbje kujtese
- C) Papërgjegjshmëri
- D) Gjykim i dobët

Infermieri Pyetje: 508

Manaxhimi i depresionit bëhet nëpërmjet:

- A) Manaxhimi i sëmundjes fizike
- B) Trajtimi me ilaçe
- C) Vetëndihma
- D) Trajtim i përgjithshëm

Infermieri Pyetje: 509

Të sjellë shndryshimin do të thotë:

- A) Të kuptosh pasojat e problemit
- B) Formulimi i programit të besueshëm
- C) Të mundësosh shërbime me vlera
- D) Arritja e një ndryshimi pozitiv

Infermieri Pyetje: 510

Zhvillim personal i infermierit do të thotë:

- A) Një plan personal dhe profesional zhvillimi
- B) Aftësi për të vendosur synime realiste
- C) Akses në trajnime dhe arsimim
- D) Kërkimi i vazhdueshëm i të rejave të fundit

Infermieri Pyetje: 511

Rreziqet nga çrregullimet e humorit vijnë si rezultat i:

- A) Gjykimit të dobët
- B) Moshës së rrezikut
- C) Agresivitetit
- D) Provokimit

Infermieri Pyetje: 512

Nuk është formë e depresionit:

- A) Crregullimi bipolar
- B) Ulja mëngjezore
- C) Hypomania
- D) Mania

Infermieri Pyetje: 513

Neuralgjia posherpetike nuk ka si karakteristikë:

- A) dhimbjet nevralgjike që mund të zgjatën për një kohë të gjatë
- B) shfaqet kryesisht te të moshuarit
- C) shoqëron infeksionet bakteriale
- D) është një komplikacion pas shërimit klinik të Herpes Zoster

Infermieri Pyetje: 514

Çrregullimi bipolar NJE shprehet me:

- A) Distrofi parësore
- B) Mani me depression
- C) Hypomania pa depression
- D) Ulje mëngjezore

Infermieri Pyetje: 515

Trajtimi në crregullimet e humorit bëhet me:

- A) Antidepresiv
- B) Antikomvulsiv
- C) Antipsikotik
- D) ECT

Infermieri Pyetje: 516

Zakonisht pacientët me hypomani paraqesin:

- A) Entuziazëm të tepruar
- B) Hiperaktivitet
- C) Pagjumësi
- D) Suicid

Infermieri Pyetje: 517

Në psikozën paranoide pacienti paraqet:

- A) Rritje e vetvlersimit
- B) Veprimtari e shtuar
- C) Humor i ngritur
- D) Halucinacione

Infermieri Pyetje: 518

Pacienti me depresion psikotik paraqet:

- A) Tentativa për vetvrasje
- B) Çrregullime të oreksit
- C) Të qara me lot
- D) Anhedoni

Infermieri Pyetje: 519

Në psikozën maniakale pacienti paraqet:

- A) Konfuzion
- B) Izolim
- C) Fluturim të ideve
- D) Anhedoni

Infermieri Pyetja: 520

Niveli I litiumit në gjak duhet të jetë Brenda normës:

- A) 5-7 miliektolitër
- B) 7-10 miliektolitër
- C) 10-17 miliektolitër
- D) 17-20 miliektolitër

Infermieri Pyetja: 521

Episodet depressive të mëdha shoqërohen me:

- A) Çrregullime emocionale
- B) Mendime për vetvrasje
- C) Humor I ngritur
- D) Veprimtari e shtuar

Infermieri Pyetja: 522

Për cilën nga sëmundjet është karakteristike shoqërimi me sëmundje të tjera atopike:

- A) psoriazis vulgaris
- B) akne Vulgaris
- C) ekzema endogjene
- D) tinea pedis

Infermieri Pyetja: 523

Simptomat pozitive të skizofrenisë I përkasin dimensionit:

- A) emocional
- B) intelektual
- C) psikotik
- D) shpirtëror

Infermieri Pyetje: 524

Skizofrenia shoqërohet me prognozë "shumë të keqe" në atë:

- A) katatonike
- B) hebefrenike
- C) reziduale
- D) të thjeshtë

Infermieri Pyetje: 525

Shkaktari më domethënës i skizofrenisë është :

- A) Çrregullimi biokimik i metabolizmit në tru
- B) Zhvillimi patologjik i trurit
- C) Faktorët ambjental
- D) Gjenetika

Infermieri Pyetje: 526

Trajtimi më produktiv në skizofreni konsiston në :

- A) Trajtim social
- B) Antipsikotik
- C) Antidepresiv
- D) ECT

Infermieri Pyetje: 527

Deluzionet janë zakonisht:

- A) Konkluzione
- B) Perceptione
- C) Zëra imagjinare
- D) Bindje të gabuara

Infermieri Pyetje: 528

Halucinacionet janë perceptime:

- A) imagjinare
- B) fetare
- C) somatike
- D) nihiliste

Infermieri Pyetje: 529

Në psikozën paranoide mbizotërues është deluzioni:

- A) persekutimit
- B) përndjekjes
- C) madhështisë
- D) xhelozisë

Infermieri Pyetje: 530

Fenomeni i "mutizmit" është tipik për :

- A) Skizofreninë e thjeshtë
- B) Skizofreninë reziduale
- C) Skizofreninë katatonike
- D) Skizofreninë e padiferencuar

Infermieri Pyetje: 531

Vlerësimi infermieror parësor në skizofreni i referohet vlerësimit të:

- A) gjendjes së humorit
- B) potencialit për dhunë
- C) mbështetjes sociale
- D) njohurive

Infermieri Pyetja: 532

Ndërhyrja infermierore në skizofreni fillon me permiresimin e:

- A) procesit të mendimit
- B) e izolimit social
- C) kujdesjeve vetjake
- D) komunikimit verbal

Infermieri Pyetja: 533

Rritja, shkolla, puna , martesë janë shprehje domethënëse për dimensionin:

- A) intelektual
- B) fizik
- C) social
- D) shoqëror

Infermieri Pyetja: 534

Hedhja sistematike që në lindje e një koliri antiseptik ose antibiotik ka për qëllim
prevenimin e konjuktivitit:

- A) Nga adenoviruset
- B) Nga trakoma
- C) Gonokoksik
- D) Pneumokoksik

Infermieri Pyetja: 535

Hedhja e kolireve kortikoide kundraindikohem në:

- A) Edemën korneale
- B) Uveitin anterior
- C) Keratitin epithelial
- D) Kataraktën

Infermieri Pyetje: 536

Cili është kundraindikacioni absolutë i midriatikëve?

- A) Koroiditi
- B) Neuriti optik
- C) Glaucoma me kënd të mbyllur
- D) Keratiti

Infermieri Pyetje: 537

Pilokarpina është një kolir:

- A) Parasimpatikomimetik
- B) Parasimpatolitik
- C) Simpatikomimetik
- D) Simpatikolitik

Infermieri Pyetje: 538

Epinefrina është një kolir:

- A) Parasimpatikomimetik
- B) Parasimpatolitik
- C) Simpatikomimetik
- D) Miotik

Infermieri Pyetje: 539

Cili nga koliret e mëposhtëm nuk e zgjeron pupilën?

- A) Pilokarpina
- B) Kokaina
- C) Adrenalina
- D) Atropine

Infermieri Pyetje: 540

Cili nga propozimet e mëposhtme mbi koliret nuk është i saktë?

- A) Koliret me bazë sulfamidë nuk veprojnë ndaj infeksioneve nga klamidet
- B) Koliret antibiotikë penetrojnë keq në vitroz
- C) Koliret anestezike në doza të përsëritura kanë efekt toksik mbi epitelin e kornesë
- D) Koliret simpatomimetike kanë efekt midriatik

Infermieri Pyetje: 541

Çfarë duhet survejuar në rastet e përdorimit të zgjatuar të kolireve kortikoide?

- A) Tensioni ocular

- B) Këndi irido-korneal
- C) Sensibiliteti korneal
- D) Endoteli i kornesë

Infermieri Pyetje: 542

Cili nga koliret e mëposhtëm nuk duhet përdorur në rastet me iridociklit?

- A) Midriatikët
- B) Miotikët
- C) Antibiotikët lokalë
- D) Kortikoidët lokalë

Infermieri Pyetje: 543

Cili nga propozimet e mëposhtme ka kundërindikacion absolut përdorimin e kolireve parasimpatikolitike?

- A) Trajtimi i uveitit anterior
- B) Ekzaminimi i fundus okulit
- C) Trajtimi i glaukomës
- D) Riedukimi i ambliopisë

Infermieri Pyetje: 544

Cili nga propozimet e mëposhtme lidhur me kolirët nuk është i saktë?

- A) Penicilina përdoret pak në kolir sepse jep alergji
- B) Kloramfenikoli ka difuzion corneal
- C) Neomicina ka një spektër të ngushtë veprimi
- D) Aminoizidet përdoren kundër mikroorganizmave gram-negativë



Infermieri Pyetja: 545

Koliret midriatike indikohen në rastet me:

- A) Sklerit
- B) Iridociklit
- C) Glaukomë kronike me kënd të hapur
- D) Glaukomë me kënd të mbyllur

Infermieri Pyetja: 546

Cilët nga kolirët e mëposhtëm japin hipertoni okulare?

- A) Midriatikët
- B) Miotikët
- C) Antiseptikët
- D) Antibiotikët

Infermieri Pyetja: 547

Cili nga koliret e mëposhtëm favorizon rrjedhjen e lëngut uxor jashtë syrit:

- A) Pilocarpina
- B) Timololi
- C) Atropine
- D) Neosinefrina

Infermieri Pyetja: 548

Cili nga koliret e mëposhtëm redukton sekrecionin e lëngut uxor?

- A) Betablokuesit
- B) Kortikoidet
- C) Acetazolamidi
- D) Kolinergjikët

Infermieri Pyetje: 549

Cili nga propozimet e mëposhtme nuk shkakton katarakt?

- A) Hipokalçemia
- B) Diabeti
- C) Marrja e kortikoidëve
- D) Marrja e indometacinës

Infermieri Pyetje: 550

Cilët janë argumentët në favor të konjuktivitit?

- A) Cefalea e fortë
- B) Kornea transparente
- C) Ulja e pamjes
- D) Prekja unilaterale

Infermieri Pyetje: 551

Në cilin nga lezionet e mëposhtme nuk duhet të kërkohet prezenca e një trupi të huaj intra okular?

- A) Plagë e kornesë
- B) Opacitet i kristalinit
- C) Hemoragji sub-konjuktivale
- D) Zbardhje e papilës

Infermieri Pyetje: 552

Cili nga propozimet që i përkasin glaukomës me kënd të mbyllur nuk është i saktë?

- A) Trajtimi medical mbështetet në përdorimin e hipotonikëve me rrugë të përgjithshme
- B) Miotikët janë të kundraindikuar
- C) Trajtimi kirurgjikal sekondar është i nevojshëm
- D) Kriza e glaukomës akute përfaqëson mbylljen jo komplete të këndit irido-korneal

Infermieri Pyetje: 553

Për të kontrolluar rritjen e bakterieve në mungesë të infeksionit në pacientët me ulçerë dekubituese rekomandohen:

- A) Antibakterial lokalë
- B) Antiinflamatorë
- C) Analgjezikë
- D) Antimykotikë

Infermieri Pyetje: 554

Një dëmtim të aftësive të pacientit me ulçerë dekubituese për të rezistuar ndaj infeksionit e tregon:

- A) Një edemë e thellë subkutane
- B) Një prurit i rëndë
- C) Një sasi e shtuar eksudati dhe një shkatërrim progresiv i indeve
- D) Rritja e temperaturës së lëkurës

Infermieri Pyetje: 555

Cila prej shkaqeve të mëposhtme bën pjesë në shkaqet e brendshme të sëmundjeve të lëkurës:

- A) mykotike
- B) parazitare
- C) gjenetike
- D) kimike

Infermieri Pyetje: 556

Cili nga medikamentet e mëposhtme ka efekt antiseptik:

- A) acicloviri
- B) sol. Gencian violet
- C) sol. Benzilbenzoat
- D) hidrokortizoni

Infermieri Pyetje: 557

Shfaqja e lezioneve në Herpes Zoster ngjan me Herpesin Simplex, por veçoria kryesore është:

- A) Shfaqja e lezioneve vizaton trajektoren e nervave sensitive
- B) Shfaqja e papulave të rastësishme
- C) Telengioektazitë dhe pigmentimi
- D) Shfaqja e papulave me mure të forta rrethore

Infermieri Pyetje: 558

Shfaqja më e shpeshtë klinike e HSV-1 (Herpes Simplex Virus 1) është:

- A) Papula me mure të forta rrethore
- B) Telengioektazi dhe pigmentim
- C) Një grup me vezikula mbi një bazë eritematoze
- D) Makula të vogla me kruste të verdha të forta

Infermieri Pyetje: 559

Incidenca në patologjinë e Psoriasis zakonisht më e ulur është në:

- A) Racat e bardha
- B) Racat e zeza
- C) Në njerëzit me numër apo përmbajtje të lartë të rruazave të kuqe të gjakut
- D) Në njerëzit me numër apo përmbajtje të ulët të rruazave të kuqe të gjakut

Infermieri Pyetje: 560

Funksionin e saj sekretor, lëkura e realizon nëpërmjet :

- A) poreve të lëkurës
- B) hapësirave ndërçelimore
- C) folikujve të flokut
- D) gjendrave të yndyrës dhe djersës

Infermieri Pyetje: 561

Funksionin sensitiv i lëkurës e realizon nëpërmjet:

- A) pH të saj acid
- B) mbaresave nervore
- C) proceseve të shumta metabolike
- D) shtresës së shndritshme

Infermieri Pyetje: 562

Krusta është element morfologjik dytësor që formohet nga :

- A) disa qeliza të brirëzuara të shtresës korneale
- B) tharja e sekrecioneve të vezikulave, erozioneve apo ulçerave
- C) traumatizimi i lëkurës me anë të thonjve
- D) hollimi i sipërfaqes së të gjitha shtresave të lëkurës

Infermieri Pyetje: 563

Përdorimi i acidit salicilik, për cilën nga patologjitë e mëposhtme është karakteristike:

- A) Psoriazis vulgaris
- B) Variçela
- C) Erizipela
- D) Skabies

Infermieri Pyetje: 564

Cili nga medikamentet e mëposhtme ka efekt keratolitik:

- A) permanganati i kaliumit
- B) pomada me gentamicinë
- C) acidi salicilik
- D) kortizonikët lokalë

Infermieri Pyetje: 565

Adipocitet janë qeliza të pranishme në :

- A) epidermë
- B) shtresën bazale të lëkurës
- C) shtresën papilare të dermës
- D) hipodermë

Infermieri Pyetje: 566

Cilën nga funksionet e mëposhtme kryen melaninia:

- A) merr pjesë në sistemin e mbrojtjes imunitare
- B) mbron lëkurën nga veprimi i rrezeve ultraviolette
- C) siguron funksionin mbrojtës kimik
- D) siguron mbajtjen konstante të temperaturës

Infermieri Pyetje: 567

Cila nga karakteristikat e mëposhtme i përket shtresës korneale:

- A) është shtresa e parë e epidermës duke u nisur nga brendësia në sipërfaqe
- B) përbëhet nga qeliza të mëdha me bërthamë
- C) merr pjesë në rigjenerimin e shtresave të sipërme të epidermës
- D) përbëhet nga qeliza të vdekura pa bërthamë

Infermieri Pyetje: 568

Në pacientët me Urtikarie, reaksioni i lëkurës është shoqëruar me një çlirim të histaminës, medikamentet e zgjedhura janë:

- A) Antibiotikët
- B) Antimykotikët
- C) Antihistaminikët
- D) Antiviralët

Infermieri Pyetje: 569

Cilat nga qelizat e mëposhtme marrin pjesë në sistemin e mbrojtjes imunitare të organizmit:

- A) qelizat e Masonit
- B) melanocitet
- C) qelizat e Langerhansit
- D) adipocitet

Infermieri Pyetje: 570

Infeksionet bakteriale lokale zakonisht mjekohen me:

- A) Antiviral
- B) Antibiotikë topikal
- C) Nizoral
- D) Antihistaminikë

Infermieri Pyetje: 571

Cilat janë komplikacionet që takohen tek pacienti pas demtimit të sistemit nervor qendror?

- A) Paraliza
- B) Dhimbje kyçesh
- C) Dhimbje muskujsh
- D) Temperaturë e lartë

Infermieri Pyetje: 572

Sa % e foshnjave të lindura nga nëna me Miaseni gravis shfaqin simptoma të sëmundjes?

- A) 44% e foshnjave
- B) 34% e foshnjave
- C) 24% e foshnjave
- D) 14% e foshnjave

Infermieri Pyetje: 573

Parkinsoni prek më shpesh grup-moshat:

- A) 50-55 vjeç
- B) 60-65 vjeç
- C) 70-75 vjeç
- D) 80-85 vjeç

Infermieri Pyetje: 574

Zona Wernicke, e lokalizuar midis zonave paresore të degjimit dhe shikimit është shumë e rëndësishme për:

- A) Interpretimin e gjuhës
- B) Përgjegjësi për gjenerimin e modeleve levizore
- C) Termoregulacionin
- D) Shikimin

Infermieri Pyetje: 575

Demtmet konjitive tek pacienti me skleroze multiple hasen në:

- A) Fazën e hershme të sëmundjes
- B) Fazën e mëvonshme
- C) Nuk takohen të tilla demtime
- D) Janë simptoma paralajmëruese

Infermieri Pyetje: 576

Vëzhgimi dhe vlerësimi neurologjik i pacientit me epilepsi, nga ana e infermierit, janë faktorë të rëndësishëm sepse:

- A) Përcaktojnë tipin e krizës epileptike
- B) Përcaktojnë llojin e medikamentoz të trajtimit
- C) Vendosin diagnozën përfundimtare
- D) Nuk janë pjesë e kujdesit

Infermieri Pyetje: 577

Termi hiperemi aktive i referohet ngjyrës së lëkurës:

- A) pas djegies së saj
- B) normale
- C) pas mjekimit
- D) pas një traume

Infermieri Pyetje: 578

Hypotermia aksidentale është një gjendje ku personi ekspozohet:

- A) në temperatura shumë të ulta
- B) në temperatura të ulta
- C) në situata aksidentale
- D) në temperatura të larta

Infermieri Pyetje: 579

Hypotermia urbane është :

- A) ekspozimi ekstrem ndaj të ftohtit në mjedise urbane
- B) ulja e temperaturës trupore nga kontakti me ujë të ftohtë
- C) ulja e temperaturës trupore nga patologji të ndryshme
- D) ulja e temperaturës trupore nga të ftohtit

Infermieri Pyetje: 580

Hemoragjia, quhet e ndërmjetme kur shfaqet :

- A) gjatë operacionit
- B) pak orë pas operacionit
- C) pak ditë pas operacionit
- D) pas një traume të jashtme

Infermieri Pyetje: 581

Hemoragjia, quhet primare kur shfaqet:

- A) pak orë pas operacionit
- B) gjatë operacionit
- C) pak ditë pas operacionit
- D) pas një traume të jashtëme

Infermieri Pyetje: 582

Ndihma e parë në raste hemoragjike është:

- A) vendosja shtrirë e pacientit
- B) vendosja e bandazhit
- C) vendosja e akullit
- D) terapi medikamentoze

Infermieri Pyetje: 583

Donatori lejohet të japë gjak pasi të kenë kaluar të paktën:

- A) 45 ditë nga dhurimi i fundit
- B) 56 ditë nga dhurimi i fundit
- C) 65 ditë nga dhurimi i fundit
- D) 75 ditë nga dhurimi i fundit

Infermieri Pyetje: 584

Sasia e gjakut që dhurohet është të paktën :

- A) 350ml
- B) 450 ml
- C) 550ml
- D) 650ml

Infermieri Pyetje: 585

Pesha minimale trupore për një donator gjaku duhet të jetë:

- A) 40 kg
- B) 50 kg
- C) 60 kg
- D) 70 kg

Infermieri Pyetje: 586

Mosha minimale për një donator gjaku është:

- A) 15 vjeç
- B) 17 vjeç
- C) 20 vjeç
- D) 25 vjeç

Infermieri Pyetje: 587

Mosha maksimale për një donator gjaku duhet të jetë:

- A) 45 vjeç
- B) 55 vjeç
- C) 65 vjeç
- D) 75 vjeç

Infermieri Pyetje: 588

Pozicioni më i përshtatshëm për pacientët pas operacionit është :

- A) pozicioni semi - Fowler
- B) pozicioni Fowler
- C) tredelenburg
- D) gjinekologjik

Infermieri Pyetje: 589

Mjeku Reanimator është anëtar në grupin:

- A) steril
- B) jo steril
- C) vezhgues
- D) qarkullues

Infermieri Pyetje: 590

Numërimi i veglave kirurgjikale para dhe pas operacionit kryhet nga:

- A) infermiera qarkulluese
- B) infermiera instrumentare
- C) mjeku kirurg
- D) mjeku anestezi

Infermieri Pyetje: 591

Me termin asepsi nënkuptojmë:

- A) Eliminim të mikroorganizmave në një zonë të caktuar
- B) Kufizim të mikroorganizmave në një zonë të caktuar
- C) Pastrim
- D) Dezinfektim

Infermieri Pyetje: 592

Asepsia kirurgjikale përfshin të gjitha si më poshtë përveç:

- A) Përdorimin e dorezave sterile gjatë vendosjes së kateterit urinar
- B) Përdorimin e pajisjeve sterile në ndryshimin e garzave të plagës
- C) Larjen e duarve para dhe pas kryerjes së manipulimeve
- D) Sterilizimin e instrumentave kirurgjikal

Infermieri Pyetje: 593

Asepsia mjekësore përfshin :

- A) Larjen e duarve para dhe pas servirjes së ushqimit
- B) Larjen e duarve pas zbrazjes së uturakut
- C) Përdorimin e dorezave sterile gjatë mjekimit të plagës
- D) Larjen e duarve para, pas servirjes së ushqimit dhe pas zbrazjes së uturakut

Infermieri Pyetje: 594

Flebotomia konsiston në :

- A) venipunkturën dhe thithjen e gjakut
- B) dëmtimin e enës së gjakut
- C) venipunkturën dhe dhënien e gjakut
- D) aplikimin e infuzioneve

Infermieri Pyetje: 595

Vlerësimet fizike të pacientit në periudhën preoperative përfshijnë të gjitha si më poshtë, përveç :

- A) Vlerësimin e bilancit hidrik dhe elektrolytik
- B) Vlerësimin e statusit ushqimor
- C) Vlerësimin e funksionit kardiovaskular
- D) Vlerësimin e ankthit

Infermieri Pyetje: 596

Bën pjesë në anëtarët e grupit steril :

- A) Kirurgu
- B) Anestezisti
- C) Infermiera qarkulluese
- D) Asnjëra

Infermieri Pyetja: 597

Administrimi i opiateve para operacionit ndihmon :

- A) në paksimin e sekrecioneve
- B) uljen e tonusit muskular
- C) reduktimin e ankthit dhe stresit
- D) tharjen e mukozave

Infermieri Pyetja: 598

Administrimi i antikolinergjikëve para operacionit ndikon në :

- A) në pakësimin e sekrecioneve
- B) reduktimin e ankthit dhe stresit
- C) uljen e tonusit muskular
- D) tharjen e mukozave

Infermieri Pyetja: 599

Asepsitë kirurgjikale janë aktivitete që :

- A) minimizojnë përhapjen e sporeve dhe mikroorganizmave në një sipërfaqe të caktuar
- B) eliminojnë numrin dhe përhapjen e sporeve dhe mikroorganizmave në një sipërfaqe të caktuar
- C) pakësojnë numrin e sporeve dhe mikroorganizmave në një sipërfaqe të caktuar
- D) pakësojnë përhapjen e sporeve dhe mikroorganizmave në një sipërfaqe të caktuar

Infermieri Pyetja: 600

Asepsia është procedura që bën të mundur:

- A) eliminimin e të gjithë mikroorganizmave
- B) eliminimin e shumicës së mikroorganizmave
- C) pakësimin e të gjithë mikroorganizmave
- D) pakësimin e shumicës së mikroorganizmave

Infermieri Pyetje: 601

Anëtarë të grupit jo steril janë të gjithë si më poshtë përveç:

- A) Anestezisti
- B) Infermiera qarkulluese
- C) Ndihmës kirurgu
- D) Teknikët radiolog

Infermieri Pyetje: 602

Praktikat që ulin dhe pengojnë proceset e infeksionit në pacientët post– kirurgjikal quhen:

- A) Teknika Dezinfektuese
- B) Teknika Dekontaminuese
- C) Teknika Kontrolli
- D) Teknika Aseptike

Infermieri Pyetje: 603

Pacientët e pranuar në Njësinë e Kujdesit Post – Anestezik pa refleksin faringeal duhet të vendosen në pozicion:

- A) Dorsal
- B) Lateral
- C) Fowler
- D) Asnjëra

Infermieri Pyetje: 604

Infermieri duhet të njohë shenjat dhe simptomat e pengesës respiratore tek pacienti në periudhën post operatore, këto shenja përfshijnë:

- A) përdorimi i muskujve ndihmës gjatë frymëmarrjes
- B) hipotension arterial
- C) dhimbje kraharori
- D) asnjëra

Infermieri Pyetja: 605

Përdorimi i klizmës pastruese është i detyrueshëm të aplikohet :

- A) para të gjitha llojeve të operacioneve
- B) para operacioneve që përfshijnë traktin gastro - intestinal
- C) para operacioneve që përfshijnë traktin uro -genital
- D) para asnjë lloj operacioni pasi nuk rekomandohet më

Infermieri Pyetja: 606

Infermiera qarkulluese është pjesë e:

- A) grupit steril
- B) grupit josteril
- C) grupit vëzhgues
- D) nuk është antare e bllokut operator

Infermieri Pyetja: 607

Ruajtja e sigurisë dhe integritetit të fushës sterile gjatë procedurës kirurgjikale është detyrë e :

- A) kirurgut primar
- B) anestezistit
- C) infermieres qarkulluese
- D) infermieres instrumentare

Infermieri Pyetja: 608

Në rast se pas operacionit kanë kaluar më shumë se 12 – 18 orë dhe pacienti nuk ka urinuar, ndërhyrje primare është :

- A) vendosja e kateterit urinar
- B) nxitja e pacientit për të urinuar vetë nëpërmjet përdorimit të borsave të ngrohta
- C) vendosja e kateterit supra pubik
- D) asnjëra

Infermieri Pyetja: 609

Hipotensioni arterial në periudhën post –operatore mund të shkaktohet nga:

- A) Acidoza
- B) Hipokseミア
- C) Disritmia
- D) Humbja e gjakut dhe e lëngjeve

Infermieri Pyetja: 610

Cila nga alternativat e mëposhtme tregon për një procedurë diagnostikuese?

- A) kolostomia
- B) ileostomia
- C) kolonoskopia
- D) jejunostomia

Infermieri Pyetja: 611

Djegjet kimike të lëkurës cilat rezultojnë nga lëndë korrozive duhet:

- A) Të shpëlahen menjëherë me ujë të rrjedhshëm për 15 – 20 min
- B) Të aplikohet pomadë
- C) Të aplikohet balsame
- D) Të fashohet menjëherë

Infermieri Pyetja: 612

Pas operacioneve gastrike pacienti këshillohet të qëndroj në pozicionin:

- A) Fowler
- B) Semi- Fowler
- C) Tredelenburg
- D) Gjinekologjik

Infermieri Pyetja: 613

Infermiera qarkulluese ka pergjegjesi per te gjitha sa me poshte pervec :

- A) A Kryerjen e veprimeve jashte fushes sterile
- B) Te siguroj kujdes infermieror per pacientin
- C) Te siguroj mbeshtetje emocionale per pacientin
- D) Te numeroje instrumentet dhe paisjet e perdorura ne operacion

Infermieri Pyetja: 614

Eshte procedure diagnostikuese :

- A) qarkullimi ekstrakorporal
- B) koronarografia
- C) stenti
- D) koronaroskopia

Infermieri Pyetja: 615

Qarkullimi ekstrakorporal haset ne:

- A) Kardiokirurgji
- B) Neurokirurgji
- C) Kirurgji abdominale
- D) Kirurgji estetike

Infermieri Pyetja: 616

Hematemeza eshte :

- A) Prania e gjakut ne te vjella
- B) Prania e gjakut ne fece
- C) Rrjedhja e gjakut nga hundet
- D) Asnjera

Infermieri Pyetje: 617

Dhënia e ushqimeve dhe e lëngjeve nga goja tek pacientët post – operator fillon:

- A) Në momentin e rifillimit të peristaltikës dhe zhurmës aktive intestinale
- B) Në momentin e rifillimit të diurezës
- C) Në momentin e stabilizimit të presionit arterial
- D) Asnjëra

Infermieri Pyetje: 618

Çrregullimi i bilancit hidro-elektrolitik tek pacientët e djegur mund të vijë si pasojë e:

- A) Humbjes të një sasive të madhe plazme
- B) Humbjes të një sasive të madhe gjaku
- C) Diurezës së shtuar
- D) Asnjëra

Infermieri Pyetje: 619

Plagët nga dekubituset janë plagë që shkaktohen nga:

- A) traumat e hapura
- B) armët e zjarrit
- C) aksidentet automobilistike
- D) qëndrimi në shtrat për një kohë të gjatë

Infermieri Pyetje: 620

Faktorët që ndikojnë për formimin e dekubituesëve janë të gjitha përveç:

- A) kequshqyerja
- B) higjiena e ulët
- C) gjendja emocionale
- D) qëndrimi gjatë në shtrat

Infermieri Pyetje: 621

Në një retension urinar përdoret kateteri:

- A) Robinson
- B) Nichols
- C) Foley
- D) Moby- Dick

Infermieri Pyetje: 622

Gastrostomia është procedure që ushqen pacientin nga:

- A) ezofagu
- B) stomaku
- C) jejunum
- D) kolon

Infermieri Pyetje: 623

Ndërrimi i pensamentëve të plagës operative bëhet:

- A) 10 - 15 orë pas operacionit
- B) 16 - 24 orë pas operacionit
- C) 36 - 48 orë pas operacionit
- D) 52 - 72 orë pas operacionit

Infermieri Pyetje: 624

Trajtimi fillestar i plagës bëhet me:

- A) antibiotik
- B) kortizonik
- C) sol. fiziologjik
- D) betadinë

Infermieri Pyetja: 625

Litotripsia është thyerja e gurëve në:

- A) vezikën urinare
- B) veshka
- C) uretër
- D) kolecist

Infermieri Pyetja: 626

Një plagë quhet e papastër kur:

- A) nuk ka rrjedhje të madhe nga organet viscerale
- B) kur ka pezmatim pa eksudat qelbëzues
- C) që nuk kanë shenja të pezmatimit
- D) nëse ka supuracion

Infermieri Pyetja: 627

Një plagë quhet e kontaminuar kur:

- A) nuk ka rrjedhje të madhe nga organet viscerale
- B) kur ka pezmatim pa eksudat qelbëzues
- C) që nuk kanë shenja të pezmatimit
- D) nëse ka supuracion

Infermieri Pyetja: 628

Faktorët e rrezikut për infeksione spitalore të plagëve janë të gjitha përveç:

- A) përkujdesja perioperative
- B) sterilizimi i pajisjeve
- C) gjendja e të sëmurit
- D) statusi emocional i të sëmurit

Infermieri Pyetje: 629

Irrigimi i plagës nënkupton:

- A) suturimi i plagës
- B) trajtimi me antibiotik
- C) lavazhi i plagës
- D) fashimi i plagës

Infermieri Pyetje: 630

Qëllimi primar në trajtimin e ulçerës stazike venoze të këmbës është:

- A) Pastrimi i plagës me alkool
- B) Përdorimi i lidokainës lokale
- C) Sigurimi i shërimit të plagës dhe parandalimi i infeksionit
- D) Asnjëra

Infermieri Pyetje: 631

Gjatë djegies pacienti ka humbje më të theksuar të :

- A) plazmës
- B) gjakut
- C) urinës
- D) djersës

Infermieri Pyetje: 632

Ku përdoret rregulli i 9-ës?

- A) Në politrauma
- B) Në ngrirjet trupore
- C) Në djegiet trupore
- D) Plagët me armë zjarri

Infermieri Pyetje: 633

Ileusi adinamik zakonisht ndodh:

- A) 1 ditë pas operacionit
- B) 2 - 3 ditë pas operacionit
- C) 4 - 6 ditë pas operacionit
- D) 6 - 8 ditë pas operacionit

Infermieri Pyetje: 634

Mamografia është e këshillueshme të bëhet çdo vit për gra:

- A) 20 vjeç
- B) 30 vjeç
- C) 40 vjeç
- D) mbi 50 vjeç

Infermieri Pyetje: 635

Ekstravazacioni është komplikacion pas:

- A) kirurgjisë
- B) kimioterapisë
- C) radioterapisë
- D) radiografisë

Infermieri Pyetje: 636

Traumata e rënda të heparit mund të shkaktojnë:

- A) Insuficiencë renale
- B) Shok hipovolemik si pasojë e hemoragjisë
- C) Hipertension arterial
- D) Leukopeni

Infermieri Pyetje: 637

Në tumoret metastatike të heparit dallohet:

- A) Angiografi negative
- B) Zvogëlim të heparit
- C) Ascit (me nuancë gjaku)
- D) Hiperproteinemi

Infermieri Pyetje: 638

Në kancerin e gjirit nuk ndikojnë:

- A) Historia familjare me këtë diagnozë
- B) Terapia me hormone
- C) Numri i pakët i lindjeve
- D) Ulja e konsumit të yndyrnave shtazore dhe proteinave

Infermieri Pyetje: 639

Për kancerin e gjirit nuk përfshihen këto diagnoza infermierore:

- A) Ndryshime në jetën seksuale
- B) Pamundësi për infeksion
- C) Dëmtim i integritetit të lëkurës
- D) Frikë dhe ankth, lidhur me prognozën e sëmundjes

Infermieri Pyetje: 640

Në pacientët me kancer gastrik:

- A) Hemoragjia është e theksuar
- B) Në raste të rralla ndodh hemoragjia për këtë diagnozë
- C) Ikteri paraqitet në stadin e parë të sëmundjes
- D) Prognoza nuk është shumë e varfër

Infermieri Pyetje: 641

Gjatë realizimit të një transfuzioni gjaku, në 15–30 minutat e para infermieri observon pacientin për :

- A) Shenja reaksioni
- B) Shenja infeksioni
- C) Hipertension
- D) Asnjëra

Infermieri Pyetje: 642

Edukimi i një pacienti me urolitiazë në lidhje me sigurimin e një hidratimi optimal, ka si qëllim kryesor:

- A) Parandalimin e recidivave
- B) Rehidrimin e pacientit
- C) Parandalimin e komplikacioneve
- D) Asnjëra

Infermieri Pyetje: 643

Në karcinomën hepatoqelizore, testet diagnostike shpesh zbulojnë:

- A) Nivele të larta të leukociteve
- B) Nivele të larta të trombociteve
- C) Nivele të larta të AFP (alfafetoproteinës)
- D) Të gjitha

Infermieri Pyetje: 644

Në rastin e gastrektomisë më e rëndësishme është të administrohet:

- A) Vitaminë E
- B) Vitaminë B12
- C) Ushqime me frekuencë të lartë
- D) Ushqime me rrugë orale

Infermieri Pyetje: 645

Ileostomia - Qëllimi i interventeve infermierore nuk përfshin:

- A) Sigurimin e eliminimit normal intestinal
- B) Reduktimin e dhimbjeve dhe spazmave abdominale
- C) Përshkrimin e medikamenteve analgjezike
- D) Reduktimin e ankthit dhe stresit

Infermieri Pyetje: 646

Në prekjen e heparit nga metastazat nuk ndikojnë:

- A) Vaskularizimi i theksuar i heparit
- B) Pozicioni i tij anatomik
- C) Niveli i koshiencës
- D) Tumoret nga trakti gastrointestinal

Infermieri Pyetje: 647

Ileusi adinamik:

- A) Ka një prognozë të varfër
- B) Në përgjithësi ka prognozë të mirë
- C) Trajtimi është gjithmonë kirurgjikal
- D) Është shkaku më i rrallë i obstruksionit intestinal

Infermieri Pyetje: 648

Për të parandaluar ulçerën stazike venoze duhet të:

- A) Ndërpritet aktiviteti fizik
- B) Ekspozohet zona e prekur në temperatura të ftohta
- C) Pozicionohen ekstremitetet më poshtë se niveli i zemrës
- D) Të kontrollohen pulset periferike dhe temperatura e ekstremiteteve

Infermieri Pyetje: 649

Faktor që nuk ndikon në kalkulozën e aparatit urinar është:

- A) Staza urinare
- B) Infeksioni i traktit urinar
- C) Staza venoze
- D) Dehidrimi

Infermieri Pyetje: 650

Për të mbajtur bilancin elektrolitik, nuk është vlerësim specifik:

- A) Niveli i elektroliteve
- B) Marrjet dhe nxjerrjet e likideve
- C) Turgori i lëkurës
- D) Niveli i gazeve në gjak

Infermieri Pyetje: 651

Pacienti me gastrostomi, nuk ka prezencë infeksioni nëse:

- A) Lëkura është e skuqur përreth inçizionit
- B) Është afebril
- C) Ka drenim nga plaga
- D) Leukocitozë

Infermieri Pyetje: 652

Interventet infermierore për pacientin me ileostomi nuk kanë për qëllim:

- A) Reduktimin e dhimbjes
- B) Pakësimin gradual të marrjeve orale
- C) Mbajtjen e bilancit elektrolitik dhe peshës trupore
- D) Sigurimin e eliminimit intestinal

Infermieri Pyetja: 653

Menaxhimi infermior, para kirurgjisë kardiake përfshin:

- A) Vetëm vlerësim të hollësishëm të sistemit kardiak
- B) Vlerësimin e sistemit respirator
- C) Vlerësim të detajuar sistemik
- D) Ndërprerjen e terapisë medikamentoze të mëparshme

Infermieri Pyetja: 654

Stafi infermior instruktton pacientët me patologji të sistemit biliar të:

- A) Shtojnë sasinë e ynyrnave
- B) Të pakësojnë kaloritë dhe yndyrnat në dietën ushqimore
- C) Të shtojnë peshën trupore
- D) Mbajnë regjim absolut pushimi

Infermieri Pyetja: 655

Nuk është prioritet i menaxhimit infermior për pacientët me gastrostomi:

- A) Mbajtja e statusit nutricional
- B) Mbrojtja integritetit të lëkurës
- C) Përshtatja me ndryshimet në imazhin trupor
- D) Përcaktimi i dietës ushqimore specifike për këta pacientë

Infermieri Pyetja: 656

Perfuzioni indor për pacientët me patologji kardiake vlerësohet me të gjitha metodat e mëposhtme përveç njëjës:

- A) Monitorimit të EKG
- B) Matjes së presionit arterial dhe nivelit të gazeve në gjak
- C) Eleminimit urinar
- D) Reagimit nga medikamentet analgjezike

Infermieri Pyetje: 657

Menaxhimi i pacientëve me obstrukcion të zorrës së trashë bëhet me:

- A) Trajtim operator kur bllokimi është i pjesshëm
- B) Intervent kirurgjikal vetëm kur bllokimi është i plotë
- C) Radiografi me barium
- D) Trajtim jo kirurgjikal në rastin e perforimit intestinal

Infermieri Pyetje: 658

Komplikacioni më i shpeshtë për pacientët me ileostomi është:

- A) Kalkuloza urinare
- B) Stenoza stomale
- C) Irritimi i lëkurës peristomale
- D) Cholelithiasis

Infermieri Pyetje: 659

Limadeniti është:

- A) infeksion kirurgjik i nyjeve limfatike
- B) infeksion akut nekrotik
- C) infeksion kirurgjikal i gjendrave të djersës
- D) infeksion akut purulent

Infermieri Pyetje: 660

Ulçera diabetike karakterizohet nga:

- A) Dhimbje shumë të fortë
- B) Dhimbje të moderuar
- C) Dhimbje të lehtë ose mungesë të saj
- D) Mungesa e recidivimit

Infermieri Pyetje: 661

Në diagnozat infermierore në rastin e ileostomisë nuk përfshihet:

- A) Alternime në komfort
- B) Spazma abdominale
- C) Imbalancë lëngjesh dhe elektrolitësh
- D) Stabilitet në eliminimin intestinal

Infermieri Pyetje: 662

Shoku septik fillon me të gjitha shenjat e mëposhtme përveç:

- A) ethe
- B) stres
- C) temperaturë të lartë
- D) hypotension

Infermieri Pyetje: 663

Karbunkuli është:

- A) inflamacion akut nekrotik purulent
- B) infeksion akut-purulent
- C) infeksion kirurgjikal i gjendrave të djersës
- D) infeksion kirurgjik i nyjeve limfatike

Infermieri Pyetje: 664

Organizmi shkaktar për gjendjen e sepsit të rëndë nuk mund të jetë:

- A) Escherichia coli
- B) klebsiella
- C) stafilococcus aureus
- D) virusi

Infermieri Pyetje: 665

Sa duhet të jetë diureza që të themi se funksioni renal vjen duke u përmirësuar?

- A) 20 ml/ore
- B) 25 ml/ore
- C) 30 ml/ore
- D) 40 ml/ore

Infermieri Pyetje: 666

Efektin e vet dëmtues virusi i SIDA-s e ka mbi limfocitet:

- A) A
- B) C
- C) T
- D) E

Infermieri Pyetje: 667

Cili është streptokoku më i hasur tek njerëzit:

- A) hemolitik i grupit E
- B) hemolitik i grupit C
- C) hemolitik i grupit D
- D) hemolitik i grupit A

Infermieri Pyetje: 668

Mononukleoza Infektive shkaktohet nga :

- A) neisseria gonorea
- B) clostridium botulinum
- C) virusi Epstein-Barr
- D) Plasmodium

Infermieri Pyetje: 669

Transmetimi i sëmundjes infektive nga një vektor mekanik vjen nga:

- A) mizat
- B) mushkonjat
- C) karkalecat
- D) gjinkallat

Infermieri Pyetje: 670

Transmetimi i sëmundjes infektive nga një vektor organik vjen nga:

- A) mizat
- B) mushkonjat
- C) karkalecat
- D) gjinkallat

Infermieri Pyetje: 671

Tipar i përbashkët i gjithë infeksioneve kirurgjikale është:

- A) nekroza
- B) fistula
- C) hemorragjia
- D) hipotermia

Infermieri Pyetje: 672

Shkalla e prevalencës është raporti :

- A) nr total i të sëmurëve me sëmundje infektive / nr. i pacientëve në total
- B) nr. i pacientëve në total / nr.total i të sëmurëve me sëmundje infektive
- C) nr. i pacientëve në spital në krahasim me popullatën
- D) nr. i pacientëve në infektiv / me nr. e pacientëve në spital

Infermieri Pyetje: 673

Incidenca e infeksionit për plagët operatore të pastra duhet të jetë:

- A) nën 5%
- B) nën 7 %
- C) nën 10 %
- D) nën 15 %

Infermieri Pyetje: 674

Nuk bën pjesë në plagët e mbyllura:

- A) Kontuzioni
- B) Hematomat
- C) Sindromi Crush
- D) Plagët incizionale

Infermieri Pyetje: 675

Nuk bën pjesë në manifestimet klinike të Kontuzionit:

- A) Hematoma
- B) Fraktura
- C) Hemorragjia
- D) Nauze/të vjella

Infermieri Pyetje: 676

Shkaktari më i shpeshtë i infeksioneve spitalore është :

- A) E. Coli
- B) Candidas
- C) Spiroketa
- D) Streptokoku

Infermieri Pyetje: 677

Periudha e inkubacionit të mononukleozës infektive varion :

- A) 10- 20 ditë
- B) 20- 30 ditë
- C) 30- 50 ditë
- D) 40- 60 ditë

Infermieri Pyetje: 678

Triada ethe - dhimbje fyti- zmadhim i nodjve limfatik cervikal është karakteristik e:

- A) tetanozit
- B) meningokoksisë
- C) mononukleozës infektive
- D) stafilokoksisë

Infermieri Pyetje: 679

Forma më e shpeshtë e salmonelozës është :

- A) ethet tifoide
- B) forma gastrointestinale
- C) bakteremia me ose pa infektion
- D) mbartja asimptomatike

Infermieri Pyetje: 680

Sëmundja e "papastërtisë" mund të quhet

- A) salmoneloza
- B) amebiaza
- C) ethet tifoide
- D) shigeloza

Infermieri Pyetje: 681

Përfshihet në shkaqet e hemorragjisë digjестive të poshtme:

- A) variçet e ezofagut
- B) gastritet
- C) divertikuli i Meckelit
- D) sindromi Mallory-Weiss

Infermieri Pyetje: 682

Infeksionet Nosokomiale ndryshe quhen:

- A) komune
- B) ambientale
- C) spitalore
- D) shtëpiake

Infermieri Pyetje: 683

Është karakteristike për hemorragjinë venoze:

- A) gjaku me ngjyrë të kuqe
- B) gjaku rrjedh me pulsacione
- C) rrjedhje e pandërprerë e gjakut
- D) rrjedhje e ngadalshme e gjakut të errët

Infermieri Pyetje: 684

Nuk bëjnë pjesë në grupin e përhapjes së infeksionëve nga vektorët:

- A) njerëzit
- B) minjtë
- C) mizat
- D) mushkonjat

Infermieri Pyetja: 685

Faktorët e rrezikut për infeksione spitalore të plagëve janë të gjitha përveç:

- A) përkujdesja perioperative
- B) sterilizimi i pajisjeve
- C) gjendja e të sëmurit
- D) statusi emocional i të sëmurit

Infermieri Pyetja: 686

Vaksina profilaktike për hepatitin B aplikohet në:

- A) një dozë
- B) dy doza
- C) tre doza
- D) katër doza

Infermieri Pyetja: 687

Nuk bën pjesë në imobilizimin e jashtëm:

- A) gipsi
- B) qaforia
- C) protezat
- D) traksioni

Infermieri Pyetja: 688

Osteomieliti është:

- A) frakturë e kockës
- B) infeksioni i kockës
- C) distorcion i artikulacionit
- D) rupturë ligamenti

Infermieri Pyetje: 689

Fiksatori ekstern përdoret në :

- A) rupturën e ligamenteve
- B) rupturën e tendinave
- C) frakturë të kockave të shkurtra
- D) frakturë të kockave të gjata

Infermieri Pyetje: 690

Sa kohë mbahet longeta e allçisë në frakturën e kockave të parakrahut?

- A) 2 javë
- B) 3 javë
- C) 6 javë
- D) 8 javë

Infermieri Pyetje: 691

Koha e tharjes së allçisë në ekstremitete është:

- A) rreth 10-12-orë
- B) rreth 12-24 orë
- C) rreth 24-48 orë
- D) rreth 48-72 orë

Infermieri Pyetje: 692

Traksioni pelvik është:

- A) i vazhdueshëm
- B) statik
- C) dinamik
- D) intermitent

Infermieri Pyetje: 693

Vlerësimi i mekanizmave të dëmtimit dhe e forcave kinetike që kanë vepruar mbi pacientin gjatë një incidenti traumatik ose aksidenti quhet:

- A) energji kinetike
- B) kinetika e traumës
- C) procesi i traumës
- D) shpejtësia e goditjes

Infermieri Pyetje: 694

"Ora e artë" ju kujton:

- A) koha në të cilën ndodh një politraum
- B) koha në të cilën transportohet një person i aksidentuar
- C) dhënia e ndihmës brenda 1 ore nga koha e dëmtimit
- D) mbledhja e të dhënave për një person të aksidentuar

Infermieri Pyetje: 695

Një frakturë quhet e stresuar kur:

- A) muskujt mbështjellës nuk e akumulojnë më energjinë e nevojshme
- B) ndodh si pasojë e patologjive të ndryshme
- C) ndodh si pasojë e traumave të jashtëme
- D) ndodh si pasojë e osteomielitit

Infermieri Pyetje: 696

Esenciale kur transportohet një pacient me politraum është:

- A) mbështjellja e pacientit
- B) imobilizimi i kokës dhe i qafës
- C) imobilizimi i ekstremiteteve të sipërme
- D) infuzionimi i pacientit

Infermieri Pyetja: 697

Në cilin lloj të traksionit sasia e peshave që aplikohet është me e vogel:

- A) te lekurës
- B) skeletal
- C) statik
- D) dinamik

Infermieri Pyetja: 698

Fiksatorët ekstern në ekstremitetet e sipërme hiqen pas:

- A) 2 javë
- B) 4 javë
- C) 6 javë
- D) 8 javë

Infermieri Pyetja: 699

Cili është qëllimi kryesor i vlerësimit infermieror preoperator?

- A) Të reduktojë morbiditetin dhe mortalitetin perioperator
- B) Të merren të dhëna për sëmundjen kirurgjikale
- C) Të hartohet një strategji menaxhimi
- D) Të hartohet një plan anestetik

Infermieri Pyetja: 700

Sa orë para duhet të ushqehen neonatët dhe fëmijët para kirurgjisë?

- A) 2 orë para kirurgjisë
- B) 30 minuta para kirurgjisë
- C) 6 orë para kirurgjisë
- D) 4 orë para kirurgjisë

Infermieri Pyetje: 701

Bronkospazma mund të shkaktojë:

- A) Qëndrueshmëri hemodinamike
- B) Hiperventilim postoperator
- C) Insuficiencë renale
- D) Hipoventilim dhe hipoksemi

Infermieri Pyetje: 702

Insuficienca respiratore në kirurgjinë abdominale ndodh nga shkaqet e mëposhtme përveç:

- A) Depresion i qendrës respiratore pas anestezisë
- B) Distensioni abdominal
- C) Dhimbja abdominale
- D) Hemorragji nga plaga

Infermieri Pyetje: 703

Cili është standarti bazë për të vlerësuar shkëmbimin e gazeve në pulmone:

- A) vlera e presionit arterial të dioksidit të karbonit
- B) vlera e presionit arterial të oksigjenit
- C) gazanaliza e gjakut arterial
- D) vlera e oksihemoglobinës

Infermieri Pyetje: 704

Vlera e saktë e presionit arterial të oksigjenit është:

- A) 50-70 mmHg
- B) 90-100 mmHg
- C) 100-120 mmHg
- D) 30-40 mmHg

Infermieri Pyetje: 705

Shoku hipovolemik shkaktohet nga humbja e:

- A) më shumë se 20-25% të masës qarkulluese të gjakut
- B) më pak se 5-10% të masës qarkulluese të gjakut
- C) afërsisht 2-3% të masës qarkulluese të gjakut
- D) 1-5% të masës qarkulluese të gjakut

Infermieri Pyetje: 706

Në shokun hipovolemik kemi:

- A) Hipertension
- B) Lëkurë të zbehtë dhe të ftohtë
- C) Puls i ngadaltë
- D) Diurezë të shtuar

Infermieri Pyetje: 707

Interventet infermirore në rastin e shokut fillojnë me:

- A) Rivendosjen e funksionit kardiak
- B) Reduktimin e ankthit
- C) Përmirësimin e oksigjenimit
- D) Rivendosjen e bilancit elektrolitik

Infermieri Pyetje: 708

Likidet intravenoze zëvendësuese:

- A) Mbajnë volumin në hapësirën vaskulare
- B) Nuk japin asnjëherë reaksione alergjike
- C) Janë trajtues të hipovolemisë
- D) Përfshijnë edhe plazmën e frekët të ngrirë

Infermieri Pyetje: 709

Pas ingestionit të substancave korrozive është i kundërlinduar:

- A) Shplarja me likide menjëherë pas ingestionit
- B) Lavazhi gastrik
- C) Hollimi i substancës korrozive
- D) Sigurimi i rrugëve respiratore

Infermieri Pyetje: 710

Në helmimet ingestive me helme, kur pacienti nuk është koshient së pari aplikojmë:

- A) Lavazhin me sondë orogastrike
- B) Aspirimin gastrik
- C) Vendosja e tubit endotrakeal për të mbrojtur rrugët respiratore
- D) Provokimin e të vjellave

Infermieri Pyetje: 711

Në helmimet me substanca fortësisht acide ose bazike kundërlindohen:

- A) Inserimi i sondës nazogastrike me shumë kujdes
- B) Radiografia
- C) Provokimi i të vjellave
- D) Përdorimi i qumështit në raste të veçanta

Infermieri Pyetje: 712

Veprimi i parë infermior në rastin e reaksionit akut hemolitik është:

- A) Administrimi i kortikosteroideve
- B) Trajtimi i hipotensionit me likide dhe vazopresorë
- C) Dërgimi i një mostre gjaku në bankën e gjakut
- D) Ndërprerja e menjëhershme e transfuzionit

Infermieri Pyetje: 713

Shkalla e ndryshimeve që ndodhin në organizmin e të operuarit nuk varet nga:

- A) përgatitja preoperatorë
- B) gjendja e të sëmurit pas operacionit
- C) lloji i anestezisë
- D) lloji i ndërhyrjes kirurgjikale

Infermieri Pyetje: 714

Dhimbja e patrajtuar shkakton:

- A) Rritjen e kërkesave për oksigjen
- B) Ulje të pulsit
- C) Ulje të presionit arterial
- D) Reduktim të ideve suicidale

Infermieri Pyetje: 715

Në komplikacionet e mëvonshme të operacionit bën pjesë:

- A) infeksioni
- B) ethe reumatizmale
- C) pneumotoraks valvular
- D) skoliozë

Infermieri Pyetje: 716

Vlerat e presionit venoz central janë:

- A) Shumë të ulëta në shokun hipovolemik
- B) Shumë të ulëta në shokun septik
- C) Normale në shokun kardiogjen
- D) Shumë të larta në shokun hemoragjik

Infermieri Pyetje: 717

Shoku është një sindrom i:

- A) Hipertensionit dhe perfuzionit relativisht të lartë indor
- B) Presionit arterial të lartë
- C) Hipotensionit dhe perfuzionit të ulët indor
- D) Rritjes së masës qarkulluese

Infermieri Pyetje: 718

Rastet kur indikohet intubimi endotrakeal:

- A) Ventilim i përshtatshëm
- B) Rrugëve respiratore të lira
- C) Saturimi i oksigjenit është mbi 90%
- D) Insuficienca respiratore me hiperkapni

Infermieri Pyetje: 719

Nuk bën pjesë në instrumentat kirurgjikale:

- A) pincat
- B) bisturia
- C) diverikatorët
- D) defibrilatori

Infermieri Pyetje: 720

Nuk është qëllim i pastrimit të plagës në ulcer:

- A) largimi i fibrinës
- B) largimi i nekrozës
- C) largimi i gjakut
- D) largimi i fistulës

Infermieri Pyetje: 721

Halotani është lëndë anestetike e cila përdoret:

- A) Vetëm tek fëmijët
- B) Vetëm tek të rriturit
- C) Tek fëmijët dhe të rriturit
- D) Duke mos u përzier me oksigjenin

Infermieri Pyetje: 722

Obeziteti nuk favorizon komplikacione postoperatore të tilla si :

- A) Infeksion
- B) Dehishencë të suturave
- C) Obstruksion të rrugëve respiratore
- D) Psikozën postoperatore

Infermieri Pyetje: 723

Ulcerat venoze shfaqen nga:

- A) diabeti
- B) fistulat artero-venoze
- C) infeksionet e lëkurës
- D) pamjaftueshmëria arteriale

Infermieri Pyetje: 724

Obstruksioni respirator nuk manifestohet me:

- A) Cianozë
- B) Apne
- C) Nivele normale të gazeve në gjakun arterial
- D) Përdorim të muskujve aksesori

Infermieri Pyetje: 725

Në rastin e ventilimit jo të përshtatshëm kemi:

- A) Ulje të presionit të dioksidit të karbonit
- B) Ulje të PH të gjakut (acidozë respiratore)
- C) Rritje të PH sistemik
- D) Funkcion të ruajtur të miokardit

Infermieri Pyetje: 726

Stafi infermior për interventin kirurgjikal nuk mund të përcaktojë:

- A) Diagnozën, lidhur me ankthin preoperator
- B) Diagnozën, lidhur me nivelin e dhimbjes
- C) Llojin e anesteziës që do të aplikohet
- D) Komplikacionet potenciale në periudhën postoperative

Infermieri Pyetje: 727

Kateterët ureteral kanë qëllim:

- A) Diagnostik
- B) Parandalues
- C) Terapeutik
- D) Evakuativ

Infermieri Pyetje: 728

Nuk bën pjesë në komplikacionet e menjëhershme pas operacionit:

- A) Hipertension
- B) Hipotension
- C) Hipotermi
- D) Hiperkalcemi

Infermieri Pyetje: 729

Ku bën pjesë metoda kalendarike?

- A) Në kontraktivët oralë
- B) Në metodat natyrale
- C) Në metodat barrjerë
- D) Në metodat kimike

Infermieri Pyetje: 730

Cili është mekanizmi i veprimit të një spermicidi?

- A) Mbajtja e pH acid të vaginës
- B) Mbajtja e pH alkaline të vaginës
- C) Hollimit të mukosit cervikal
- D) Trashje të mukosit cervikal

Infermieri Pyetje: 731

Cila nga simptomat e mëposhtme bën që gruaja të ndërpres menjëherë kontraktivët oral të kombinuar dhe të paraqitet tek mjeku?

- A) Çrregullime të të parit
- B) Perforacion të uterusit
- C) Infeksion
- D) Temperaturë

Infermieri Pyetje: 732

Sekretionet vaginale me erë si të peshkut të prishur është karakteristike për cilin nga këto infeksione:

- A) Herpesin genital
- B) Infeksioni nga gonorea
- C) Infeksioni nga chlamydia
- D) Vaginozën bakteriale

Infermieri Pyetja: 733

Shfaqja e ulçeracionit që në momentin e parë të inokulimit të shkaktarit në organet genitale është karakteristike për infeksion nga:

- A) Trikomoniaza
- B) Gonorrea
- C) Sifilizi
- D) Klamidia

Infermieri Pyetja: 734

Cili nga infeksionet seksualisht të transmetueshme ka mundësi të çojë në kancer të traktit genital?

- A) Human Papiloma Virus
- B) Infeksioni trikomonial
- C) Vaginoza bakteriale
- D) Infeksioni mykotik

Infermieri Pyetja: 735

Dhimbje në kuadratet e poshtme abdominale, temperaturë, gjakrrjedhje vaginale të herë pas herëshme, sekrecione vaginale purulente, nauze, të vjella; kuadri klinik i cilës patologji i referohet:

- A) Sindromit të Shokut Toksik
- B) Sëmundjes Inflamatore Pelvike
- C) Infeksionit trikomonial
- D) Infeksionit herpetik

Infermieri Pyetje: 736

Zonja X është beqare dhe përshkruan jetën e saj seksuale, si aktive dhe me shumë partnerë. Ajo dëshiron të përdorë një metodë kontraktive, e cila është e sigurtë dhe që nuk ndikon në aktivitetin e saj seksual. Ajo kërkon D.I.U.. Përgjigja më e përshtatshme e mamisë do të jetë:

- A) D.I.U. do t'ju mbrojë ju nga SST
- B) D.I.U. nuk ndikon në aktivitetin seksual
- C) Përqindja e shtatzanive është më e lartë me D.I.U.
- D) Rreziku i Sëmundjes Inflammatorë Pelvike është më i madh për ju

Infermieri Pyetje: 737

Cila nga metodat kontraktive të mëposhtme përveç efektit kontraktiv ka ndikim për të parandaluar infeksionet seksualisht të transmetueshme?

- A) Dispozitivi intrauterin
- B) Kontraktivi oral
- C) Sterilizimi kirurgjikal
- D) Spermicidet

Infermieri Pyetje: 738

Perforacioni i uterusit është komplikacioni i cilës metode kontraktive:

- A) Metodave barijere
- B) Sterilizimit kirurgjikal
- C) Kontraktiveve injektueshëm
- D) Dispozitivit intrauterin

Infermieri Pyetje: 739

Karakteristika e sekrecioneve vagjinale në infeksionin mykotik është:

- A) Sekrecione të pakta në sasi por pa erë
- B) Sekrecione të pakta në sasi por me erë
- C) Sekrecione të shumta, të trasha pa erë
- D) Sekrecione të shumta, të trasha me erë

Infermieri Pyetje: 740

Cila nga infeksionet seksualisht të transmetueshme shoqërohet me sëmundjen inflamtoe pelvike, barrën ekstrauterine, infertilitetin?

- A) Gonorea
- B) Kondyloma
- C) Klamidia
- D) Herpesi

Infermieri Pyetje: 741

Mbrojtja abdominale që përfitohet gjatë palpacionit është një e dhënë e rëndësishme që ndodh në:

- A) Sëmundjen Inflamtoe Pelvike
- B) Sindromin e Shokut Toksik
- C) Infeksionin moniliar
- D) Vaginozën bakteriale

Infermieri Pyetje: 742

Nga se shkaktohet infertiliteti?

- A) Përdorimi i tamponëve vaginalë
- B) Sëmundjet seksualisht të transmetueshme
- C) Përdorimi i metodave barijere
- D) Përjetimi i infeksionit mykotik

Infermieri Pyetje: 743

Cila nga metodat kontraktive ka efekt më të gjatë?

- A) Injeksionet Depo-Provera
- B) Kontraktivi i urgjencës
- C) Implantet subdermale
- D) Spermicidet

Infermieri Pyetje: 744

Cili nga infeksionet e mëposhtme nuk ka mjekim specifik por vetëm simptomatik?

- A) Sifilizi
- B) Herpesi Genital
- C) Gonorrea
- D) Klamidia

Infermieri Pyetje: 745

Sëmundja inflamatore pelvike jep infeksionin:

- A) Salpingitis
- B) Otitis
- C) Iritis
- D) Artrit

Infermieri Pyetje: 746

Pilulat kontraceptive të kombinuara veprojnë sipas mekanizmit të mëposhtëm përveç:

- A) nivelet e larta të estrogenit parandalojnë ovulacionin duke inhibuar prodhimin e FSH
- B) progesteroni mban mukusin cervical të trashë dhe bën kështu të vështirë penetrimin e spermës.
- C) progesteroni ndryshon shtresën e uterusit dhe e bën të papërshtatshme implantimin e vezës.
- D) veprojnë lokalisht në uterus

Infermieri Pyetje: 747

Kur gruaja shtatzanë paraqitet për herë të parë në klinikë mamia/mjeku i drejton disa pyetje rreth hepatitit, të cilat bëjnë pjesë në:

- A) Anamnezën e kaluar obstetrikale
- B) Anamnezë personale dhe familjare
- C) Historinë mjekësore
- D) Anamnezë gjenetike

Infermieri Pyetja: 748

Pacientet me diabet gestacional zakonisht menaxhohen me:

- A) Dietë
- B) Insulinë me veprim të zgjatur
- C) Hipoglicemiantë oralë
- D) Hipoglicemiantë oralë dhe insulin

Infermieri Pyetja: 749

Cila nga alternativat bën pjesë në anamnezën gjinekologjike?

- A) Histori për dysmenorrhea
- B) Infeksione gjatë periudhes së post partumit
- C) Probleme të post partumit hemoragjik
- D) Rezultatet e testeve të barrës, nëse janë kryer

Infermieri Pyetja: 750

Cila nga alternativat perfshihet në anamnezën obstetrikale?

- A) Cila ka qënë mënyra e lindjes?
- B) Kur ka ndodhur kojtusi i parë?
- C) Kë Metodë kontrceptive ke përdorur?
- D) Sa është numri i partnereve seksual?

Infermieri Pyetja: 751

Konjugata diagonale është distanca midis:

- A) Buzës së sipërme të simfizës pubike & promontoriumit
- B) Dy tuberoziteteve iskiadike
- C) Pjesës së pasme të simfizës pubike & promontoriumit
- D) Promontoriumit sacral & buzës së poshtme të simfizës pubike

Infermieri Pyetje: 752

Konjugata e vërtetë është distanca midis :

- A) Buzës së sipërme të simfizës pubike & promontoriumit
- B) Dy tuberozitetëve iskiadike
- C) Promontoriumit sacral & buzës së poshtme të simfizës pubike
- D) Pjesës së pasme të simfizës pubike & promontoriumit

Infermieri Pyetje: 753

Pjesa e pelvisit e cila është më shumë e përfshirë me lindjen është:

- A) Koksiksi
- B) Pelvisi falls
- C) Pelvisi i vërtetë
- D) Sakrumi

Infermieri Pyetje: 754

Informacioni i siguruar nga metodat e Leopoldit përfshin:

- A) Paraqitjen fetale
- B) Rritjen dhe zhvillimin fetal
- C) Vlersimin e toneve fetale
- D) Vlersimin e tonusit maternal

Infermieri Pyetje: 755

Metodat e Leopoldit kryesisht janë përdorur për të:

- A) Për të hequr presurën nga kordoni umbilikal
- B) Përcaktuar nëse vezika është e distenduar
- C) Sygjeruar vendin e monitorimit external të kontraksioneve uterine
- D) Vlerësuar prezentacionin dhe zbritjen

Infermieri Pyetje: 756

Frekuenca normale e toneve fetale është:

- A) 90 - 100 rrahje për minut
- B) 180 rrahje për minut
- C) 90 - 140 rrahje për minut
- D) 120 - 160 rrahje për minut

Infermieri Pyetje: 757

Një grua 4 javëshe shtatzanë i kërkon mamisë se kur ajo është në gjendje të dëgjojë RZF- të e fëmijës së saj. Mamia i thotë asaj se me stetoskop ultrasonografik special apo fetoson i cili i amplifikon (i zmadhon) tonet, R.Z.F. mund të dëgjoen afërsisht

- A) 2 - 4 javësh
- B) 6 - 8 javësh
- C) 10 - 12 javësh
- D) 14- 16 javësh

Infermieri Pyetje: 758

Rrahjet e Zemrës Fetale nuk dëgjoen me stetoskop të zakonshëm obstetrikal kur kemi:

- A) Anomali fetale
- B) Moshë barre 28 javë
- C) Shtatzani me më shumë se një fetus
- D) Obezitet amtar

Infermieri Pyetje: 759

Sa shpejt arrin të përcaktojë barrën, ekografia me sondë vaginale?

- A) 6 javë
- B) 4 javë
- C) Afërsisht 10 javë
- D) Pas 10 ditësh

Infermieri Pyetje: 760

Si shenjë pozitive e barrës përfshihet:

- A) Amenorrhea
- B) Lëvizjet fetale që ndihen nga nëna
- C) Rritja abdominale
- D) Sonographya

Infermieri Pyetje: 761

Një shenjë supozuese e shtatzanisë është:

- A) Kontraksionet e Braxton- Hicks
- B) Ndërprerja e menseve
- C) Shenja e Hegarit
- D) Zhurmat uterine

Infermieri Pyetje: 762

Shenja Goodell është:

- A) Diskolorim (cerviksit, mukozës së vaginës & vulvës)
- B) Përkulja e trupit të uterusit mbi cerviks
- C) Zbutja e cerviksit
- D) Zbutja e istmusit

Infermieri Pyetje: 763

Në ekzaminimin fizik, mamia vë re se cervixi i gruas është në ngjyrë të kaltër. Kjo është shënja:

- A) Cheduik
- B) Goodell
- C) e Hegarit
- D) Mc Donald (Lading)

Infermieri Pyetje: 764

Cila nga pikat e mëposhtme nuk bën pjesë në ndryshimet e lëkurës gjatë shtatzanisë?

- A) Kloasoma gravidarum
- B) Linea nigra
- C) Shenja e Hegarit
- D) Striae gravidarum

Infermieri Pyetja: 765

Mamia i shpjegon gruas se gjatë shtatzanisë sëmundja e mëngjesit (nausea & të vjellat) zakonisht takohet në :

- A) Gjashte javët e para
- B) Në 6 j - 12 j
- C) Në 8j - 16j
- D) Në muajin e pare

Infermieri Pyetja: 766

Cila nga pikat e mëposhtme nuk ndikon në lartësinë e fundusit uterin?

- A) Barra binjake
- B) Hydramnioni
- C) Qëndrimi fetal
- D) Tonusi muskular

Infermieri Pyetja: 767

Lëvizjet aktive fetale perceptohen fillimisht në:

- A) Dymbëdhjetë javë
- B) Mes muajit të gjashtë dhe të shtatë
- C) Në muajin e tretë të barrës
- D) Para se të përfundojë muaji i katërt

Infermieri Pyetja: 768

Kujdesi prenatal është ideale të fillojë:

- A) Pas mundesës së tretë të menseve
- B) Pas mungesës së dytë të menseve
- C) Pas mungesës së parë të menseve
- D) Përpara mungesës parë të menseve

Infermieri Pyetje: 769

Në 16 javë niveli i fundusit uterin është:

- A) 1/3 e poshtme që bashkon umbilikusin me procesin ksifoid
- B) 1/2 e vijës që bashkon simfizën pubike me umbilikusin
- C) 2/3 e vijës që bashkon umbilikusin me procesin ksifoid
- D) Një gisht nën umbilicus

Infermieri Pyetje: 770

Në 24 javë niveli i fundusit uteri është:

- A) 1/3 e poshtme që bashkon umbilikusin me procesin ksifoid
- B) 1/2 e poshtme që bashkon umbilikusin me procesin ksifoid
- C) 1 - 2 gisht mbi umbilicus
- D) 3 - 4 gisht nën procesin ksifoid

Infermieri Pyetje: 771

Zonja X është 14 javë shtatzanë. Mamia duhet të palpojë fundusin e uterusit në nivelin:

- A) Në nivelin e umbilikusit
- B) Nuk palpohet mbi simfizën pubike
- C) Pak mbi simfizën pubike
- D) Pak mbi umbilikusin

Infermieri Pyetje: 772

Znj është në javën e 23 të shtatzanisë. Ajo është informuar se shenjë alarmi në shtatzani është:

- A) Palpitacioni kardiak
- B) Rritja e oreksit
- C) Ulja e lëvizjeve fetale
- D) Ulja e presionit të gjakut

Infermieri Pyetje: 773

Cila nga simptomat e mëposhtme konsiderohet si shenjë paralajmëruese e një problemi potencial, dhe gruaja shtatzanë duhet të raportojë menjëherë personelin e kujdesit shëndetësor?

- A) Gjakrrjedhje vaginale
- B) Lodhje
- C) Nausea
- D) Shtim i frekuencës urinare

Infermieri Pyetje: 774

Kultura për gonorrhea në shtatzani përfshihet si një nga testet rutinë e cila rekomandohet të bëhet në:

- A) Çdo fillim muaji gjatë shtatzanisë,
- B) Fillim të vizitës së parë prenatale
- C) Përfundim të muajit të fundit të shtatzanisë
- D) Vizitën e parë prenatale dhe përsëritet në 36 javë

Infermieri Pyetje: 775

Ç' ndryshim mund të shkaktojë pozicioni lithotomik, në presionin e gjakut tek gruaja shtatzanë?

- A) Asgjë e veçantë nuk vihet re
- B) E rrit presionin e gjakut
- C) E ulë presionin e gjakut
- D) Rrit dhe ul, varet nga linja bazë e presionit të gjakut

Infermieri Pyetje: 776

Në vizitat e radhës, në shtatzaninë e pakomplikuar zakonisht nuk përfshihet:

- A) Dëgjimi i RZF-ve
- B) Ekzaminimin vaginal
- C) Manovrat e Leopoldit
- D) Matjet e lartësisë së fundusit

Infermieri Pyetja: 777

Okupimi në punë i gruas gjatë shtatzanisë:

- A) Duhet të reduktohet në tremestrin e tretë
- B) Nuk ka probleme në barrën normale
- C) Rrit rrezikun e problemeve në barrë
- D) Ul riskun e problemeve në barrë

Infermieri Pyetja: 778

Mamia instruktin gruan të zbatojë ushtrimet e Kegelit, pasi ato:

- A) Forcojnë dyshemenë pelvike
- B) Ndhmojnë në zbritjen e fetusit
- C) Ndhmojnë në zbutjen e columit
- D) Përshpejtojnë aktin e lindjes

Infermieri Pyetja: 779

Pozicioni që ju i rekomandoni gruas shtatzanë për t'u çlodhur ose fjetur është:

- A) Anash
- B) Gjysëm ndenjtur.
- C) Në shpinë
- D) Permbys

Infermieri Pyetja: 780

Dita e parë e zakoneve të fundit të gruas ka qënë 3 Maj 2011, duke përdorur rregullën e Negelit kësaj gruaje i takon të lindë:

- A) 10 shkurt 2012
- B) 10 mars 2012
- C) 31 qershor 2012
- D) 06 korrik 2012

Infermieri Pyetje: 781

Cila nga vaksinat e mëposhtme mund të administrohet gjatë shtatzanisë?

- A) Parotitit
- B) Poliomeilitit
- C) Rabies
- D) Varicelës

Infermieri Pyetje: 782

Cila nga vaksinat e mëposhtme nuk duhet të administrohen gjatë shtatzanisë?

- A) Difteria
- B) hepatiti b
- C) Parotiti
- D) Rabies

Infermieri Pyetje: 783

Për të përcaktuar frekuencën e kontraksioneve uterine mamia do të vlersojë kohën nga:

- A) Fillimi i një kontraksioni deri në fund të kontraksioni tjetër
- B) Fundi i një kontraksioni deri në fund të kontraksionit tjetër
- C) Shpërthimi i kontraksionit deri në fund
- D) Shpërthimi i një kontraksioni deri në shpërthimin e kontraksionit tjetër

Infermieri Pyetje: 784

Në stadin e parë të lindjes shenja vendimtare që tregon për kontraksione uterine efektive është:

- A) Dilatacioni i cerviksit
- B) Ruptura e membranave amniotike
- C) Shfaqja e një sasive hemorragjie
- D) Zbritja e fetusit

Infermieri Pyetje: 785

Mamia i mëson gruas shtatzanë rreth karakteristikave të kontraksioneve të aktivitetit të vërtetë. Mamia vlerëson të arsyetuarit e gruas nëpërmjet instruksionit kur gruaja "do të përjetojë kontraksione të aktivitetit të vërtetë:

- A) Ato shkaktojnë diskomfort në pjesën e sipërme të uterusit
- B) Kontraksionet uterine do të bien kur unë do të ecë
- C) Vazhdojnë të jenë të çrregullta, por bëhen të forta.
- D) Vazhdojnë të jenë të forta edhe nëse unë relaxohem e bëj një dush

Infermieri Pyetje: 786

Infermierja është duke parë një grua që sapo ka bërë një test shtatzanie dhe rezulton pozitiv. Pas ekzaminimit vaginal infermierja bën shënime në kartelë. Cila nga gjetjet e mëposhtme është sinjifikative për këtë moshë shtatzanie :

- A) Zbutje të cerviksit
- B) Një zhurmë e lehtë që korrespondon me pulsën e nënës gjatë dëgjimit të uterusit
- C) Prezencën e HCG në urinë
- D) Prezencën e lëvizjeve fetale

Infermieri Pyetje: 787

Cila nga pikat e mëposhme nuk bën pjesë në nënfazat e stadi të parë të aktivitetit të lindjes?

- A) Faza aktive
- B) Faza e expulsionit
- C) Faza e tranzicionit
- D) Faza latente

Infermieri Pyetje: 788

Cila fazë e aktivitetit të lindjes është më e gjatë?

- A) Dytë
- B) Katërt
- C) Parë
- D) Tretë

Infermieri Pyetje: 789

Faza e dytë e lindjes nis me:

- A) 1 - 2 orët e para pas daljes së placentës
- B) Dilatacionin komplet dhe përfundon me lindjen e infantit
- C) Fillimin e hapjes dhe zbutjes së cerviksit
- D) Lindjen e infantit dhe përfundon me lindjen e placentës

Infermieri Pyetje: 790

Faza e tretë e lindjes nis me :

- A) 1-2 orët e para pas lindjes
- B) Dilatacionin komplet
- C) Lindjen e infantit
- D) Me përfundimin e fazës aktive

Infermieri Pyetje: 791

Në njësinë e paralindjes mamia po ndjek një grua primigravida. Ajo do ta lejojë gruan të shterzojë kur dilatacionin i qafës së mitrës të jetë:

- A) 10cm
- B) 5 cm
- C) 7cm
- D) 8cm

Infermieri Pyetje: 792

Infermierja shoqëron ekspulsionin e placentës duke administruar oxytocinë për:

- A) Lehtësimin e dhimbjeve
- B) Lehtësuar qëndrimin dhe relaximin
- C) Prevenimin e infeksionit
- D) Parandalimin e e hemoragjise pas lindjes

Infermieri Pyetje: 793

Cilat nga pikat e mëposhtme nuk i tregojnë mamisë shkolitjen e placentës?

- A) Kontraksionet uterine
- B) Ndryshime të TA dhe pulsit
- C) Ndryshimi i formës së uterusit
- D) Shtim i një sasive hemorragjie

Infermieri Pyetje: 794

Një grua duhet të marrë në konsideratë këshillimin gjenetik nëse në kohën që do të mbetet shtatzanë është :

- A) 30 vjeç ose më shumë
- B) 35 vjeç ose më shumë
- C) midis 25 vjeç dhe 30 vjeç
- D) nën 35 vjeç

Infermieri Pyetje: 795

Gjatë palpimit për të përcaktuar fundusin uterin tek një grua që sapo ka lindur, ju vini re se fundusi i saj është i fortë dhe tre gishtë gjëresë mbi umbelikus dhe i devijuar. Ju duhet të:

- A) Kontrolloni për shtim të lohjeve
- B) Masazhoni uterusin e fortë
- C) Matni presionin arterial
- D) Palponi për vezikë urinare të distenduar

Infermieri Pyetje: 796

Pritshmëria e mamisë lidhur me involucionin normal uterin në periudhën post partumit do të ishte, zbritja e uterusit :

- A) 1 cm në ditë
- B) 1 cm në dy ditë
- C) 1 cm në tre ditë
- D) 1 cm në javë

Infermieri Pyetje: 797

Dhimbja e fortë e kokës në tremestrin e tretë të shtatzanisë, mund të jetë shenjë paralajmëruese për:

- A) Dehidratim
- B) Hypertension
- C) Lodhje
- D) Pamjaftueshmëri ushqimi

Infermieri Pyetje: 798

Eklampsia është:

- A) Hipertensioni i zhvilluar menjëherë pas lindjes
- B) Prania e hipertensionit para 20 javësh gravidancë
- C) Prania e hipertensionit pas 20 javësh gravidancë
- D) Preeklampsi plus konvulsione, koma ose të dyja

Infermieri Pyetje: 799

Znj. X ka eklampsi. Detyra e parë e mamisë është:

- A) Administrimi i O₂ me maskë
- B) Aspirimin e përmbajtjes së gojës për të parandaluar kalimin në rrugën e frymëmarrjes
- C) Të fusë ajër në rrugë orale
- D) Të qëndrojë me pacienten dhe të telefonojë për ndihmë

Infermieri Pyetje: 800

Znj. X shtrohet në spital për të stimuluar lindjen për arsye të HT të induktuar nga barra. Analizat laboratorike tregojnë vlerën e trombociteve 90.000, rritje të transaminazave, dhe ulje të hematokritit. Infermeria njofton mjekun se rezultatet laboratorike

- A) HELLP sindrom
- B) K.I.D.
- C) Preeklampsi
- D) Trombocitopeni idiopatik

Infermieri Pyetje: 801

Infermierja po merr anamnezën e znj. X gjatë vizitës së parë prenatale kur gruaja rezultoi 10 javë me barrë. Cila prej pikave të mëposhtme tregon që znj. X është në rrezik për zhvillimin e diabetit gestacional gjatë kësaj barre:

- A) Ajo është 28 vjeçe
- B) Fëmija i parë i saj ka lindur me seksio
- C) Në anamnezën familjare rezultoi diabet i tipit të I-rë
- D) Pësha e fëmijës së fundit në lindje ka qënë 4530gr.

Infermieri Pyetje: 802

Gjatë instruksionit në lidhje me nivelet e dëshiruara të glukozës kur flitet për diabet gestacional, infermierja shpjegon nivelet e glukozës si p.sh. para ushqimit të cilat janë:

- A) 60-90 mg/dl
- B) 90-120 mg/dl
- C) 110-150 mg/dl
- D) 150-180 mg/dl

Infermieri Pyetje: 803

Konsultimi për konceptimin është i rëndësishëm për përfundimin e shtatzanisë tek gruaja me diabet, sepse kontrolli jo i mirë i glicemisë para dhe në periudhën e hershme të barrës shoqërohet me:

- A) Anomali kongjenitale të fetusit
- B) Episode të shpeshta të hipoglicemisë amtare
- C) Hiperemesis gravidarum
- D) Polihidramion

Infermieri Pyetja: 804

Zonja D. është 13 javë shtatzanë. Ajo ankon për dhimbje në fund të barkut dhe hemorragji. Gjatë ekzaminimit vaginal, mjeku konstaton se gruaja ka shkurtim të qafës së mitrës dhe dilatacion të saj. Cili lloj aborti është ky?

- A) Abort i paevitueshëm ose progredient
- B) Abort inkomplet
- C) Mised abort
- D) Rrezik aborti

Infermieri Pyetja: 805

Gruaja është në javën e tetë të shtatzanisë. Gjatë ekzaminimit me ultrasaund mjeku nuk arrin të kapë RZF. Në këtë rast kemi të bëjmë me:

- A) Abort habitual
- B) Abort inkomplet
- C) Abort të paevitueshmëm
- D) Mised abort

Infermieri Pyetja: 806

Një grua 10 javë shtatzanë merr në telefon shërbimin prenatal dhe i referon se ajo ka hemoragji vaginale. Cila duhet të jetë përgjigjia fillestare e infermieres?

- A) Ndoshta ju keni abortuar. Sill me vete të gjitha garzat apo lineset dhe hajde në klinikë tani.
- B) Përshkruaj sasinë e hemoragjisë, karakteristikat dhe kohën e gjakrrjedhjes (sa kohë ka zgjatur hemoragjia)
- C) Të rrijë regjim shtrati dhe nëse hemoragjia vazhdon të lajmërojë menjëherë
- D) Të vijë në klinikë sa më shpejt të jetë e mundur me qëllim që të vizitohet

Infermieri Pyetja: 807

Një grua gravide 8 javëshe paraqet rrezik aborti. Kush është trajtimi i duhur për këtë lloj aborti:

- A) Përgatitja e gruas për t'ju bërë dilatacioni e kyretazhi
- B) Vendosja e gruas rregjim shtrati për disa ditë dhe rivlerësimi i saj
- C) Përgatitja e gruas për ekzaminim ekografik për të parë integritetin e sakusit gestacional
- D) Qetësimi i gruas duke i treguar asaj që edhe n.q.se e humbet këtë fëmijë ajo mund të ngelet përsëri shtatzane pas një muaji.

Infermieri Pyetja: 808

Testet e përdorura për të zbuluar SGA (I vogël për moshën e shtatzanisë) janë :

- A) Palpimi abdominal
- B) Lartësia fundale
- C) Biometria ekografike
- D) Testet biofizike për të diagnostikuar SGA/IUGR

Infermieri Pyetja: 809

Kur vendoset forcepsi dilatacioni duhet të jetë:

- A) 6 - 7 cm
- B) 7 - 8 cm
- C) 10 cm
- D) Mbi 10 cm

Infermieri Pyetja: 810

Barra serotine është shtatzania që zgjat:

- A) 36 - 38 javë
- B) 38 - 40 javë
- C) 40 - 41 javë
- D) Mbi 42 javë

Infermieri Pyetje: 811

Nëse gruaja ka një lindje në javën e 41 të shtatzanisë së saj, çfarë lloj lindje ajo duhet të konsiderohet:

- A) Pretermë
- B) Termë
- C) Postermë
- D) Gestacinale

Infermieri Pyetje: 812

Nëse gruaja ka një lindje në javën e 38 të shtatzanisë së saj, çfarë lloj lindje ajo duhet të konsiderohet:

- A) Pretermë
- B) Termë
- C) Postermë
- D) Gestacinale

Infermieri Pyetje: 813

Nëse gruaja ka një lindje para javës së 36 të shtatzanisë së saj, çfarë lloj lindje ajo duhet të konsiderohet:

- A) Pretermë
- B) Termë
- C) Postermë
- D) Gestacinale

Infermieri Pyetje: 814

Shënja që një grua shtatzane ka aktivitet të parakohshëm lindje mund të jetë:

- A) Dhimbja që shoqëron kontraksionet uterine është e fortë, konstante dhe lokalizohet në pjesën e sipërme të barkut, në fundusin uterin
- B) Kontraksionet uterine zgjasin të paktën 20 minuta
- C) Kontraktimet uterine të cilat ndodhin me një frekuencë prej katër kontraksionesh në 1 orë
- D) Shkurtimi qafës së mitrës deri në 80% edhe dilatacioni 2 cm.

Infermieri Pyetje: 815

Një grua shtatzanë, në javën e 32 të shtatzanisë është përcaktuar të jetë me rrisht për lindje pretermë. Një shenjë, që të ndodhë lindja pretermë do të jetë:

- A) Dhimbja që shoqëron kontraksionet uterine është e fortë dhe konstate
- B) Dilatacioni cervikal është më shumë se 1 cm
- C) Kontraksionet uterine i kemi me një frekuencë, 4 kontraksione në një orë
- D) Përgatitja e qafës mitrës (zbutja) dhe shkurtimi i saj 25%

Infermieri Pyetje: 816

Një grua e hospitalizuar për aktivitet të parakohshëm po merr MgSO₄ i/v. Rezultati i priturb për këtë trajtim do të jetë n.q.s.:

- A) Ataket eklamptike nuk do të ndodhin
- B) Kontraksionet uterine ndalohen
- C) Mushkrittë e të porsalindurit fillojnë prodhojnë surfaktant
- D) Nuk ndodh plasja e parakohshme e membranave

Infermieri Pyetje: 817

Zonja X është 23 javë shtatzanë. Ajo ju telefonon dhe ju thotë se mendon që ka rrjedhje të ujrave nga vagina.ju do ti thoni asaj:

- A) Hajdeni menjëherë në klinikë
- B) Më telefono pas 2 h dhe më trego nëse ka ndryshime të rrjedhjeve
- C) Ne mund të presim deri në vizitën tjetër të radhës
- D) Për sa kohë që bebi lëviz ju mos u shqetësoni

Infermieri Pyetje: 818

Kur gruas i plasin membranat amniotike parakohe mamia duhet të vlersojë T° çdo:

- A) 1 orë
- B) 4 orë
- C) 6 orë
- D) 8 orë

Infermieri Pyetje: 819

Gruaja paraqitet në klinikë dhe ankton për dhimbje (kontraksione). Mami mendon që gruaja i ka filluar aktivitetin e lindjes, kur kontraksionet janë:

- A) 30 minuta dhe zgjasin 90 sekonda
- B) çdo 5 minuta dhe zgjasin 30 sekonda
- C) të çrregullta në intervale të ndryshme kohore
- D) të çrregullta, por të forta

Infermieri Pyetje: 820

Znj X është 36 javë shtatzanë. Ajo referon se ka dhimbje shpine, si dhe dhimbje me forcim të barkut. Infermiera në këtë rast vlerëson kontraksionet uterine për rreth:

- A) 5min
- B) 10 min
- C) 15 min
- D) 30 min

Infermieri Pyetje: 821

Kur infermiere-mamia bënte planifikimin e kujdesit për gruan të cilës i kanë plasur membranat amniotike parakohe, ajo arsyeton që gruaja është e riskuar për:

- A) Hemorragji
- B) Hipotension në pozicion shtrirë me shpinë
- C) Infeksion intrauterin
- D) Lindje precipitoze

Infermieri Pyetje: 822

Menjërherë pas lindjes, gjatë vlersimit që infermiera i bën gruas vë re që fundusi uterin është i squllur dhe ka gjakrrjedhje të madhe. Etiologjia më e mundshme e kësaj gjakrrjedhje është.

- A) Atonia e uterusit
- B) Hematoma vaginale
- C) Inversioni uterin
- D) Laceracioni vaginal

Infermieri Pyetje: 823

Hemoragjitë e vona të post partumit shkaktohen nga:

- A) Atonia uterine
- B) Mbetjet e fragmenteve placentare
- C) Multipariteti i madh
- D) Zgjatje e aktivitetit të lindjes

Infermieri Pyetje: 824

Pas lindjes, gjatë ekzaminimit të zonjës X ju konstatojnë se brenda 15 min linesi i saj arrin të saturohet plotësisht. Veprimi i parë infermier që ju ndërmerrni është:

- A) Kontrolloni shënjat vitale
- B) Lajmëroni mjekun
- C) Palponi fundusin uterin
- D) Rrisni marrjen e likideve i/v

Infermieri Pyetje: 825

Simptomat e mëposhtme janë karakteristike për distakon e placentës së inseruar normalisht përveç:

- A) Dhimbja konstante (abdominale) uterine
- B) Hemorragjia vagjinale me gjak të errët
- C) Uterusi i kontraktuar, i dhimbshëm, hipertonic
- D) Mungesë e hemorragjisë

Infermieri Pyetje: 826

Pas lindjes gruaja ka hemoragji të vazhdueshme në sasi të pakët, fundusi uterin i kontraktuar. Kjo vjen si pasojë e:

- A) Atonisë së uterusit
- B) Laçeracionit të columit
- C) Mbetjeve të fragmenteve placentare
- D) Mbetjeve të membranave amniotike

Infermieri Pyetje: 827

Hemoragjia e hershme e postpartumit (hemoragjia që ndodh brenda 24 orëve të para të pas lindjes) ka më pak gjasa të ndodhë si rezultat i :

- A) Atonin uterine
- B) Formacioneve të hematomeve
- C) Laceracionet e labieve, perineumit, vagjinës ose cerviksit
- D) Subinvolucionin e uterusit

Infermieri Pyetje: 828

Shkaqet më të shpeshta të subinvolucionit janë:

- A) Barra multiple dhe hemorragjia postpartum
- B) Hemorragjia postpartum dhe infeksioni
- C) Kontraksion persistent dhe mbidozim me oxytocinë
- D) Mbetje e fragmenteve placentare dhe infeksioni

Infermieri Pyetja: 829

Një grua shtatzanë për herë të parë lind dy binjakë në javën e 37 të shtatzanisë.

Përshkrimi korrekt i anamnezës obstetrikale të gruas do të jetë:

- A) Multigravida, multipara
- B) Multigravida, primipara
- C) Primigravida, multipara
- D) Primigravida, primipara

Infermieri Pyetja: 830

Amniotomia është:

- A) Marrja e likidit amniotik për vlerësim
- B) Plasja artificiale e membranave
- C) Plasja spontane e membranave
- D) Studimi citologjik i likidit amniotik

Infermieri Pyetja: 831

Në metodat diagnostikuese jo-invazive në obstetrikë NUK bën pjesë:

- A) Ekografia
- B) Stress test
- C) Amniocenteza
- D) Profili biofizik

Infermieri Pyetja: 832

Zonja X ka zgjedhur metodën kalendarike për të kontrolluar kontracepsionin. Gjatë procesit të vleresimit, më e rëndësishme për infermieren është:

A) Ekzaminimi i pigmentacionit të lëkurës dhe cilesise së flokëve për ndryshime hormonale

B) Marrja e anamnezës menstruale për 6- 12 muajt e fundit

C) Njohja e experiencës së mëparshme të gruas për të kontrolluar lindjen

D) Përcaktimi i shtimit dhe humbjes në peshë

Infermieri Pyetja: 833

Zonja X është duke përdoruar temperaturën bazale trupore si metodë kontrceptive. Ajo shkon për kontroll në klinikë dhe i tregon infermieres "periodat e mia janë paksuar dhe temperatura nuk është rritur" përgjigja më e përshtatshme e mamisë duhet të jetë:

A) Ju keni qënë e sëmure këte muaj

B) Ju ndoshta nuk patët ovulacion këtë muaj

C) Kjo ndoshta nënkupton që ju jeni shtatzanë

D) Mos u mërzitni ndoshta kjo nuk është asgjë

Infermieri Pyetja: 834

Sifilia shkaktohet nga :

A) Clamidia trakomatis

B) Herpesi simpleks

C) Neiseria gonorrhoea

D) Treponema pallidum

Infermieri Pyetja: 835

Substancat spermicide veprojnë me anë të:

A) Barrierave mekanike

B) Duke frenuar ovulacionin

C) Duke shtuar rritjen e epitelit vaginal.

D) Shkatërrimit të spermës

Infermieri Pyetja: 836

Cili tip i pilulave kontraceptive konsiderohet i përshtatshëm për gjashtë javët e para pas lindjes kur është në ushqyerje me gji?

- A) pilulat kontraceptive të kombinuara
- B) pilulat kontraceptive trifazike
- C) pilulat me dozë të lartë estrogeni
- D) pilula vetëm me progesterone

Infermieri Pyetja: 837

Çrregullimet e shikimit dhe ato cerebrale janë karakteristike për:

- A) Diabetin e shtatzanisë
- B) Aneminë e shtatzanisë
- C) Preeklampsinë e rëndë
- D) Asnjë nga këto

Infermieri Pyetja: 838

Kondomët duhet të përdoren gjatë shtatzanisë:

- A) Asnjëherë
- B) Nga gratë me rrezik për kandida
- C) Nga gratë me rrezik të lartë për SST
- D) Nga të gjitha gratë shtatzana

Infermieri Pyetja: 839

Një grua e re vjen në klinikë dhe ju shpjegon që një natë më parë gjatë marëdhënies seksuale kondomi u çua. Në konsultë me këtë kliente ju e këshilloni atë që kontracepsioni post koital (kontracepsioni i urgjencës) ul rrezikun e një shtatzanie dhe është shumë efektiv kur:

- A) Ajo merret në çdo kohë përpara ciklit
- B) Doza e parë merret sa më shpejt që të jetë e mundur
- C) Doza e parë mund të merret pas 72 orëve
- D) Mund të merret dhe pas tre ditësh

Infermieri Pyetja: 840

Zonja X është beqare dhe përshkruan jetën e saj seksuale, si aktive dhe me shumë partnerë. Ajo dëshiron një metodë kontraceptive, e cila është e sigurtë dhe që nuk ndikon në aktivitetin e saj seksual. Ajo kërkon D.I.U.. Përgjigja me e përshtatëshme e ma

- A) D.I.U. do t'ju mbrojë ju nga SST
- B) D.I.U. nuk ndikon në aktivitetin seksual
- C) Përqindja e barrave është më e lartë me D.I.U.
- D) Rreziku i SIP është më i madh për ju

Infermieri Pyetja: 841

Zoti dhe Zonja X po kalojnë momente të vështira për pamundësinë e tyre për të krijuar shtatzanësi. Ata duan të dinë se çfarë mund të bëjnë për të ruajtur ekuilibrin e tyre emocional. Përgjigja më e përshtatëshme nga ana e mamisë është :

- A) T'i tregojnë gjithë shokëve të tyre dhe familjeve
- B) Të bisedojnë me homologët e tyre infertil
- C) Të kërkojnë mbështetje nga grupet e specializuara për këtë problem
- D) Të fillojnë procedurat e menjëherëshme për adoptim

Infermieri Pyetja: 842

Një grua është duke përdorur diafragmën në mënyrë jo korrekte nëse ajo:

- A) Aplikon spermicid brenda kupës dhe rreth buzëve të diafragmës
- B) E lan atë me sapun të butë dhe ujë pas përdorimit dhe më pas e pudros atë me niseshte
- C) Lëviz atë brenda 2 orëve pas aktit të fundit të koitusit
- D) Vendos diafragmën 6 orë para marrëdhënies

Infermieri Pyetje: 843

Zonja X. sapo ka patur abort në tremestrin e I-rë dhe është dërguar në shtëpi duke i dhënë kontraktivë orale për tu mbrojtur nga një barrë, ajo është këshilluar të :

- A) Të fillojë kontraktivët orale që ditën e kryerjes së abortit
- B) Të mënjanojë kontaktin seksual deri sa të pushojë hemorragjia
- C) Paraqitet me të vjella me gjak
- D) Trajtohet me FPP

Infermieri Pyetje: 1322

Cirroza është:

- A) Sëmundje kronike degjenerative e mëlçisë
- B) Tumor i gojës
- C) Tumor i stomakut
- D) Prania e gurëve në fshikëzën e tëmthit

Infermieri Pyetje: 1323

Një pacient diagnostikuar me hbs Ag (+), propabikish ka:

- A) Një Hepatit B
- B) Koledokolitiazë
- C) Cirrozë biliare primare
- D) Kolangit sklerotizant primar

Infermieri Pyetje: 1324

Cili ekzaminim gjaku do të ishte më i dobishëm për të konfirmuar diagnozën e Cirrozës biliare primare?

- A) Antitrupa Antigliadinë
- B) Antitrupa Antimitokondrial (AMA)
- C) Antitrupa Antinuclear
- D) Niveli i amilazës në gjak

Infermieri Pyetje: 1325

Për cilin nga viruset e hepatitit ekziston vakcina?

- A) Për virusin A
- B) Për virusin B
- C) Për virusin C
- D) Për virusin D

Infermieri Pyetja: 1326

Faktori më i rëndësishëm për progresionin e nefropatisë është:

- A) Proteinuria
- B) Leukocituria
- C) Hematuria
- D) Asnjëra

Infermieri Pyetja: 1327

Ndër shkaqet e Insuficencës Renale Kronike mund të jetë:

- A) Diabeti Mellitus
- B) Hipertensioni Sistemik
- C) Pielonefriti kronik
- D) Të gjitha

Infermieri Pyetja: 1328

Në Insuficencën Renale Kronike të avancuar mund të vihen re këto lezime kutane:

- A) Pruritis
- B) Kalçifikime kutane dhe subkutane
- C) Dermatopati të fistulës arteriovenoze
- D) Të gjitha

Infermieri Pyetja: 1329

Faktorë predispozues për Insuficencën Renale Akute mund të jetë:

- A) Moshë e avancuar
- B) Përdorimi i anti-inflamatorëve-josteroidal
- C) Përdorimi i anti-hipertensivëve ACE inhibitorë.
- D) Të gjitha

Infermieri Pyetje: 1330

Indikacion absolut për fillimin e dializës është:

- A) Edema pulmonare
- B) Hiperkaliemia
- C) Perikarditi uremik
- D) Të gjitha

Infermieri Pyetje: 1331

Hemisferat cerebrale janë:

- A) Identike me njëra-tjetrën;
- B) Thuajse identike me njëra-tjetrën
- C) Plotësisht të ndryshme nga njëra-tjetra
- D) Të pakrahasueshme

Infermieri Pyetje: 1332

Hemisferat dallojnë nga njëra-tjetra nga:

- A) Përmasat e lobit frontal;
- B) Përmasat e lobit temporal;
- C) Lokalizimi i zonës së të folurës;
- D) Përmasat e lobit oksipital

Infermieri Pyetje: 1333

Ndarja e hemisferave për arsye didaktike bëhet në:

- A) 2 lobe;
- B) 3 lobe;
- C) 4 lobe;
- D) 5 lobe.

Infermieri Pyetje: 1334

Korteksi cerebral përbëhet kryesisht nga:

- A) trupa qelizash nervore;
- B) zgjatimet e qelizave nervore;
- C) qeliza mbështetëse (jo neurone);
- D) trupa qelizore dhe zgjatime të qelizave nervore në sasi thuajse të barabarta.

Infermieri Pyetje: 1335

Afazia është crregullim i:

- A) vëmendjes
- B) të folurit
- C) nuhatjes
- D) shikimit

Infermieri Pyetje: 1336

Çrregullime të kujtesës janë:

- A) Afazi
- B) Agrafi
- C) Amnezi
- D) Disfagi

Infermieri Pyetje: 1337

Anosmia është shenjë e dëmtimit të nervave:

- A) olfaktorë
- B) facial
- C) glosofaringealë
- D) trigeminalë

Infermieri Pyetje: 1338

Hemianopsia është:

- A) Deficit motor
- B) Çrregullim sensitiv
- C) Deficit i fushës vizive
- D) Çrregullim i ekuilibrit

Infermieri Pyetje: 1339

Ptoza palpebrale haset në dëmtimet e nervit:

- A) olfaktor
- B) okulomotor
- C) trigeminal
- D) hypogloss

Infermieri Pyetje: 1340

Shenja e "Bell", haset në:

- A) Neuraljinë trigeminale
- B) Paralizën faciale centrale
- C) Paralizën faciale periferike
- D) Neuraljinë glosso-faringeale.

Infermieri Pyetje: 1341

Në dëmtimet e nervit glosso-faringeal kemi humbjen e shijes në:

- A) 1/3 e përparme të gjuhës;
- B) 1/3 e mesme të gjuhës;
- C) 1/3 e pasme të gjuhës;
- D) Gjithë gjuhën.

Infermieri Pyetje: 1342

Nervi hypogloss është:

- A) sensitiv;
- B) motor;
- C) miks (sensitivo-motor);
- D) me funksion parasimpatik.

Infermieri Pyetje: 1343

Në sindromat miastenike dëmtimi primar është në:

- A) Nervat periferikë;
- B) Fibrat muskulare;
- C) Pllakën neuro-muskulare;
- D) Sistemin nervor qendror.

Infermieri Pyetje: 1344

Në miopatië, dëmtimi primar është në:

- A) mekanizmin e kontraksionit muskular;
- B) funksionin muskul-nerv;
- C) nervat periferikë;
- D) harqet reflektore.

Infermieri Pyetje: 1345

Rezervat neuronale me glukozë janë të mjaftueshme për:

- A) 0.5 - 1 min;
- B) 1 - 1.5 min;
- C) 1.5 - 2 min;
- D) 2 - 3 min.

Infermieri Pyetje: 1346

Furnizimi arterial i trurit sigurohet nga 2 arteriet:

- A) cerebri anterior;
- B) cerebri media;
- C) comunicante anterior dhe 2 arteriet comunicante posteriore;
- D) karotis dhe 2 arteriet vertebrale.

Infermieri Pyetje: 1347

Patologjitë cerebrovaskulare karakterizohen nga deficite:

- A) subakute neurologjike, nga çrregullim metabolik;
- B) akute neurologjike, nga çrregullim i sistemit cerebro-vaskular;
- C) neurologjik me baze gjenetike;
- D) neurologjik nga intoksikacionet.

Infermieri Pyetje: 1348

Skleroza multiple është patologji:

- A) Dismielinizante hereditare;
- B) Dismielinizante e fituar;
- C) Demielinizante;
- D) Metabolike.

Infermieri Pyetje: 1349

M. Alzheimer është sëmundje:

- A) Demielinizante;
- B) Degjenerative progressive;
- C) Traummatike;
- D) Metabolike.

Infermieri Pyetje: 1350

Në morbus Alzheimer ndodh humbje progressive neuronale në korteksin e lobeve:

- A) parietale e temporale;
- B) oksipitale e frontale;
- C) frontale e parietale;
- D) oksipitale e parietale.

Infermieri Pyetje: 1351

Skleroza laterale amiotrofike (SLA), karakterizohet nga humbje:

- A) progresive neuronale në korteksin frontal;
- B) neuronale në traktin pyramidal;
- C) neuronale në fashikujt posterior;
- D) neuronale në cornu anterior të medullës spinale.

Infermieri Pyetje: 1352

Atrofitë spinocerebellare janë patologji:

- A) demielinizante;
- B) metabolike;
- C) hereditare;
- D) vaskulare.

Infermieri Pyetje: 1353

Patologjitë metabolike të trashëguara të sistemit nervor shkaktohen nga defekte të:

- A) genit që kodon për një enzimë apo protein të rëndësishme;
- B) kontraksionit muskular;
- C) funksionit të harkut reflektor;
- D) funksionit të pllakës neuro-muskulare.

Infermieri Pyetje: 1354

Morbus Willson është pasojë e anomalisë së një proteine transportuese të:

- A) hekurit në organizëm;
- B) klorit në organizëm;
- C) azotit në organizëm;
- D) bakrit në organizëm.

Infermieri Pyetje: 1355

MMSE, është test i cili përdoret për të vlerësuar:

- A) forcën muskulare;
- B) funksionet e larta konjitive;
- C) sensibilitetin;
- D) ekuilibrin.

Infermieri Pyetje: 1356

Dëmtimet e motoneuroneve inferior shkaktojnë:

- A) Reflekse të pandryshuara;
- B) Hipërrefleksi;
- C) Hyporefleksi;
- D) Arefleksi.

Infermieri Pyetje: 1357

Dëmtimet e motoneuroneve superiore shkaktojnë:

- A) Reflekse të pandryshuara;
- B) Hipërrefleksi;
- C) Hyporefleksi;
- D) Arefleksi.

Infermieri Pyetje: 1358

Zona motore primare ndodhet në korteksin:

- A) motor;
- B) parietal;
- C) oksipital;
- D) temporal

Infermieri Pyetje: 1359

Dhimbje neuropatike është dhimbje që shkaktohet nga lezime:

- A) të korteksit cerebral;
- B) të radikseve nervore;
- C) muskulare;
- D) të fibrave nervore.

Infermieri Pyetje: 1360

Për të ekzaminuar sensibilitetin termik përdoren:

- A) Një epruvetë qelqi me ujë të ngrohtë;
- B) Një epruvetë qelqi me ujë të ftohtë;
- C) Dy epruveta qelqi, njëra me ujë të ngrohtë dhe tjetra me ujë të ftohtë;
- D) Një age sterile.

Infermieri Pyetja: 1361

Zona sensore primare ndodhet në korteksin:

- A) frontal;
- B) parietal;
- C) oksipital;
- D) temporal.

Infermieri Pyetja: 1362

Në sindromën hipotalamike (dëmtime të hipotalamusit), kemi:

- A) Hypoestezi dhe disestezi;
- B) Hipërestezi;
- C) Hypoestezi;
- D) Anestezi.

Infermieri Pyetja: 1363

Halucinacionet olfaktore kanë të bëjnë me:

- A) Mungesën e nuhatjes;
- B) Ekzagjerimin e nuhatjes;
- C) Mungesën e shijes;
- D) Përceptimin e aromave inekzistente.

Infermieri Pyetja: 1364

Ataksia statike është paaftësia për të:

- A) ruajtur ekuilibrin në pozicionin në këmbë;
- B) ruajtur ekuilibrin në ecje me sytë hapur;
- C) ruajtur ekuilibrin në ecje me sytë mbyllur;
- D) kryer provën index-nasi.

Infermieri Pyetje: 1365

Dismetria është paaftësia për:

- A) ruajtjen e ekuilibrit në ecje;
- B) arritjen në mënyrë korrekte një shenjë;
- C) kapjen e një objekti;
- D) ecjen me sytë mbyllur.

Infermieri Pyetje: 1366

Agnozia është çrregullim i:

- A) kuptimit të të folurës;
- B) orientimit në kohë dhe hapësirë;
- C) njohjes së objekteve në prani të sistemeve sensoriale intakte;
- D) sensibilitetit taktil.

Infermieri Pyetje: 1367

Elektroneurografia përcakton:

- A) Aktivitetin elektrik kortikal;
- B) Vijueshmërinë funksionale të harqeve reflektore;
- C) Funksionin e fibrave muskulare;
- D) Shpejtësinë e konduksionit nervor motor apo sensitiv;

Infermieri Pyetje: 1368

Epilepsia reflektore përbëhet nga atake epileptike që:

- A) Shpërthejnë pas një stimuli të caktuar;
- B) Janë të palidhura me stimuj të ndryshëm;
- C) Hasen më tepër në të rriturit;
- D) Janë me bazë gjenetike.

Infermieri Pyetje: 1369

EEG bën regjistrimin e :

- A) Funksionit të harqeve reflektore;
- B) Aktivitetit elektrik kortikal;
- C) Funksionit të fibrave muskulare;
- D) Funksionit të fibrave nervore.

Infermieri Pyetje: 1370

Aura e migrenës është:

- A) Faza e dhimbjes maksimale të kokës;
- B) Përuidha pas qetësimit të kësaj dhimbjeje;
- C) Simptomatologjia specifike që shfaqet para dhimbjes;
- D) Nuk ka lidhje me dhimbjen e kokës.

Infermieri Pyetje: 1371

Progesteroni prodhohet nga:

- A) Trupi i verdhe
- B) Uterusi
- C) Hypofiza
- D) Ovaret

Infermieri Pyetje: 1372

Parandalimi paresor ul:

- A) Prevalencën e një sëmundjeje
- B) Incidencën e një sëmundjeje
- C) Prevalencën e një handikapi
- D) Incidencën e një handikapi

Infermieri Pyetje: 1373

Për të evituar një shtatzani abstinohet nga dita:

- A) 8 deri në ditën e 14
- B) 6 deri në ditën e 14
- C) 8 deri në ditën e 18
- D) 6 deri në ditën e 12

Infermieri Pyetje: 1374

Pilula kontraceptive e urgjencës merret në:

- A) Mes të ciklit
- B) Fillim të ciklit
- C) Fund të ciklit
- D) Nuk ka rëndësi në çfarë momenti të ciklit

Infermieri Pyetje: 1375

Hormoni luteinizues prodhohet:

- A) Në hipofizë
- B) Në ovarë
- C) Në testikuj
- D) Në uterus

Infermieri Pyetje: 1376

Testosteroni është:

- A) Qeliza seksuale mashkullore
- B) Hormoni seksual femëror
- C) Hormoni seksual mashkullor
- D) Qeliza seksuale femërore

Infermieri Pyetje: 1377

Hormoni folikulo stimulus prodhohet nga:

- A) Hypofiza dhe hipotalamusi
- B) Ovarët
- C) Uterusi
- D) Testikujt

Infermieri Pyetje: 1378

Deproverat bëjnë pjesë në metodat:

- A) Orale
- B) Kirurgjikale
- C) Subdermale
- D) Injektable

Infermieri Pyetje: 1379

E vetmja metode kontraceptive që mbrojnë nga HIV/AIDS është:

- A) Metoda kirurgjikale
- B) Spërmicidet
- C) Kondomi
- D) Metodët hormonale

Infermieri Pyetje: 1380

Cilat metoda kontraceptive mund të mbrojnë nga IST?

- A) Metoda e ditëve kalendarike
- B) Metodët barriere
- C) Injektablet
- D) Metodët orale

Infermieri Pyetja: 1381

Vetinspektimi e vetekzaminimi behet ne:

- A) Kancerin e qafës se mitres
- B) Menopauze
- C) Ne rastin e një IST je
- D) Kancerin e gjirit

Infermieri Pyetja: 1382

PAP testi behet për te diagnostikuar:

- A) Kancerin e qafës se mitres
- B) Kancerin e gjirit
- C) HIV/AIDS
- D) Kancerin e ovarit

Infermieri Pyetja: 1383

Norplanti dhe implanon bejne pjese te metodat:

- A) injëktable
- B) orale
- C) barriere
- D) subdermale

Infermieri Pyetja: 1384

Kur kemi largim të kondileve femorale kontrolaterale nga njëri-tjetri dhe afrim të maleolave kontrolaterale me njëra-tjetrën, kemi të bëjmë me:

- A) Genus rekurvatum
- B) Genus varum
- C) Genus valgum
- D) Genus pronatum

Infermieri Pyetje: 1385

Në shenjat klinike të osteogenezës imperfekte vërejmë:

- A) Deformim të shtyllës kurrizore
- B) Ekzoftalmi
- C) Sklera blu
- D) Ptozë palpebrale

Infermieri Pyetje: 1386

Osteoporoza ka si karakteristikë:

- A) Mineralizim të pamjaftueshëm të kockës
- B) Pakësim i masës kockore
- C) Të dyja sa më sipër
- D) Asnjë prej tyre

Infermieri Pyetje: 1387

Në pes ekuinovarus kemi:

- A) Shkurtim të strukturave laterale
- B) Shkurtim të strukturave mediale
- C) Shkurtim të strukturave dorsale
- D) Nuk kemi shkurtim të asnjë strukture

Infermieri Pyetje: 1388

Në hallux valgus patologjia qëndron në:

- A) Artikulacionin metacarpo-falangeal
- B) Artikulacionin interfalangeal
- C) Artikulacionin talo-krural
- D) Artikulacionin metatarso-falangeal

Infermieri Pyetje: 1389

Kur kemi rrotullim të vertebrave në aksin e tyre dhe transmetim të këtij rrotullimi tek brinjët duke formuar gibus kifo-skoliotik kemi të bëjmë me:

- A) Skoliozë strukturale
- B) Skoliozë funksionale
- C) Kifoze
- D) Spondilolistezë

Infermieri Pyetje: 1390

Në luksacionin congenital koksofemoral kur fëmija fillon të ecë duke çaluar, kjo ndodh si pasojë:

- A) E shkurtesës së njërit femur
- B) E shkurtesës së të dy femureve
- C) E insuficencës së muskujve gluteale
- D) Asnjë prej sa më sipër

Infermieri Pyetje: 1391

Mielomeningocela shfaqet në kë nga këto diagnoza:

- A) Sakralizim të vertebrës së fundit lumbare
- B) Luksacion congenital kokso-femoral
- C) Skoliozë funksionale
- D) Spina bifida

Infermieri Pyetje: 1392

Në pes planus patologjia qëndron në:

- A) Pozicionimin e metatarsëve
- B) Harkun longitudinal dhe atë transversal
- C) Pozicionimin e kockës kuboide
- D) Tendinin e akilit

Infermieri Pyetja: 1393

Trajtimi i luksacionit kokso-femoral kongenital në moshën 3 muaj konsiston:

- A) Në vendosjen e jastëkut abduktor (Pavlik)
- B) Në imobilizimin me gips
- C) Në rikonstrukcion të acetabulit kirurgjikalisht
- D) Në reponim të hapur kirurgjikal

Infermieri Pyetja: 1394

Mjekimi i pes equinovarus tek të porsalindurit konsiston në:

- A) Ndërhyrje kirurgjikale
- B) Artrodezë
- C) E lëmë të autokorrigjohet deri në moshën 8 vjeç
- D) Redresime me gips

Infermieri Pyetja: 1395

Në coxa vara këndi cerviko-diafizar është:

- A) Më i ngushtë (vogël) se norma
- B) Më i gjerë (madh) se norma
- C) 180 gradë
- D) Këndi cerviko-diafizar nuk ndikohet nga coxa vara

Infermieri Pyetja: 1396

Fraktura e diafizës tibiale trajtohet:

- A) Duke imobilizuar gjithë anësinë superiore
- B) Duke imobilizuar vetëm bërrylin
- C) Duke imobilizuar artikulacionin Gleno-humeral
- D) Asnjë prej tyre

Infermieri Pyetja: 1397

Në frakturat e thjeshta të klavikulës pa komplikacione duhet kryer:

- A) Reponim dhe imobilizim në gips
- B) Reponim kirurgjikal dhe fiksime me vida
- C) Reponim e fiksime me bandazh në formë tete
- D) Reponim dhe fillim i lëvizjeve të lehta

Infermieri Pyetja: 1398

Në frakturën e diafizës humerale mund të kemi dëmtim të:

- A) arteries radiale
- B) arteries ulnare
- C) nervit radial
- D) nervit ulnar

Infermieri Pyetja: 1399

Luksacioni gleno-humeral reponohet sipas:

- A) metodës së Hipokratit
- B) metodës Kocher
- C) metodës së Hipokratit metodës Kocher
- D) kirurgjikalisht

Infermieri Pyetja: 1400

Nëse kemi frakturë ekstensore suprakondilare të humerusit, pas reponimit imobilizimi duhet të kryhet në:

- A) Fleksion
- B) Abduksion
- C) Ekstension
- D) Pronacion

Infermieri Pyetja: 1401

Fraktura e kondileve femorale ndodh:

- A) Në pjesën distal të femurit
- B) Në pjesën diafizare të femurit
- C) Në pjesën proksimale të femurit
- D) Në pjesën proksimale të humerit

Infermieri Pyetja: 1402

Luksacioni gleno-humeral mund të jetë të gjitha më poshtë përveç:

- A) Subklavikular
- B) Erehta
- C) Subakromial
- D) Submandibular

Infermieri Pyetja: 1403

Frakturë oblike është fraktura që e ndan kockën:

- A) Në 2 pjesë nëpërmjet një linje horizontale
- B) Në 2 pjesë nëpërmjet një linje të pjerrët
- C) Në 2 pjesë nëpërmjet një linje ovale
- D) Në 3 ose më shumë pjesë

Infermieri Pyetja: 1404

Fraktura e ulnës dhe luksacioni i radiusit emërtohet:

- A) Locos tipica ose Colles
- B) Galeazzi
- C) Monteggia
- D) Jones

Infermieri Pyetja: 1405

Në konsolidimin kockor faza e dytë është:

- A) e kallusit primar
- B) e inflamacionit
- C) pseudoartroza
- D) asnjë prej tyre

Infermieri Pyetja: 1406

Një frakturë mund të jetë:

- A) komocionale
- B) kompartmentale
- C) spirale
- D) të gjitha sa më lart

Infermieri Pyetja: 1407

Implantet janë metoda kontracepsin hormonale

- A) Hormonale
- B) Jo hormonale
- C) Kimikate
- D) Asnjë nga keto

Infermieri Pyetja: 1408

Pilulat progestative kunderindikohen në;

- A) Gjashtë mujorin e parë të ushqyerjes me gji
- B) Gjashtë javët e para të ushqyerjes me gji
- C) Tre muajt e parë të ushqyerjes me gji.
- D) Asnjë nga keto

Infermieri Pyetja: 1409

DIU vendoset kur femra eshte:

- A) Shtatzane
- B) Ka nje infeksion puerperal
- C) Ka nje semundje inflamatore pelvike.
- D) Asnje nga opsionet

Infermieri Pyetja: 1410

Hormoni folikulo stimulus

- A) Provokon ovulacionin
- B) Mban trupin e verdhe
- C) Nxit rritjen dhe zhvillimin e folikulit ovarian
- D) Asnje nga opsionet

Infermieri Pyetja: 1411

Estradioli prodhohet nga:

- A) Hypofiza
- B) Ovaret
- C) Uterusi
- D) Asnje nga opsionet

Infermieri Pyetja: 1412

Kush e percakton tipin e pilulave te kombinuara:

- A) Doza e etinil estradiolit
- B) Doza e progesteronit
- C) Doza e te dyve
- D) Asnje nga keta

Infermieri Pyetja: 1413

Kontraceptivet oral jane metoda:

- A) Hormonale
- B) Jo hormonele
- C) Kimikate
- D) Asnje nga opsionet

Infermieri Pyetja: 1414

Menopauza natyrale eshte si rezultat i:

- A) Ndalimit te aktivitetit folikular ovarian
- B) Ablacionit kirurgjikal te ovareve
- C) Frenimit jatrogjen te funksionit te ovareve
- D) Te treja se bashku

Infermieri Pyetja: 1415

Nje mesazh duhet te jete:

- A) I gjate
- B) I shkurter
- C) Te mos perseritet
- D) Asnje nga opsionet

Infermieri Pyetja: 1416

Cfare eshte ovulacioni:

- A) Pjekja e vezes
- B) Dalja e vezes nga folikuli
- C) Pjekja dhe dalja e vezes nga folikuli
- D) Asnje nga opsionet

Infermieri Pyetja: 1417

Ne ciklin menstrual, duke nisur nga dita e pare e ciklit, dallohen tre faza. Tregoni cila nga alternativat e meposhtme i paraqet ne renditjen e rregullt:

- A) Luteale, ovalatore, folikulare
- B) Ovulatore, luteale, folikulare
- C) Folikulare, ovulatore, luteale
- D) Folikulare, luteale, ovulatore

Infermieri Pyetja: 1418

Sa shtresa dallohen ne strukturen e uterusit?

- A) Tre: mukoze, muskulare e seroze
- B) Dy: seroze dhe muskulare
- C) Dy: mukoza dhe muskulare
- D) Tre: dy mukoze dhe një muskulare

Infermieri Pyetja: 1419

Cili nga këto hormone nuk prodhohet nga placenta gjatë barrës?

- A) Gonadotropina korionike humane (hCG)
- B) Hormoni laktogjen placentar
- C) Prolaktina
- D) Progesteroni

Infermieri Pyetja: 1420

Cila është frekuenca e rrahjeve të zemres fetale RZF:

- A) 70-80/min
- B) 90-110/min
- C) 120-160/min
- D) > 160/min

Infermieri Pyetje: 1421

Cila nga këto mundësi nuk është e pranishme në javën e 12-të të shtatzanisë ?

- A) Amenorea
- B) Hormoni bhCG në gjak
- C) Rrahjet e zemrës fetale në ekografi
- D) Lëvizjet fetale të ndjera nga nena

Infermieri Pyetje: 1422

Difektet e tubit neural të fetusit mund t'i atribuohen mungesës së:

- A) hekurit
- B) folateve
- C) vitaminës A
- D) estrogenëve

Infermieri Pyetje: 1423

Kordoni umbilikal përmban:

- A) Dy vena dhe një arterie
- B) Dy arterie dhe dy vena
- C) Dy arterie dhe një venë
- D) Një arterie dhe një venë

Infermieri Pyetje: 1424

Volumi i gjakut në barrë rritet me

- A) 10-20 %
- B) 30-40 %
- C) 50-60 %
- D) 70-80 %

Infermieri Pyetje: 1425

Diametri më i madh i kokës fetale është:

- A) Subokspital
- B) Oksipito-mental
- C) Biparietal
- D) Oksipito-frontal

Infermieri Pyetje: 1426

Ekspulsioni i anekseve fetale (placentes dhe membranave) pas lindjes normalisht ndodh brenda:

- A) 2-3 minutave
- B) 10 minutave
- C) 15-30 minutave
- D) 60-90 minutave

Infermieri Pyetje: 1427

Puerperium quhet:

- A) Përiudha menjëherë pas lindjes deri në 4-6 javë pas lindjes
- B) Përiudha para fillimit të aktivitetit të lindjes
- C) Përiudha e aktivitetit të lindjes
- D) Asnjëra nga këto

Infermieri Pyetje: 1428

Cila nga substancat e mëposhtme clirohet ose është përgjegjëse për prodhimin e qumështit të gjirit (laktogjenezen) ?

- A) Estrogjeni
- B) Progesteroni
- C) Oksitocina
- D) Prolaktina

Infermieri Pyetja: 1429

Cila nga substancat e mëposhtme clirohet ose është përgjegjëse për rrjedhjen (daljen) e qumështit të gjirit ?

- A) Estrogjeni
- B) Progesteroni
- C) Oksitocina
- D) Prolaktina

Infermieri Pyetja: 1430

Cila nga substancat e mëposhtme është përgjegjëse për involucionin uterin?

- A) Estrogjeni
- B) Progesteroni
- C) Oksitocina
- D) Prolaktina

Infermieri Pyetja: 1431

Cila nga pohimet e mëposhtme është e saktë për kontracepsionin pas lindjes ?

- A) Duhet filluar menjëherë tek gruaja që nuk ushqen bebin me gji
- B) Nuk është i rëndësishëm tek gruaja që ushqen bebin me gji
- C) Nuk është i rëndësishëm deri në shfaqjen e menstruacioneve të para
- D) Nuk është i nevojshëm për një muaj pas Sectio Cezarea

Infermieri Pyetja: 1432

Cila nga këto paraqitje i referohet paraqitjes me koke të fetusit?

- A) Podalike
- B) Cefalike
- C) Oblike
- D) Transversus

Infermieri Pyetje: 1433

Cila nga indikacionet dietetike të mëposhtme NUK është e duhura për gruan shtatzënë?

- A) Ulja e përdorimit të kripës
- B) Shtesa e hekurit
- C) Shtimi i acidit folik
- D) Shtimi i të paktën 6 kg peshë në barrë

Infermieri Pyetje: 1434

Cili nga ekzaminimet e mëposhtme nuk është test i zakonshëm gjatë një barre pa komplikime ?

- A) Dozimi në serum i bhCG
- B) Hemoglobina
- C) Pap testi
- D) Grupi i gjakut dhe faktori Rh

Infermieri Pyetje: 1435

Cili nga kushtet e mëposhtme NUK lidhet me një shtim të riskut të sëmundshmërisë perinatale ?

- A) Kushtet e dobëta socioekonomike
- B) Moshë e nënës nën 20 vj
- C) Duhanpirja
- D) Ushtrimet fizike

Infermieri Pyetje: 1436

Barra me moshe më shumë se 42 javë quhet:

- A) preterm
- B) premature
- C) ne term
- D) serotine

Infermieri Pyetje: 1437

Sindroma e postmaturit (serotinit) përfshin gjithë mundësitë e mëposhtme, përveç:

- A) Rritja e trashësisë së indit adipoz subkutan
- B) Lekura e rrudhosur, që deskuamohet
- C) Gjurme mekoniumi mbi lekure, membrane e kordon
- D) Thonj të gjatë

Infermieri Pyetje: 1438

I porsalinduri nga nëna diabetike NUK rrezikohet nga:

- A) Hipoglicemia
- B) Hipërglicemia
- C) Hipocalcemia
- D) Makrosomia

Infermieri Pyetje: 1439

Cili është mbartesi natyral i Toksoplazmozës?

- A) Gjaku
- B) Macja
- C) Peshku i kontaminuar
- D) Femijet në moshe shkollore

Infermieri Pyetje: 1440

Prematur përkufizohet një neonat i lindur para javës:

- A) 24 të barrës
- B) 34 të barrës
- C) 36 të barrës
- D) 40 të barrës

Infermieri Pyetja: 1441

Ne metodat diagnostikuese joinvazive ne obstetrike NUK ben pjese:

- A) Ekografia
- B) Stress test
- C) Amniocenteza
- D) Profili biofizik

Infermieri Pyetja: 1442

Abort habitual quhet prania e njepasnjeshme e :

- A) Dy aborteve spontane
- B) Tre aborteve spontane
- C) Kater aborteve sponatene
- D) Me shume se 5 aborte spontane

Infermieri Pyetja: 1443

Placenta previa eshte vendosja e placentes ne:

- A) 1/3 e poshtme te kavitetit uterin
- B) 1/3 sipërme te kavitetit uterin
- C) Fundus uteri
- D) Murin e përpareshem uterin

Infermieri Pyetja: 1444

Cili nga organet apo lokalitetet anatomike nuk ben pjese ne organet e jashtme genitale?

- A) Vulva
- B) Vagina
- C) Mons pubis
- D) Përineumi

Infermieri Pyetje: 1445

Zgjatja mesatare e ciklit menstrual është:

- A) 22 ditë
- B) 25 ditë
- C) 28 ditë
- D) 35 ditë

Infermieri Pyetje: 1446

Ardhja e ciklit menstrual shkaktohet nga:

- A) Çlirimi i prolaktinës
- B) Çlirimi pulsatil i GnRH (hormoni lirues i gonadotropinave)
- C) Zgjatja e ndryshueshme e fazës folikulare
- D) Nga sinteza e progesteronit në corpus luteum

Infermieri Pyetje: 1447

Indikatori më i mirë që pararend ovulacionin është:

- A) Piku i estrogjenit
- B) Shtimi i sekretimit të FSH
- C) Fillimi i stimi të sekretimit të LH
- D) Shtimi preovulator i progesteronit

Infermieri Pyetje: 1448

Cila nga karakteristikat e mëposhteme NUK është tipike për fazën folikulare të ciklit ?

- A) Kohezgjatja e ndryshueshme
- B) Rritja dhe zhvillimi i folikujve ovariene
- C) Tempëratura bazale mbi 36,5
- D) Rritja vaskulare e endometrit

Infermieri Pyetja: 1449

Cila nga shënjat e më poshtme NUK takohet në rastin e barrës ektopike (GEU) ?

- A) Dhimbje në kuadrantet e poshtme të barkut
- B) Gjakrrjedhje vaginale ose spotting
- C) Amenorrea
- D) Proctoragjia (hemoragji rektale)

Infermieri Pyetja: 1450

Trajtimi i GEU (barrës ektopike) mund te behet me:

- A) Laparaskopi
- B) Laparatomy
- C) Methotroxate
- D) Të gjitha

Infermieri Pyetja: 1451

Cilat nga patologjitë e mëposhteme NUK është pasojë e sëmundjes inflamatore pelvike ?

- A) Endometrioza
- B) Barra ektopike
- C) Aderencat pelvike
- D) Dispareunia

Infermieri Pyetja: 1452

Cila nga situatat e mëposhtme NUK shoqerohet me risk te shtuar për SIP?

- A) Fillimi i kontakteve seksuale 15 vj
- B) Nderprerje te vullnetshme te barrës
- C) Marrja e kontrceptiveve orale
- D) Përdorimi i DIU

Infermieri Pyetja: 1453

Diagnoza e endometrioze vendoset në baze të:

- A) Anamnezës
- B) Ekzaminimit objektiv
- C) Dozimi i CA 125
- D) Shikimi direkt i lezionit endometrioik dhe biopsia

Infermieri Pyetja: 1454

Terapia më e përshtatshme për një grua 35 vjece që i është nënshtruar interventit kirurgjikal radikal (hysterectomia totale cum adnesis) është:

- A) Danazoli
- B) Kontraktivet orale
- C) Antiinflamatorët jo steroidienë
- D) Terapia estrogenike zëvendësuese

Infermieri Pyetja: 1455

Cila nga pohimet e mëposhtmet NUK shërben si teori për endometriozen?

- A) Metaplazia e epitelit celomik
- B) Hipërplazia endometriale
- C) Menstruacioni retrograd
- D) Deficiti imunologjik

Infermieri Pyetja: 1456

Cila nga terapitë e mëposhtme NUK është e indikuar për trajtimin e endometrioze?

- A) Agonistët e hormonit lirues të gonadotropinave (GnRH)
- B) Progesteroni
- C) Kontraktivet orale
- D) Danazoli

Infermieri Pyetje: 1457

Parimet e trajtimit të gonorresë, ME PËRJASHTIM TE:

- A) Doza unike
- B) Trajtimi i partnerit
- C) Trajtimi spitalor
- D) Mjekimi i sëmundjeve bashkëshoqëruese

Infermieri Pyetje: 1458

Me cilat nga patologjitë e mëposhtme janë të lidhura me shpesh metrorragjitë disfunktionale?

- A) Polipet endometriale
- B) Anovulacioni
- C) Çregullimet e koagulimit
- D) Endometrioza

Infermieri Pyetje: 1459

Me çfarë termi (emri) përcaktohen menstruacionet me humbje gjaku 100 ml dhe me ritëm cdo 35 ditë?

- A) Menometroragjia
- B) Menoragjia
- C) Polimenorea
- D) Oligomenorea

Infermieri Pyetje: 1460

Me çfarë termi (emri) përcaktohen menstruacionet me humbje gjaku 40 ml dhe ritëm cdo 35 ditë?

- A) Menometroragjia
- B) Menoragjia
- C) Polimenorea
- D) Oligomenorea

Infermieri Pyetje: 1461

Cila nga këto IST kalon nëpër tre stadi të njëpasnjëshme nëse lihet pa u mjekuar ?

- A) HPV
- B) Sifilizi
- C) Chlamidia tracomatis
- D) Gardnerella vaginalis

Infermieri Pyetje: 1462

Miomat submukoze mund të shoqërohen me këto shenja dhe simptoma, përveç:

- A) Anemi
- B) Infertilitet
- C) Menometroragji
- D) Qarkullim gjaku parazitar nga organet e tjera

Infermieri Pyetje: 1463

Miomat janë të lidhura me kushtet e mëposhtme klinike përveç se me:

- A) Aneminë
- B) Amenorenë
- C) Dismenorea
- D) Pielonefritin

Infermieri Pyetje: 1464

Cila nga ankesat e mëposhtme nuk lidhet me klinikën e fibromiomave uterine?

- A) Te vjellat
- B) Dhimbja
- C) Problemet riprodhuese
- D) Menometroragjia

Infermieri Pyetje: 1465

Fibromioma uterine gjatë barrës:

- A) I zvogelojnë përmasat
- B) I rrisin përmasat
- C) Pësojnë transformim malinj
- D) Nuk pësojnë ndryshime

Infermieri Pyetje: 1466

Cila nga metodat diagnostike të mëposhtme është e duhura për vlerësimin e kalueshmërisë tubare?

- A) Testi post-koital
- B) Histerosaplingografia
- C) Laparaskopia
- D) Spermograma

Infermieri Pyetje: 1467

Cila nga metodat diagnostike të mëposhtme është e duhura për vlerësimin e malformacioneve të kavitetit uterin ?

- A) Testi post-koital
- B) Histerosaplingografia
- C) Laparaskopia
- D) Biopsia e endometrit

Infermieri Pyetje: 1468

Cila nga situatat e mëposhtme NUK është treguese e ndodhjes së ovulacionit?

- A) Shtimi i temperaturës normale
- B) Barra
- C) Endometri i tipit sekretiv
- D) Menstruacioni

Infermieri Pyetje: 1469

Cila nga situatat e mëposhtme NUK flet për sterilitet femeror?

- A) Mungesa e kalueshmerise tubare
- B) Anovulacioni
- C) Kriptokirdia
- D) Insuficiencia e progesteronit ne fazen e dyte te ciklit

Infermieri Pyetje: 1470

Cila nga ekzaminimet e më poshtme NUK përdoret për identifikimin e infertilitetit mashkullor?

- A) Spermograma
- B) Testi post-coital
- C) Biopsia endometriale
- D) Antikorpjet anti-spërmatozoidike

Infermieri Pyetje: 1471

Për fillimin dhe mbajtjen e ciklit menstrual NUK është e nevojshme:

- A) Hormoni clirues i gonatropinave (GnRH)
- B) Një endometer i ndjeshëm ndaj hormonet steroide seksuale
- C) Kalueshmëria tubare
- D) Hormonet steroide seksuale me origjine ovariale

Infermieri Pyetje: 1472

Cili nga ekzaminimet hormonale është kryesor për përcaktimin e ndodhise se menopauzes?

- A) FSH
- B) LH
- C) Prolaktina
- D) Androgjenet

Infermieri Pyetje: 1473

Afshet e nxehura në menopauzë krijohen nga:

- A) Rritja e FSH
- B) Rritja e LH
- C) Rënia e estrogjeneve
- D) Rënia e progesteronit

Infermieri Pyetje: 1474

Trajtimi i keshilluar për osteoporozë në menopauzë i përfshin të gjitha PËRVEC:

- A) Estrogjen
- B) Progesterone
- C) Ushtrime fizike
- D) Kalcium

Infermieri Pyetje: 1475

Pasojat afatgjata të menopauzës janë:

- A) Anemia
- B) HTA dhe diabeti
- C) Osteoporozë dhe arterioskleroza
- D) Depresioni

Infermieri Pyetje: 1476

Cili nuk përbën një faktor rreziku për kancerin e qafës së mitres?

- A) Raporti i parë seksual në moshë shumë të re
- B) Partnere seksuale të shumta
- C) Duhëpirja
- D) Hipërkoesterolemia

Infermieri Pyetje: 1477

Gjatë laktacionit janë të lejuar kontraktivët oralë:

- A) Monofazikë të kombinuar
- B) Dyfazikë të kombinuar
- C) Trefazikë të kombinuar
- D) Vetëm me progesteron

Infermieri Pyetje: 1478

Metodat kontraktive afatgjata të rikthyeshme përfshijnë:

- A) DIU
- B) Spërmicidet
- C) Kondomi
- D) Diafragma

Infermieri Pyetje: 1479

Dizavantazhet e kontraktivëve progesteronike përfshijnë:

- A) Metroragji
- B) Amenore
- C) Nauze
- D) Humbje në peshë

Infermieri Pyetje: 1480

Diagnoza e menopauzës vendoset pas:

- A) 3 muaj amenore
- B) 6 muaj amenore
- C) 12 muaj amenore
- D) 18 muaj amenore

Infermieri Pyetje: 1481

Dispareunia është dhimbja:

- A) gjatë menstruacioneve
- B) gjatë kontakteve seksuale
- C) në mesin e ciklit (ovulatore)
- D) pelvike e papërcaktuar

Infermieri Pyetje: 1482

HPV është i lidhur me kancerin e :

- A) Gjirit
- B) Mitrës
- C) Vaginës
- D) Qafës së mitrës

Infermieri Pyetje: 1483

IST favorizohen nga:

- A) Menopauza
- B) Abstenenca seksuale
- C) Përdorimi i profilaktikëve
- D) Numri i lartë i partnerëve seksualë

Infermieri Pyetje: 1484

Nëntipat e HPV që përfshihen si onkoviruse me risk të lartë janë:

- A) 6, 11
- B) 16, 18
- C) 21, 23
- D) 52, 53

Infermieri Pyetja: 1485

Kush është ekzaminimi baze depistues për kancerin e qafës së mitres?

- A) Ekografia
- B) Vizita gjinekologjike
- C) Pap-testi
- D) Kultura e sekrecioneve vagjinale

Infermieri Pyetja: 1486

Kush përbën faktor parandalues për kancerin e gjirit?

- A) Menarka e herëshme
- B) Menopauza e vonëshme
- C) Nullipariteti
- D) Asnjëra

Infermieri Pyetja: 1487

Menopauza artificiale nukupton të gjitha opsionet e mëposhtme, përveç:

- A) Ablacioni kirurgjikal i dy ovarëve
- B) Ndalimit natyral të aktivitetit folikular ovarian
- C) Kemioterapia
- D) Radioterapia

Infermieri Pyetja: 1488

Infeksioni vaginal i shoqëruar me leukore me erë si të peshkut të prishur shkaktohet nga:

- A) Chlamydia trachomatis
- B) Streptokoku B hemolitik
- C) Trichomonas vaginalis
- D) Gardnerella vaginalis

Infermieri Pyetje: 1489

Kur harrohet pilula kontraceptive, cili është qendrimi i duhur?

- A) Nderpritet paketa e filluar
- B) Merren dy pilula njëherazi
- C) Hidhet tableta e harruar dhe merret pasardhësja
- D) Merret pilula e harruar brenda 12 orëve dhe vazhdohet pilula e radhës

Infermieri Pyetje: 1490

Kateterizimi arterial:

- A) Nuk realizon një monitorim agresiv të presionit arterial
- B) Nuk mundëson marrjen e gjakut për analizë
- C) Përdoret shpesh për infuzionin e likideve dhe medikamenteve
- D) Përdoret për infuzionin e likideve dhe medikamenteve jovazoaktive vetëm në situata urgjente

Infermieri Pyetje: 1491

Presioni venoz central:

- A) Është një e dhënë që shpreh volumin e likideve që ndodhen në venat centrale
- B) Ulet kur ulet presioni arterial sistolik
- C) Është mbi 10 cm shtyllë ujë në shokun hipovolemik
- D) Merr vlera të larta kur kemi humbje të masës qarkulluese

Infermieri Pyetje: 1492

Monitorimi respirator behet:

- A) për të mbikëqyrur përfuzionin e organeve
- B) për të vlerësuar shkëmbimin e gazeve në pulmone
- C) nëpërmjet matjes së presionit arterial të gjakut
- D) nëpërmjet matjes së frekuencës kardiake

Infermieri Pyetje: 1493

Gjendja vegetative:

- A) është mungesë e funksionit cerebral me funksione vitale të ruajtura
- B) quhet ndryshe vdekje cerebrale
- C) është gjendja në të cilën pacienti kryen aktivitet intelektual dhe shqisor
- D) është gjendja në të cilën pacienti ka nevojë për mbështetje reanimatore të funksioneve jetike të tij

Infermieri Pyetje: 1494

Shenjat e arrestit kardiocirkulator janë:

- A) Pacienti është koshient
- B) Apnea, ose respiracion me gulçim
- C) Lëkurë e ftohtë, e zbehtë, e djersitur
- D) Mungesë e pulsit periferik

Infermieri Pyetje: 1495

Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë:

- A) Ischemia cerebrale për më shumë se 5-7 minuta nuk jep dëmtime në sistemin nervor qendror
- B) Rezervat e ATP në tru konsumohen brenda 15 minutash në rast arresti kardiak
- C) Truri mund të ruhet edhe 15 minuta pas arrestit kardiak n.q.s. Fillohet menjëherë reanimimi kardiopulmonar
- D) Truri mund të ruhet edhe 15 minuta pas arrestit kardiak pavarësisht fillimit të reanimimit kardio-pulmonar

Infermieri Pyetje: 1496

Vdekja cerebrale:

- A) është humbje e parikthyeshme e funksionit të korteksit
- B) është humbje e rikthyeshme e funksionit të trungut të trurit
- C) është humbje e funksionit të korteksit, me funksion të rujtur trungut të trurit
- D) është gjendja ku pacienti ka nevojë për mbështetje reanimatore të funksioneve jetike të tij

Infermieri Pyetja: 1497

Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë:

- A) Në pacientët që janë zgjuar, reflekset mbrojtëse të rrugëve të ajrit nuk parandalojnë aspirimin pulmonar të përmbajtjes gastrike
- B) Pacientët me një status mental të alteruar mund t'i humbasin reflekset mbrojtëse gjë që i ekspozon ata me riskun e rritur për pneumoni aspirative
- C) Intubimi trakeal me një tub me manshetë nuk e ul riskun për aspirim
- D) Intubimi trakeal me një tub me manshetë mund ta parandalojë plotësisht aspirimin e përmbajtjes gastrike

Infermieri Pyetja: 1498

Shkaqet më të zakonshme që shkaktojnë arrestin kardipulmonar janë:

- A) Hipovolemia nga humbjet e shpejta të gjakut
- B) Hipokapnia
- C) Alkaloza metabolike
- D) Hipertermia

Infermieri Pyetja: 1499

Vlerësimi i komës sipas shkallës GLASGOW:

- A) Nuk jep të dhëna për thellësinë e komës
- B) Nuk ndikohet nga përgjigja motore e pacientit
- C) Kryhet vetëm duke i folur pacientit
- D) Bën vlerësimin e përgjigjeve motore, verbale dhe lëvizjes së syve

Infermieri Pyetja: 1500

Ventilimi mekanik:

- A) Nuk zëvendëson ventilimin e kryer nga sistemi respirator i pacientit
- B) Ul gjithnjë debitin kardiak
- C) Ul rrezikun e aspirimit
- D) Rrezikon për barotraumë ose volutraumë pulmonare

Infermieri Pyetje: 1501

Në pacientët që marrin opioide për një kohë të gjatë për trajtimin e dhimbjes:

- A) Zhvillohet apasionimi ose varësia psikologjike
- B) Zhvillohet toleranca
- C) Kanë diarre për një kohë të gjatë
- D) Me rritjen e dozës shfaqet deprimimi i respiracionit

Infermieri Pyetje: 1502

Në pacientët me ventilim mekanik:

- A) Preferohet ushqyerja enterale kundrejt asaj parenterale
- B) Nuk bëhet ushqyerje për sa kohë që pacienti është në ventilim mekanik
- C) Shkurtohet koha e qëndrimit në ventilator mekanik tek pacientët me kequshqyerje
- D) Duhet dhënë një sasi sa më e madhe ushqimesh nga sonda nazo-gastrike për të përmirësuar gjendjen nutricionalë të pacientit

Infermieri Pyetje: 1503

Insuficiencia respiratore:

- A) Nuk zhvillohet gjatë detresit respirator të adultit
- B) Ndikohet nga raporti ventilim/perfuzion
- C) Mund të shoqërohet me hiperoksemi
- D) Trajtohet gjithnjë me ventilim mekanik pavarësisht shkakut të saj

Infermieri Pyetje: 1504

Cili nga pohimet është i vërtetë?

- A) Të gjitha dhimbjet kanë një shkak fiziologjik të identifikueshëm
- B) Nëse raportohet lehtësim i dhimbjes pas një placeboje, kjo do të thotë se dhimbja nuk është reale
- C) Toleranca ndaj dhimbjes është individuale
- D) Meshkujt ndiejnë më pak dhimbje se femrat

Infermieri Pyetje: 1505

Në respiracionin paradoksal, në inspirim :

- A) Ndërkohë që toraksi ngrihet abdomeni ulet
- B) Ngrihet si toraksi dhe abdomeni
- C) Ulet toraksi dhe ngrihet abdomeni
- D) Ulet toraksi dhe ulet dhe abdomeni

Infermieri Pyetje: 1506

Shenja të perfuzionit jo të përshtatshëm të organeve vitale janë:

- A) Presioni sistolik i gjakut mbi 80 mmHg
- B) Presioni arterial mesatar nën 50 mmHg
- C) Prezenca e presionit venoz central të lartë
- D) Lëkura e ngrohtë, rimbushja kapilare e mirë

Infermieri Pyetje: 1507

Në një pacient të terapisë intensive me çrregullim akut të statusit mental:

- A) Monitorohet pulsoksimetria dhe gazanaliza e gjakut
- B) Jepet gjithmonë sedativë
- C) Jepet glukozë i/v vetëm në diabetikët
- D) Vendoset oksigjen suplementar pavarësisht O2Sat normal

Infermieri Pyetje: 1508

Në dhimbjen kronike pacienti:

- A) Paraqitet me shenjat e fluksit të shtuar simpatik
- B) Nuk ka ndryshime në shenjat vitale
- C) Uj dozën e analgjezikeve për qetësimin e dhimbjes
- D) Rrit tolerancën ndaj dhimbjes sepse sa më gjatë të ketë patur dhimbje aq më i pandjeshëm bëhet ndaj saj

Infermieri Pyetje: 1509

Cilën nga gjendjet e mëposhtme shkakton humbja e bikarbonateve nga organizmi?

- A) Acidozë metabolike
- B) Alkalozë metabolike
- C) Alkalozë respiratore
- D) Acidozë respiratore

Infermieri Pyetje: 1510

Shoku hipovolemik:

- A) Shkaktohet nga shtimi i masës qarkulluese të gjakut
- B) Shkaktohet nga insuficienca primare e zemrës
- C) Shfaqet me hipertension
- D) Ka si karakteristike një PH arterial nën 7,35

Infermieri Pyetje: 1511

Monitorimi hemodinamik bëhet:

- A) për të mbikëqyrur përfuzionin e organeve
- B) për të vlerësuar shkëmbimin e gazeve në pulmone
- C) nëpërmjet matjes së presionit të dioksidit të karbonit në rrugët e ajrit
- D) nëpërmjet matjes së PH dhe gazeve të gjakut arterial

Infermieri Pyetje: 1512

Pulsoksimetria bën të mundur monitorimin në vazhdimësi:

- A) Të përqëndrimit të oksihemoglobinës së saturuar të një subjekti
- B) Të niveleve të presionit pjesor të oksigjenit në gjak
- C) Të niveleve të presionit pjesor të dioksidit të karbonit në gjak
- D) Presionit të dioksidit të karbonit në rrugët ajrore

Infermieri Pyetje: 1513

Masazhi i jashtëm kardiak:

- A) Kur zhvillohet në mënyrë efektive mban një presion arterial sistolik nën 80 mmHg
- B) Praktikohet kur pulsuar në arteriet e mëdha është mbi 30 rrahje në minutë
- C) Qëllimi i tij është të rikthejë respiracionin dhe aktivitetin kardiak
- D) Shoqëron dhënien e adrenalinit, defibrilimin dhe respiracionin artificial në

menaxhimin e arrestit kardiak

Infermieri Pyetje: 1514

Shoku anafilaktik:

- A) Shkaktohet si pasojë e reduktimit të masës qarkulluese të gjakut
- B) Shkaktohet nga insuficiencia primare e zemrës
- C) Është pasojë e një vatre infeksioni dhe e bakteremisë
- D) Është pasojë e futjes në organizëm të substancave alergjene

Infermieri Pyetje: 1515

Acidoza metabolike karakterizohet nga:

- A) pH i gjakut nën 7.35
- B) Bikarbonatet në gjak mbi 23.4 mEq/l
- C) Presioni arterial i dioksidit të karbonit mbi 35 mmHg
- D) Mjekohet me oksigjenoterapi

Infermieri Pyetje: 1516

Pacienti duhet intubuar nëq:

- A) Presioni i dioksidit të karbonit në gjak ulet progresivisht
- B) Kur pacienti bëhet jokohshëm nga narkoza me dioksid karboni
- C) Kur ngrihet pH i gjakut nga alkalozja e thellë respiratore
- D) Presioni i oksigjenit arterial rritet progresivisht pavarësisht përdorimit të maskës

faciale

Infermieri Pyetja: 1517

Cilat duhet të kryhen të parat në një pacient të terapisë intensive?

- A) Manovrat diagnostike
- B) Manovrat terapeutike
- C) Anamneza dhe ekzaminimit fizik
- D) Vlerësimi dhe terapia

Infermieri Pyetja: 1518

Kush është rruga e përshtatshme për administrimin e medikamenteve gjatë reanimimit kardiopulmonar në një arrest kardiak kur nuk mund të vendoset rruga venoze?

- A) Rruga intramuskulare
- B) Rruga endotrakeale
- C) Rruga intraoseale në pacientë adultë
- D) Rruga intrakardiake

Infermieri Pyetja: 1519

Efektet anësore më të shpeshta të opioideve janë:

- A) Hiperventilimi
- B) Nauzeja dhe të vjellat
- C) Diarrea
- D) Axhitimi

Infermieri Pyetja: 1520

Sindroma e abstinencës nga opioidet:

- A) Quhet ndryshe varësi psikologjike nga opioidet
- B) Shfaqet kur një pacient ndërpret menjëherë përdorimin e opioidit
- C) Ndodh si pasojë gripit në pacientë që marrin opioide në doza të mëdha
- D) Nuk ndodh kur opioidi ndërpritet menjëherë në një pacient që i ka përdorur për një kohë të gjatë

Infermieri Pyetja: 1521

Në rastet kur ka ndodhur vdekja cerebrale:

- A) Pacienti nuk ka nevojë për mbështetje reanimatore të funksioneve jetike të tij
- B) Pacienti është në arrest respirator
- C) Pacienti nuk ka nevojë për ventilim mekanik për oksigjenim të mirë të indeve
- D) funksionojnë ende qendrat përgjegjëse për automatizmin kardiorespirator që ndodhen në bazën e kafkës

Infermieri Pyetja: 1522

Plazma e freskët e ngrirë:

- A) Është një likid zëvendësues i mirë për të korrigjuar hipovoleminë
- B) Nuk ka risk për transmetimin e infeksioneve të transmetueshme nëpërmjet transfuzionit
- C) Ka prioritet ndaj përdorimit të likideve zëvendësues kristaloidë në trajtimin e hipovolemisë
- D) Nëse mbahen temperaturat e duhura mund të ruhet për të paktën një vit, ose më shumë

Infermieri Pyetja: 1523

Ngritja e shtratit me kënd 45 gradë në pacientët në ventilim mekanik:

- A) Rrit rrishtun për aspirim të përmbajtjes gastrike
- B) Ul rrishtun për pneumoni nozokomiale
- C) Përmirëson hipotensionin
- D) Ndikon në përmirësimin e gjumit.

Infermieri Pyetja: 1524

Cilat nga pohimet e mëposhtme janë të vërteta:

- A) Sedacioni dhe paraliza përdoren në çdo pacient që është në ventilim mekanik
- B) Për parandalimin e pneumonisë të lidhur me ventilimin mekanik koka e shtratit duhet të ulet sa më shumë
- C) Për ta shkëputur pacientin nga respiratori duhet që ai të ketë reflekse intakte të rrugëve ajrore
- D) Në pacientët që marrin opioide zhvillohet varësia psikologjike nëse ato ndërpriten menjëherë

Infermieri Pyetja: 1525

Acidoza respiratore:

- A) Zhvillohet gjatë diarreve masive
- B) Zhvillohet në insuficiencën renale
- C) Korrigjohet me dhënien e bikarbonateve
- D) Është tregues i nevojës së ventilimit mekanik në insuficiencën respiratore

Infermieri Pyetja: 1526

Shoku septik:

- A) Shkaktohet si pasojë e reduktimit të masës qarkulluese të gjakut
- B) Shkaktohet nga insuficienca primare e zemrës
- C) Është pasojë e një vatre infeksioni dhe e bakteremisë
- D) Është pasojë e futjes në organizëm të substancave alergene

Infermieri Pyetja: 1527

Reaksionet hemolitike të transfuzionit vijnë si pasojë e:

- A) Transfuzionit jokompatibël sipas grupit
- B) Antitropave kundër leukociteve, ose proteinave plazmatike të dhuruesit
- C) Kalimit të një sasive të konsiderueshme të ajrit në vena
- D) Transfuzionit të shpejtë të gjakut të ftohtë

Infermieri Pyetje: 1528

Një pacient mund të vetëinfektohet si pasojë e:

- A) Transportit të agjentëve infektues nga një pacient tek tjetri
- B) Mikroorganizmave të pranishëm në florën e tij
- C) Mosndryshimit të barrierave individuale
- D) Përdorimit të antibiotikëve

Infermieri Pyetje: 1529

Transfuzioni i gjakut:

- A) Bëhet me gjak të saponxjerrë nga frigoriferi
- B) Bëhet me gjak të ngrohur më parë në 37 gradë celsius
- C) Duhet të zgjasë më shumë se 4 orë
- D) Bëhet me gjak që ka mbi 6 orë i nxjerrë nga frigoriferi dhe i ngrohur

Infermieri Pyetje: 1530

Cila nga thëniet e mëposhtme është e vërtetë :

- A) Anestezia spinale dhe epidurale jep hipertension arterial
- B) Anestezia spinale dhe epidurale jep takikardi
- C) Anestezia spinale dhe epidurale jep të përziera dhe të vjella
- D) Anestezia epidurale jep më shpesh se anestezia spinale dhimbje koke nga shpimi postdural

Infermieri Pyetje: 1531

Nga moseleminimi i plotë i anestezisë gjenerale dhe/ose bllokut neuromuskular ndodh:

- A) Çrregullime të elektrolitëve
- B) Obstruksioni i rrugëve të sipërme ajrore nga rënia e gjuhës
- C) Zgjim i shpejtë
- D) Çrregullime të temperaturës

Infermieri Pyetje: 1532

PaO₂ (presioni arterial i oksigjenit):

- A) Ndryshon në varësi të presionit pjesor të oksigjenit në ajrin e inspiruar
- B) Nuk ndryshon në sëmundjet pulmonare
- C) Matet nëpërmjet pulsoksimetrit
- D) Nuk ndryshon nga presioni venoz i oksigjenit

Infermieri Pyetje: 1533

Cila nga thëniet e mëposhtme është e vërtetë:

- A) Të gjitha medikamentet që përdor pacienti duhet të ndërpriten para kirurgjisë
- B) Duhanin mund ta pijë deri para operacionit
- C) Gjatë operacionit nuk ka rëndësi nëse stomaku është plot, ose jo
- D) Të korrigjohet hipovolemia dhe hipokalemia e mundshme para operacionit nëse koha e lejon

Infermieri Pyetje: 1534

Hipoventilimi postoperator çon në:

- A) Hipokapni
- B) Acidozë respiratore akute
- C) Hiperoksemi
- D) Në një ventilim të rritur në minutë

Infermieri Pyetje: 1535

Komplikacionet e analgjezisë epidurale janë:

- A) Hipertensioni
- B) Retensioni urinar
- C) Takikardia
- D) Sedacioni

Infermieri Pyetje: 1536

